



KËSHILLA PËR KËSHILLAT



RAPORT VJETOR I MONITORIMIT TË KËSHILLIT GJYQËSOR
DHE KËSHILLIT PROKURORIAL

(1 JANAR – 31 DHJETOR 2019)

PRISHTINË, PRILL 2020

Autor: Gzim Shala

Ekipi i Redaktorëve: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Prill 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje Ekzekutive	5
2. Metodologjia	7
3. Miratimi i legjislacionit sekondar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës	9
3.1. Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 11/2016 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve	12
3.2. Rregullore për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirim nga detyra të Gjyqtarëve Porot	12
3.3. Rregullore për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në Kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit	13
3.4. Rregullore për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave	14
3.5. Rregullore për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve	15
3.6. Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 06/2016 për Trajnimin e Gjyqtarëve	17
3.7. Rregullore për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor	18
3.8. Rregullore për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve	19
3.9. Rregullore për Procedurën dhe Kriteret e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Gjyqësori	19
4. Llogaridhënia në sistemin gjyqësor dhe mekanizmat e kontrollit	21
4.1. Raporti Vjetor i Punës së KGJK-së për vitin 2018	22
4.2. Raporti i punës së gjykatave për vitin 2018	22
4.3. Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe masat disiplinore	23
4.4. Raportimi i Kryetarëve të Gjykatave para Këshillit Gjyqësor të Kosovës	26
4.5. Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor	27
4.6. Avancimi dhe transferimi i Gjykatësve	29
4.7. Monitorimi i takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovë	30
4.7.1. Diskutimet e anëtarëve të KGJK-së gjatë miratimit të politikave	30
5. Miratimi i legjislacionit sekondar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës	36
5.1. Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr.08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve	37
5.2. Rregullore për Administrimin dhe Ndarjen e Lëndëve në Prokurorin e Shtetit	39
5.3. Rregullore për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial	39
5.4. Rregullore për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria	42
5.5. Rregullore për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve	44

5.6. Rregullore për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës	46
6. Llogaridhënia dhe integriteti në sistemin prokurorial dhe mekanizmat e kontrollit.....	48
6.1. Raporti vjetor i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2018	48
6.2. Raporti Vjetor i Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2018.....	49
6.3. Vlerësimi i performancës së prokurorëve dhe masat disiplinor.....	49
6.4. Raportimi i Kryeprokurorëve para KPK-së	51
6.5. Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit prokurorial	52
6.6. Avancimi dhe transferimi i Prokurorëve.....	55
6.7. Monitorimi i takimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës	55
6.7.1. Diskutimet e anëtarëve të KPK-së gjatë miratimit të politikave	56
7. Gjetjet e veçanta të monitorimit të IKD-së për KGJK dhe KPK.....	60
7.1. Konflikti i interesit në zgjedhjen e anëtarëve të këshillave në pozita udhëheqëse të prokurorive/gjykatave	60
7.2. Bojkoti i Avokatëve ndaj Gjyqësorit.....	62
7.3. Problemet gjatë periudhës tranzitore për funksionalizimin e Departamentit Special	64
7.4. KGJK shkel rregulloren që vet e ka miratuar.....	65
7.5. Akuzat e sistemit prokurorial lidhur me dështimet në luftimin e korrupsionit	66
7.6. Raportimi “bllanko” i Kryeprokurorëve	67
7.7. Tensionet e KPK-së me Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	68
7.8. Procesi i rekrutimit të gjyqtarëve të departamenteve speciale	70
7.9. “Kërcënimi” i Sindikatës së Judikaturës për futje në grevë	72
7.10. Kërcënimi me bombë në KGJK.....	73
7.11. Ndërprerja e procesit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të PSRK-së	74
7.12. KPK në mënyrë të kundërligjshme shpërblen me pozitën e UD Kryeprokurorit të Prishtinës prokurorin Kujtim Munishi	76
7.13. Dështimi në praktikë i Rregullores së KPK-së për Shërbimin e Komunikimit.....	78
7.14. Kryetari i Gjykatës së Apelit kërkon shkarkimin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve	81
7.15. Rritet numri i të arrestuarve në mënyrë të kundërligjshme si dhe shumat që u kompensohen këtyre personave	81
7.16. Dy gjyqtarë nën pranga si të dyshuar për korrupsion	83
8. Rekomandime	86

1. Përmbledhje Ekzekutive

Viti 2019 ka bërë rokadë në kryesimin e këshillave, pasi si Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ashtu edhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) kanë zgjedhur kryesues të rinj. Sa i përket kryesuesve paraprak, ish-kryesuesi i KPK-së është emëruar kryeprokuror i PSRK-së, derisa ish-kryesuesi i KGJK-së ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të KGJK-së.

Ish-kryesuesi i KPK-së, Blerim Isufaj, ka dhënë dorëheqje edhe nga pozita e anëtarit të KPK-së, pikërisht në ditën kur është shpallur konkursi për kryeprokuror të PSRK-së, në të cilën pozitë, Isufaj është emëruar nga kolegët e tij. Për këtë mënyrë të emërimit, IKD ka gjetur se përbën konflikt të interesit.

Më 10 janar 2019 ka hyrë në fuqi Ligji NR. 06/L-055 për KGJK-në, derisa më 18 prill 2019 ka hyrë në fuqi Ligji nr.06/L-056 për KPK-në. Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2019, si KGJK ashtu edhe KPK kanë zhvilluar punën e tyre mbi bazën e ligjeve të reja, ligje këto që kanë shfuqizuar ligjet paraprake. Miratimi i ligjeve të reja për KGJK dhe KPK, ka lënë prapa shumë obligime të pa përmbushura nga këshillat, e të cilat obligime kanë derivuar nga legjisllacioni tanimë i shfuqizuar.

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit të këshillave, ligjet e reja kanë “sakrifikuar” gjyqtarë e prokurorë. Në këtë drejtim, sipas Ligjit nr.06/L-055 për KGJK-në dhe ligjit nr.06/L-056 për KPK-në, kryesuesi, zëvendës kryesuesi, Kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Performancës, Kryetari i Komisionit për Çështje Administrative dhe Kryetari i Komisionit për administrimin e gjykatave/prokurorive shërbejnë me orar të plotë në këshill, dhe pezullojnë detyrën e tyre si gjyqtar/prokuror.

Por, përballë kësaj zgjidhje ligjore, qëllimi i së cilës është ngritja e efikasitetit të këshillave, KGJK dhe KPK nuk kanë reflektuar efikasitet në praktikë. Kjo për arsye se edhe pas miratimit të ligjeve të reja në vitit 2019, si në KGJK ashtu edhe në KPK kanë vazhduar problemet e njëjta.

Në këtë drejtim, asnjëri prej këshillave nuk ka arritur që brenda afatit të përcaktuar me ligj të miratojnë të gjithë legjisllacionin sekondar, duke lënë prapa shumë akte nënligjore të pa miratuara. Për më tepër, në disa prej akteve nënligjore të miratuara, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka gjetur se këshillat kanë devijuar nga baza ligjore.

Një progres pozitiv që këshillat, veçanërisht KGJK, kanë bërë gjatë vitit 2019 është zhvillimi i proceseve të konsultimit publik, me rastin e miratimit të shumë akteve nënligjore. Një praktikë e tillë pozitive, domosdoshmërisht se duhet të formalizohet me një rregullore të veçantë për konsultime publike, si nga KGJK, ashtu edhe nga KPK.

Në anën tjetër, këshillat vazhdojnë të japin shembuj negativ, duke mos përmbushur obligimet e tyre ligjore brenda afateve. Një qasje e tillë përpos që paraqet mungesë të efikasitetit, përqon edhe mesazh negativ tek të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që bëjnë të pamundurën që detyrat e tyre ti përfundojnë brenda afateve të përcaktuara me ligj. Për më tepër, kjo praktikë

zbeh edhe kredibilitetin e këshillave për të kërkuar llogaridhënie nga gjyqtarët dhe prokurorët të cilët detyrat e tyre zyrtare nuk i përfundojnë brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Gjatë vitit 2019, KGJK nuk ka arritur që të bëjë vlerësimin e performancës për 1/3 e gjyqtarëve, derisa KPK ka bërë vlerësimin e performancës për 1/3 e prokurorëve. Madje, gjatë takimit të Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, ka kërkuar shkarkimin e Komisionit të KGJK-së për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, për shkak se sipas tij, ky komision është subjektiv.

Po ashtu, KGJK dhe KPK nuk e kanë përmbushur siç kërkohet me ligj obligimin e tyre për të ftuar kryetarët e gjykatave, respektivisht kryeprokurorët, për të raportuar para anëtarëve të këshillave. Një mënyrë e tillë e veprimit, paraqet dështim të këshillave për të mbajtur gjykatat dhe prokuroritë llogaridhënëse.

Gjatë vitit 2019, ka hyrë në fuqi edhe Ligji nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Gjatë vitit 2019, masa më e rëndë disiplinore që KGJK ka shqiptuar ka qenë ulje e pagës për 30% në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, derisa gjatë këtij viti, KPK ka propozuar për shkarkim një (1) prokuror, derisa ka degraduar dy (2) prokurorë të tjerë. Por, për dallim nga përgjegjësia disiplinore, nën dyshimin për përgjegjësi penale, PSRK gjatë vitit 2019 ka vënë nën pranga dy (2) gjyqtarë.

Sa i përket transparencës, ndonëse ka një progres të theksuar, KGJK ende nuk ka arritur që të sigurojë transparencë të plotë, ashtu siç kërkohet me ligj. Në transparencë, gjatë vitit 2019 në masë të konsiderueshme ka çaluar KPK. Ndonëse në fillim të vitit 2019, KPK kishte një progres relativ të transparencës, ky progres ishte minuar me hyrjen në fuqi të Rregullores së KPK-së për Shërbimin e Komunikimit në Sistemin Prokurorial, e cila rregullore ka centralizuar informacionin prokurorial në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Në këtë mënyrë, në këtë raport IKD ka gjetur se pavarësisht ndryshimit të kryesuesve dhe ndryshimit të legjislacionit bazë, KGJK dhe KPK vazhdojnë me qasjen dhe praktikën përgjithësisht të njëjta, të cilat praktika cenojnë legjitimitetin dhe efikasitetin e këshillave në zbatimin e kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore.

2. Metodologjia

IKD ka hyrë në vitin e shtatë (7) të monitorimit të sistemit të drejtësisë, përkatësisht të KGJK-së, KPK-së, të gjykatave themelore bashkë me degët e tyre, Gjykatës së Apelit si dhe prokurorive.

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me zbatimin obligimeve kushtetuese dhe ligjore, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Në fokus të monitorimit kanë qenë takimet publike dhe aktivitetet e KGJK-së dhe KPK-së, të cilat janë monitoruar në detaje. Në këtë mënyrë, materiali i përpunuar në këtë raport mbi punën e KGJK-së dhe KPK-së gjatë vitit 2019 është lëndë e parë, që IKD e ka nxjerrë gjatë monitorimit të këshillave.

Gjithashtu, IKD ka monitorues në të gjitha gjykatat, degët e gjykatave dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës, të cilët monitorojnë me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të korrupsionit, rastet e tjera penale, rastet civile, administrative dhe ekonomike. Krahas këtij obligimi, monitoruesit e IKD-së janë të fokusuar në zbatimin e obligimeve ligjore nga ana e bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale si dhe stafit mbështetës. Monitorimi fokusohet në baza ditore tek performanca e gjykatave dhe prokurorive në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit të cilat miratohen nga KGJK dhe KPK. Të gjitha gjetjet e monitorimit, grumbullohen në Qendrën e IKD-së në Prishtinë, në të cilën, analistët juridikë të Institutit, zhvillojnë hulumtim ligjor dhe praktik me të dhënat e terrenit. Kjo metodologji e hulumtimit ofron mundësi praktike që të bëhet identifikimi i problemeve dhe të analizohen të gjitha çështjet që janë me interes në shërbim të zbatimit të ligjit. Për më tepër, me këtë metodologji, IKD ka mundësi që ta monitorojë zbatimin në praktikë të obligimeve ligjore, por edhe të politikave të miratuara si nga KGJK, ashtu edhe nga KPK.

Pas identifikimit dhe analizimit të gjetjeve dhe çështjeve problematike karshi ligjit, standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, IKD ka zhvilluar intervista të thella me të gjithë hisedarët e bërjes së politikave dhe ligjeve për institucionet e drejtësisë dhe zbatuesit e këtyre politikave dhe ligjeve. Intervistat janë zhvilluar në bazë të indikatorëve të vendosur si rezultat i monitorimit, gjetjeve dhe vlerësimeve nga ana e analistëve juridikë të IKD-së, të cilat kanë shërbyer për të nxjerrë në pah problemet reale në fushën e legjislacionit primar dhe sekondar si dhe në zbatimin e tyre në praktikë. Intervistat e zhvilluara janë kodifikuara ashtu që çështjet dhe informatat e dala nga to janë përfshirë në raport.

Po ashtu, për të qenë sa më të saktë në identifikimin e problemeve si dhe propozimin e rekomandimeve për zgjidhje të problemeve në zbatimin e drejtë të ligjit dhe funksionimin e mirëfilltë nga KGJK dhe KPK, IKD ka analizuar bazën ligjore dhe dokumentet e tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me pavarësinë dhe funksionimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial.

Për më tepër, IKD tanimë ka ndërtuar një sistem të monitorimit të KGJK-së, KPK-së, gjykatave, degëve të gjykatave si dhe prokurorive. Ky sistem konsiston në monitorimin dhe raportimin në kohë reale për këto institucione. Në kuptim të këshillave, IKD gjatë vitit 2019 ka publikuar tri (3) raporte mbi punën e KGJK-së dhe KPK-së¹. Në këtë mënyrë, IKD ka përcjellë në vazhdimësi punën e këtyre institucioneve kushtetuese, ku edhe ka dhënë rekomandime në vazhdimësi se si të ngritët efektiviteti i këshillave.

Ky raport paraqet punën një (1) vjeçare të KGJK-së dhe KPK-së, të përmbledhur në një raport të vetëm. Për më tepër, ky raport paraqet analizë të thellë dhe të detajuar të (mos) përmbushjes së obligimeve ligjore nga KGJK dhe KPK, analizim të legjislacionit sekondar si dhe gjetje të veçanta, ku për të gjitha çështjet, IKD ka dhënë edhe rekomandimet konkrete.

¹ Shala G. “Pavarësia, Efikasiteti, Llogaridhënia dhe Integriteti i sistemit gjyqësor dhe prokurorial”. IKD. 29 janar 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2019/01/Raporti-KGJK-KPK-2018-Final-29.01.2019-1-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2020); Shala G. “Pavarësia, Efikasiteti, Llogaridhënia dhe Integriteti i Këshillave”. IKD. 28 maj 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2019/09/Monitorimi-KGJK-KPK-Buletini-tre-mujor-1-janar-31-mars-2019-Final-PDF.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2019); Shala G. “Progresi dhe Regresi i Këshillave”. IKD. 6 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2019/11/IKD-Progresi-dhe-regresi-i-Keshillave-1-prill-30-qershor-2019-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2020).

3. Miratimi i legjislacionit sekondar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

IKD në raportet e saja periodike mbi punën e KGJK-së, kishte gjetur se ky këshill nuk kishte arritur që të përmbushë obligimet ligjore në kuptim të miratimit të legjislacionit sekondar.

Përderisa, KGJK përafërsisht për katër vjet nuk kishte arritur që të miratojë në tërësi legjislacionin sekondar sipas obligimeve të ligjeve të miratuara në vitin 2015, Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2018, ka miratuar ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor të Kosovës², Ligjin për Gjykatat³, dhe Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.⁴ Miratimi i ligjeve të reja nga Kuvendi i Kosovës përcakton përgjegjësi dhe obligime të reja për KGJK-në në miratimin e legjislacionit sekondar.

Që nga viti 2015, kur edhe kishin hyrë në fuqi ligjet e miratuara e deri në fund të vitit 2018, kur këto ligje edhe ishin shfuqizuar, si rezultat i mos planifikimit të duhur të punës në KGJK dhe komisionet e saj, ky institucion nuk kishte arritur të përmbushë obligimet ligjore në hartimin dhe miratimin e rregulloreve në vijim:

1. Rregulloren për Komunikim me Publikun dhe Mediat;
2. Rregulloren për Publikimin e Aktgjykimeve;
3. Rregulloren për Gjykatën Supreme rreth menaxhimit, caktimit të gjykatësve dhe caktimit të kolegjeve dhe kryesuesve të kolegjeve;
4. Rregulloren për Gjykatën e Apelit rreth caktimit të gjykatësve në departamente për të siguruar efikasitet në trajtimin e lëndëve, caktimin e udhëheqësve të departamenteve sipas nevojës dhe që siguron se secila lëndë i caktohet kolegjeve;
5. Rregulloren për Bashkëpunëtorët Profesional;
6. Rregulloren për Vlerësimin, Disiplinimin dhe Shkarkimin e Drejtorit të SKGJK-së.

Në kuptim të zbatimit të obligimeve ligjore nga Ligji i ri për KGJK-në dhe Ligjin e ri për Gjykatat, KGJK gjatë vitit 2019 ka miratuar gjithsej nëntë (9) rregullore dhe katër (4) udhëzime administrative.

KGJK gjatë vitit 2019 ka miratuar këto nëntë (9) rregullore:

1. Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 11/2016 për Vlerësim të Performancës së Gjyqtarëve;
2. Rregullore për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga detyra të Gjyqtarëve Porot;
3. Rregullore për Organizimin dhe Funksonalizimin e Departamentit Special në Kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit;
4. Rregullore për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave;
5. Rregullore për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve;
6. Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 06/2016 për Trajnimin e Gjyqtarëve;

²Ligji nr. 06/L-055, publikuar në Gazetën Zyrtare me nr. 23/2018, shpallur me 26 dhjetor 2018.

³Ligji nr. 06/L-054, publikuar në Gazetën Zyrtare me nr. 22/2018, shpallur me 18 dhjetor 2018.

⁴Ligji nr.06/L-67, publikuar në Gazetën Zyrtare me nr. 23/2018, shpallur me 26 dhjetor 2018.

7. Rregullore për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësorë;
8. Rregullore për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve;
9. Rregullore për Procedurën dhe Kriteret e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Gjyqësori.

Po ashtu, KGJK gjatë vitit 2019 ka miratuar edhe këto katër (4) udhëzime administrative:

1. Udhëzim Administrativ për Ndarjen e Përgjegjësisë të SKGJK-së dhe të Gjykatave në Çështjet e Personelit, Buxhetit dhe Financave, Logjistikës dhe Prokurimit
2. Udhëzim Administrativ për Plotësimin e Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore
3. Udhëzim Administrativ për Rregullat Unike dhe të Përbashkëta për Rendin Shtëpiak në Gjykata
4. Udhëzim Administrativ për Publikimin e Aktgjyqimeve të Përpunuara

Por, krahas miratimit të këtij legjislacioni sekondar, KGJK ka lënë prapa edhe disa rregullore, të cilat nuk i ka miratuar sipas afateve të përcaktuara me ligj.

Sipas Ligjit të ri për KGJK-në, KGJK ka qenë e obliguar që deri më 10 janar 2020, t'i nxjerrë këto rregullore/kode:

1. Kodi i Etikës për Gjyqtarë Porotë;
2. Kodi i Etikës për Staf Administrativ;
3. Rregullore për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisioneve të Përhershme të KGJK-së;
4. Rregullore për Transferimin e Gjyqtarëve;
5. Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës⁵;
6. Rregullore për Strukturën Organizative dhe Funkcionimin e SKGJK-së;
7. Rregullore për Strukturën Organizative dhe Funkcionimin e Njesisë për Inspektim Gjyqësor;
8. Rregullore për Administratorët e Gjykatave;

Ndërsa, në bazë të Ligjit të ri për Gjykatat, KGJK obligohet që t'i nxjerrë këto rregullore:

1. Rregullore për Shqyrtimin e Kërkesave për Themelimin e Degëve të Reja të Gjykatave;
2. Rregullore për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave;
3. Rregullore për Veprimtaritë Profesionale të Gjyqtarëve;
4. Rregullore për Bashkëpunëtorët Profesional;
5. Rregullore për Arsimimin e Vazhdueshëm Ligjor të Gjyqtarëve;

Po ashtu, në bazë të rregullores nr. 03/2017 për Procedurën e Përzgjedhjes dhe emërimit të Drejtorit të SKGJK-së, KGJK obligohet edhe në nxjerrjen e rregullores për vlerësimin,

⁵ Shënim: Kjo rregullore është miratuar nga KGJK më 27 janar 2020, pra 17 ditë pas afatit të përcaktuar me ligj.

disiplinimin dhe shkarkimin e drejtorit të SKGJK-së, rregullore e cila ende nuk është nxjerrë nga KGJK.

IKD vlerëson se praktika e KGJK-së për mos miratimin e legjislacionit sekondar brenda afateve ligjore paraqet mos përmbushje të mandatit dhe obligimeve ligjore që ka ky këshill. Fillimisht, mos miratimi i legjislacionit sekondar brenda afateve ligjore është dukuri e cila e ka përcjellë vazhdimisht KGJK-në me ligjet tanimë të shfuqizuara, e cila dukuri vazhdon të jetë prezentë edhe pas miratimit të ligjeve të reja.

Mungesa e legjislacionit sekondar paralizon shumë fusha, pasi krijohen zbrazëtira juridike në fushat respektive, të cilat zbrazëtira më pas ndikojnë në funksionimin dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor.

Për më tepër, bazuar në ligjin e ri për KGJK-në, kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi i KGJK-së si dhe kryetarët e tri (3) komisioneve angazhohen me orar të plotë të punën në KGJK. Kjo dispozitë është dashur të reflektojë qëllimin e saj, ku të paktën KGJK të miratoj legjislacionin sekondar brenda afateve ligjore.

Mos miratimi i legjislacionit sekondar dhe mos zbatimi i obligimeve të tjera brenda afateve ligjore nga vetë KGJK përcjell një shembull të keq edhe tek gjyqtarët. Në këtë situatë, kjo praktikë i demotivon gjyqtarët që të bëjnë përpjekje maksimale që detyrat e tyre ti kryejnë sipas afateve ligjore si dhe ulë kredibilitetin e vetë KGJK-së për të kërkuar llogaridhënie nga gjykatat.

Në anën tjetër, në procesin e miratimit të legjislacionit sekondar, KGJK në draftimin e disa rregulloreve ka treguar një praktikë mjaft të avancuar të draftimit të legjislacionit sekondar. Kjo për arsye se në shumicën e rregulloreve që KGJK ka miratuar, ky institucion ka zhvilluar edhe konsultime publike.

Për më tepër, IKD ka gjetur se procesi i konsultimeve publike në KGJK nuk ka qenë një proces formal, por një proces meritore, ku secila palë e interesuar ka pasur mundësi të mjaftueshme të jap kontributin e saj.

Ndër të gjitha këto rregullore, transparenca dhe bashkëpunimi më i lartë ka qenë në draftimin e Rregullores për Zgjedhjen e Anëtarëve të KGJK-së nga Gjyqësori, ku edhe pas mbylljes së konsultimit publik, pas inkorporimit të komenteve nga palët e interesuara, rregullorja është ridërguar për komente.

IKD e vlerëson shumë pozitivisht këtë praktikë të ndërtuar nga KGJK. Një praktikë e tillë është transparenca dhe veçanërisht bashkëpunimi i KGJK-së me publikun, mediat dhe shoqërinë civile. Krahas kësaj, me anë të zhvillimit të procesit të konsultimit publik, KGJK-së i bëhet e mundur që të miratojë rregullore sa më të pranueshme dhe më të qëndrueshme, ku secilës palë i mundësohet pjesëmarrje aktive në draftimin e këtij legjislacioni.

Krejt në fund, IKD vlerëson se kjo praktikë pozitive e KGJK-së duhet të formalizohet, në atë mënyrë që KGJK me anë të një rregulloreje të veçantë, të nxjerrë dispozita dhe rregulla

specifike mbi procesin e konsultimeve publike. Nxjerrja e kësaj rregulloreje, do ta betonizonte këtë praktikë të mirë të ndërtuar nga KGJK.

Në vazhdim, IKD ka analizuar secilën prej rregulloreve të miratuara nga KGJK.

3.1. Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 11/2016 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve

Më 10 janar 2019, ka hyrë në fuqi ligji nr.06/L-055 për KGJK-n. Me miratimin e këtij ligji, është shfaqur edhe nevoja që KGJK të ndryshojë Rregulloren 11/2016 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve.

Për këtë arsye, KGJK me 24 janar 2019, ka miratuar Rregulloren nr.01/2019 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores 11/2016 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve.

Ndërsa, me 31 janar 2019, KGJK ka miratuar edhe Udhëzuesin për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve.

Me anë të kësaj rregulloreje, përcaktohen kriteret ligjore që aplikohen me rastin e vlerësimit të performancës së një gjyqtari, si dhe matësit për vlerësimin e përmbushjes/mos përmbushjes së kriterëve.

Me anë të kësaj rregullore e cila bazohet në Ligjin e ri për KGJK-në, përcaktohet se nëse një gjyqtar vlerësohet me notën “dobët”, i njëjti propozohet për shkarkim nga detyra.

3.2. Rregullore për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga detyra të Gjyqtarëve Porot

KGJK, në takimin e mbajtur me 5 prill 2019, ka miratuar Rregulloren nr. 02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimit, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga Detyra të Gjyqtarëve Porotë.

Me anë të kësaj rregulloreje, KGJK ka përcaktuar se procesin e rekrutimit për gjyqtarë porotë e udhëheqin gjykatat, derisa vendimin e merr KGJK. Në këtë rregullore është përcaktuar edhe kriteri që për tu emëruar gjyqtar porotë, kandidati duhet ta ketë të përfunduar me sukses trajnimin e kërkuar për gjyqtarë porotë, ku përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit do ta caktojë KGJK me anë të një vendimi të veçantë. Po ashtu, kjo rregullore përcakton edhe lartësinë dhe procedurën e shpërblimit apo kompensimit të gjyqtarëve porotë, si dhe përcakton procedurën dhe masat disiplinore për shkelje të supozuara të gjyqtarëve porotë.

a) Vonesat në miratimin e kësaj rregulloreje

Kjo rregullore ka lënë prapa memorandumin referencë SJ/7/3/00 të datës 7 mars 2000, i cili memorandum ka shërbyer për plot 19 vjet, derisa KGJK ka miratuar këtë rregullore.

Me 1 janar 2013, kishte hyrë në fuqi Ligji nr.03/L-199 për Gjykatat. Ky ligj kishte përcaktuar obligimin e KGJK-së për miratimin e kësaj rregulloreje.

Ky ligj është shfuqizuar me 2 janar 2019, kur edhe ka hyrë në fuqi Ligji nr.06/L-054 për Gjykatat.

Në këtë mënyra, IKD ka gjetur se deri në miratimin e kësaj rregulloreje, KGJK-së i janë dashur hiq më pak se gjashtë (6) vjet e katër (4) muaj e katër (4) ditë.

Në anën tjetër, mungesën e kësaj rregulloreje, IKD e kishte evidentuar në secilin raport sistematik mbi punën e KGJK-së, ku edhe kishte rekomanduar miratimin e kësaj rregulloreje.

3.3. Rregullore për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në Kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit

Më 2 janar 2019, ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Gjykatat i cili përcakton se në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe në kuadër të Gjykatës së Apelit do të themelohet edhe Departamenti Special për Lëndët të cilat bien në kompetencë të PSRK-së.

Neni 42 i këtij ligji ka obliguar KGJK-në që të funksionalizojë këtë departament brenda gjashtë (6) muajve.

Në përmbushje të këtij obligimi ligjor dhe brenda afatit ligjor, KGJK me 23 prill 2019 ka nxjerrë Rregulloren nr.03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në Kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.

Me këtë rregullore, KGJK ka funksionalizuar Departamentin Special, ku ka përcaktuar kriteret dhe procedohet për zgjedhjen e gjyqtarëve që do të veprojnë në kuadër të këtij departamenti, si dhe ka përcaktuar dispozitat përkitazi me administratën e këtij departamenti.

Në të njëjtën ditë kur edhe është miratuar kjo rregullore, KGJK ka shpallur konkurs për gjyqtarë në Departamentin Special pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë si dhe për gjyqtarë të këtij Departamenti pranë Gjykatës së Apelit⁶. Gjyqtarët për këto departamente janë përzgjedhur nga KGJK më 28 qershor 2019⁷.

Ecuria e këtij procesi do të trajtohet edhe tek kapitulli i gjetjeve të veçanta të këtij raporti.

⁶ "Funksionalizohet Departamenti Special, KGJK-ja shpall konkurs për gjykatës". Betimi për Drejtësi. 23 prill 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/funksionalizohet-departamenti-special-kgjk-ja-shpall-konkurs-per-gjykates/>). (qasur së fundi më 29 korrik 2019).

⁷ "KGJK-ja, emëroi Gjyqtarët në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit". 28 qershor 2019. KGJK. (ëëë.gjyqesori-rks.org/2019/06/28/kgjk-ja-emeroi-gjyqtaret-ne-departamentin-special-ne-kuader-te-gjykates-themelore-ne-prishtine-dhe-gjykates-se-apelit/). (qasur së fundi më 27 korrik 2019).

3.4. Rregullore për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave

Ligji për Ndërmjetësim në nenin 8, paragrafi 4 ka përcaktuar se “Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nxjerr akt nënligjor me të cilin përcaktohet **procedura e referimit** të rasteve nga gjykata sipas paragrafit 1. të këtij neni”.

Në zbatim të këtij obligimi ligjor, KGJK me 8 maj 2019 ka miratuar Rregulloren nr.04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave.

Me anë të kësaj rregulloreje, KGJK ka përcaktuar referentin për ndërmjetësim, i cili do të administrojë me rastet e gjykatave në proces të ndërmjetësimit. Po ashtu, KGJK me anë të kësaj rregulloreje ka përcaktuar edhe rregullat për administrimin e lëndëve të gjykatave të cilat janë në procedurë të ndërmjetësimit, që nga inicimi e deri në përfundim të procedurës së ndërmjetësimit.

a) *“Volumi” i panevojshëm i rregullores*

Siç u tha edhe më lartë, KGJK sipas Ligjit për Ndërmjetësim ka qenë e obliguar që të nxjerrë akt nënligjor me të cilin përcakton vetëm **procedurat e referimit** të rasteve nga gjykata. Përtej kësaj, KGJK nuk ka pasur nevojë dhe as të drejtë të përcaktojë dispozita të tjera, të cilat janë të karakterit ligjor.

KGJK është e vërtetë se ka përcaktuar si duhet këto procedura si dhe ka vendosur rregulla të duhura për administrimin e mirë të këtij procesi. Por, pjesa më e madhe e kësaj rregulloreje është e mbushur me dispozita të cilat janë përcaktime ligjore në Ligjin për Ndërmjetësim.

Kjo për arsye se përpos procedurës së referimit, kjo rregullore përcakton edhe dispozitat për përshtatshmërinë e lëndëve për ndërmjetësim, fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, konfliktin e interesit, të metat e vullnetit, konfidencialitetin e procedurës së ndërmjetësimit, marrëveshjen e ndërmjetësimit, mosarritjet e marrëveshjes së ndërmjetësimit, përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit, efektin juridik të marrëveshjeve të arritura në procedurën e ndërmjetësimit dhe shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit. Normat që rregullojnë këto çështje, janë norma identike sikurse në Ligjin për Ndërmjetësim.

IKD vlerëson se KGJK duhet ti shmanget logjikës që në legjislacionin e saj sekondar të kopjoj dispozitat ligjore. Në këtë drejtim, KGJK duhet ta ketë parasysh se ligji është i vet zbatueshëm, deri në masën në të cilën për zbatimin e të njëjtit nuk nevojitet legjislacion sekondar në kuptim të detajizimit të dispozitave ligjore. Për këtë arsye, kopjimi i dispozitave ligjore në legjislacion sekondar nuk ka asnjë kuptim, pasi ky i fundit vjen në shprehje vetëm në rastet kur për të njëjtin referojnë ligjet bazike.

Për më tepër, IKD konsideron se me anë të kësaj mënyre të draftimit të legjislacionit sekondar, KGJK vetëm sa krijon volum të panevojshëm të legjislacionit sekondar, pasi i njëjti nuk ka asnjë efekt ligjor. Secili gjyqtar dhe zyrtar i cili merret me rastet e ndërmjetësimit,

duhet që fillimisht ti referohet ligjeve bazike dhe pastaj të referohet tek legjislacioni sekondar për çështjet të cilat ligji thotë se i rregullon akti nënligjor.

Andaj, KGJK duhet ta ketë parasysh që në secilin rast kur KGJK fillon draftimin e një akti nga legjislacioni sekondar, duhet ti përcaktojë kufijtë dhe detyrimet e saj përballë ligjit, dhe në kuptim të dispozitave ligjore të draftojë edhe rregulloren deri në masën që kërkohet me ligj, pavarësisht nëse volumi i aktit nënligjor do të jetë i vogël ose i madh.

3.5. Rregullore për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve

Më 10 janar 2019, ka hyrë në fuqi Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Neni 17 i këtij ligji përcakton se “Këshillat miratojnë rregulloret e parapara me këtë ligj, brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji”.

Në zbatim të këtij obligimi ligjor, KGJK në takimin e mbajtur me 27 maj 2019, ka miratuar Rregulloren 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

Kjo rregullore adreson kërkesat e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve përkitazi me sistemin e ri të disiplinimit që ka ndërtuar kjo rregullore.

Mbi bazën e Ligjit të ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregulloren për Procedurën Disiplinore për Gjyqtarë, KGJK më 12 qershor 2019, ka miratuar listën prej 70 gjyqtarëve të cilët do të funksionojnë në panelet hetimore⁸.

a) Kundërligjshmëria e rregullores përkitazi me ankesat anonime

KGJK me anë të kësaj rregulloreje ka vendosur që ta hudhë secilën ankesë të secilës palë i cili në raportimin e një shkeljeje disiplinore dëshiron të mbetet anonim.

Në paragrafin 2 të nenit 7 të rregullores përcaktohet se:

Ankesa hudhet siç është përcaktuar me nenin 9, paragrafi 6 i Ligjit, dhe kur autoriteti kompetent konstaton se ankesa është:

1. Anonime
2. Shkelja e supozuar është parashkruar

⁸ "KGJK-ja miraton listën prej 70 gjykatësve që do jenë në panele hetimore". Betimi për Drejtësi. 12 qershor 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/kgjk-ja-miraton-listen-prej-70-gjykatesve-qe-do-jene-ne-panele-hetimore/>). (qasur për herë të fundit më 29 korrik 2019).

Në paragrafin 3 të këtij neni të rregullores përcaktohet po ashtu se autoriteti kompetent e refuzon ankesën kur konstatohet se e njëjta është dukshëm jo serioze dhe e pabazuar.

KGJK me anë të këtij neni ka tejkeluar nenin 9, paragrafin 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i cili përcakton katër rrethana se kur autoriteti kompetent nuk kërkon fillimin e hetimeve nga KGJK.

Neni 9, paragrafi 6 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve përcakton se:

Autoriteti Kompetent sipas nenit 9, paragrafin 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12, paragrafin 2, përveç kur konstaton se ankesa është **dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar.**

Pra, në asnjërin prej këtyre rrethanave nuk përcaktohet se autoriteti kompetent nuk duhet të kërkojë fillimin e hetimeve në rastin kur kërkesa është anonime.

Për më tepër, në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në asnjë pjesë të saj nuk e përmban fjalën “anonime”.

Paragrafi 4 i nenit 9 të këtij ligji përcakton se ankesa duhet të përmbajë, ndër të tjera, edhe “identitetin e personit fizik ose juridik i cili e paraqet ankesën”. Por, kjo në asnjë rrethanë nuk mund të shërbejë si arsye që në rregullore të përcaktohet se autoriteti kompetent nuk vepron tutje nëse ankesa është anonime.

Aq më tepër, kur autoriteti kompetent është njoftuar lidhur me një shkelje të supozuar të një gjyqtari. Kjo për arsye se pas njoftimit të tij lidhur me një rrethanë në të cilën ka një shkelje të supozuar disiplinore, i njëjti mund të kërkojë nga KGJK fillimin e hetimeve edhe sipas detyrës zyrtare, pra, edhe sikur ankesa mos të kishte ekzistuar fare.

Përkritazi me këtë, paragrafi 2 i nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve përcakton se:

Autoriteti Kompetent kërkon nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore mbi bazën e një ankese të paraqitur nga një person fizik apo juridik dhe e cila nuk është hedhur poshtë sipas nenit 9, paragrafit 6 të këtij Ligji, **ose sipas detyrës zyrtare kur ka bazë të arsyeshme të besoj se një gjyqtar ose prokuror ka kryer shkelje disiplinore.**

Lidhur me këtë përcaktim të rregullores, IKD konsideron se është tërësisht e papranueshme që secila ankesa e cila është anonime të hudhet qysh në fillim nga autoriteti kompetent, aq më tepër kur në përmbajtjen e të njëjtës ankese mund të ketë dëshmi të qarta për një shkelje të supozuar disiplinore nga një gjyqtarë.

Në mënyrën se si funksionon aktualisht sistemi gjyqësor, është shumë normale që një person i caktuar të ketë frikë të ballafaqohet direkt me gjyqtarin i cili supozohet se ka kryer një shkelje disiplinore dhe si rrjedhojë i njëjti do preferojë të mbetet anonim. Në raste të tilla, ankesa mund të përmbajë shumë informacione, dhe nuk ka asnjë arsyetim ligjor dhe logjik me të cilin mund të konkludojmë se kjo ankesë nuk duhet të procedohet tutje. Nëse ankesa është anonime por edhe është e pabazuar dhe joserioze, ka baza të tjera të përcaktuara me ligj dhe rregullore me të cilat autoriteti kompetent mund ta hudhë poshtë në fillim ankesën. Por, jo që ta hudhë ankesën vetëm pse e njëjta është anonime, përkundër përmbajtjes së saj.

Po ashtu, fakti se parashtruesi i ankesës është i panjohur, pra ankesa është anonime, nuk e pengon në asnjë rrethanë zhvillimin e procedurës, pasi e njëjta mund të zhvillohet edhe pa parashtruesin e ankesës. Në kuptim të nenit 2.1.1.5 të Rregullores, palë në rastin konkret paraqitet vetë autoriteti kompetent.

Për këtë arsye, IKD kërkon nga KGJK të reflektojë përkitazi me këtë pjesë dhe të ndryshojë këtë rregullore, në atë mënyrë që të largojë këtë pjesë me anë të një rregulloreje për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores. Derisa në atë kohë, secili autoritet kompetent duhet të referohet ligjit dhe mos ta aplikojë këtë dispozitë kundërligjore të kësaj rregulloreje, pra, të procedojë tutje me ankesat, edhe nëse të njëjtat janë anonime.

3.6. Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 06/2016 për Trajnimin e Gjyqtarëve

KGJK në takimin e mbajtur me 27 maj 2019, ka nxjerrë rregullore me të cilën ka ndryshuar dhe plotësuar Rregulloren për Trajnimin e Gjyqtarëve të nxjerrë me 16 nëntor 2017.

Sipas Ligjit për KGJK-në, *“Këshilli mund të kërkojë rishikimin e cilitdo program trajnimi në mënyrë që të sigurohet zbatimi i politikave dhe standardeve për trajnimin profesional të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë”*.

Me anë të kësaj rregulloreje, KGJK ka caktuar numrin e trajnimeve që gjyqtarët duhet të mbajnë gjatë një viti kalendarik, ku numri i ditëve që gjyqtarët duhet të kalojnë në trajnim gjatë një viti dallon tek gjyqtarët varësisht përvojës së tyre.

Neni 2 i kësaj rregulloreje përcakton:

Gjyqtarët në bazë të përvojës, gjatë një viti kalendarik duhet të kalojnë në trajnim të paktën periudhën kohore si në vijim:

- 1.1. Gjyqtarët me përvojë pune si gjyqtar mbi 20 vite - 2 (dy) ditore.
- 1.2. Gjyqtarët me përvojë pune si gjyqtar nga 10 deri në 20 vite - 5 (pesë) ditore.
- 1.3. Gjyqtarët me përvojë pune si gjyqtar nga 5 deri në 10 vite - 6 (gjashtë) ditore.

1.4. Gjyqtarët me përvojë pune si gjyqtar nga 3 deri në 5 vite - 7 (shtatë) ditore.

Gjyqtarët duhet që të ndjekin trajnime për çështje të etikës profesionale në kohëzgjatje një (1) ditore, në bazë të periudhës kohore siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Ndër të tjera, kjo rregullore përcakton se mos përmbushja e obligimeve që dalin nga kjo rregullore është bazë për zhvillimin e procedurës disiplinore sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

3.7. Rregullore për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor

KGJK në takimin e 233-të, të mbajtur me 5 shtator 2019 ka miratuar Rregulloren Nr.07/2019 për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor.

Me anë të kësaj rregulloreje, KGJK ka përcaktuar procedurat e certifikimit dhe emërimit, kushtet, të drejtat dhe detyrimet për përkthyes dhe interpret gjyqësorë, lartësinë e shpërblimit për punën e tyre si dhe largimin nga regjistri.

a) Mungesa e mjeteve juridike

Sipas nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e drejta për mjete juridike është e garantuar. Ky nen përcakton se “*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj*”.

Në anën tjetër, neni 6, paragrafi 3 i rregullores përcakton se “*Komisioni i shqyrton të gjitha aplikacionet dhe e harton listën e kandidatëve, në të cilën përfshihen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 5 të kësaj rregulloreje. Kandidatët informohen brenda pesë ditëve dhe ftohen të marrin pjesë në fazat e tjera të procesit të përzgjedhjes*”.

Në këtë rast, rregullorja përcakton se procedura vazhdon me kandidatët e futur në listë, ndërsa nuk përcakton fare nëse kandidatët e tjerë të cilët nuk janë përfshirë në listë kanë të drejtën e ankesës.

Po ashtu, neni 11 i rregullores përcakton procedurën dhe rregullat për shpalljen e rezultateve të provimit me shkrim. Paragrafi 4 i këtij neni përcakton se “*Komisioni publikon listën e kandidatëve që kanë kaluar provimin me shkrim në ueb faqen e KGJK-së, në afat prej 10 (dhjetë) ditëve pas përfundimit të provimit me shkrim*”.

Në këtë rast, përkundër mundësive të mëdha që komisioni të ketë bërë gabime dhe shkelje me rastin e poentimit, për personat të cilët nuk janë futur në listën e kandidatëve që kanë kaluar provimit, nuk garantohet mjete juridik.

Në këtë drejtim, fakti se neni 14 përcakton procedurën e ankesës pas përfundimit të tërësishëm të këtij procesi nuk nënkupton se kandidatëve të pakënaqur duhet tu mohohet mjete juridik në gjithë procedurën. Në këtë drejtim, përpos që kufizohen të drejtat e njeriut për kandidatë të caktuar, KGJK rrezikon edhe vetë procesin. Në këtë kuptim, nëse kandidatëve të pakënaqur u ipet mjet juridik pas çdo faze kur të njëjtit diskualifikohen, KGJK në mënyrë të vazhdueshme siguron edhe ligjshmërinë e këtij procesi, duke u siguruar se procesi është duke shkuar në binarët e duhur.

b) Referimi i rregullores në ligjin e shfuqizuar

Në paragrafin 4 të nenit 14 të rregullores përcaktohet se *“Procedura e ankimit bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit për Procedurë Administrative”*.

Më 21 qershor 2017, ka hyrë në fuqi Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Neni 161 i këtij ligji ka përcaktuar se: *“Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, si dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë Ligj”*.

Në këtë mënyrë, Ligji për Procedurë Administrative, në të cilin ligj referon rregullorja në fjalë, është ligj tanimë i shfuqizuar me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

3.8. Rregullore për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve

KGJK, me 7 tetor 2019, ka miratuar Rregulloren nr.08/2019 për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktojë rregullat, rolin dhe detyrat e gjyqtarëve, si dhe stafit administrativ në përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) në punën e tyre gjatë procedimit të lëndëve përmes sistemit.

Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve sistemin për digjitalizimin e gjykatave në menaxhimin e lëndëve.

Lidhur me përdorimin e këtij sistemi, kjo rregullore ka përcaktuar përkufizimet, parimet, strukturën menaxhuese të këtij sistemi, përgjegjësinë për zbatimin e kësaj rregulloreje e deri tek aspektet e tjera teknike për përdorimin e këtij sistemi nga të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës.

3.9. Rregullore për Procedurën dhe Kriteret e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Gjyqësori

KGJK, me 27 dhjetor 2019, ka miratuar Rregulloren nr.09/2019 për Procedurën dhe Kriteret e Zgjedhjes së Anëtarëve të KGJK-së nga Gjyqësori.

Ligji nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka hyrë në fuqi më 10 janar 2019. Nxjerrja e kësaj rregulloreje ka qenë obligim sipas nenit 8, paragrafi 6 të këtij ligji.

Afati i fundit për nxjerrjen e kësaj rregulloreje ka qenë data 10 janar 2020. Pra, KGJK e ka miratuar këtë rregullore brenda afatit ligjor.

Me anë të kësaj rregulloreje, KGJK ka përcaktuar kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së nga radhët e gjyqësorit.

Lidhur me dy (2) anëtarët e KGJK-së nga Gjykata Supreme dhe dy (2) anëtarët e KGJK-së nga radhët e Gjykatës së Apelit, kjo rregullore ka përcaktuar se të njëjtit zgjidhen nga radhët e gjyqtarëve të gjykatës respektive.

Ndërsa, lidhur me tre (3) anëtarët e KGJK-së nga radhët e Gjykatave Themelore, kjo rregullore ka përcaktuar dy (2) procese të votimit. Fillimisht, kandidatët e nominuar brenda një Gjykate Themelore, votohen nga gjykata prej nga vinë. Në këtë rast, secila gjykatë mund të nominojë një kandidat. Pas kësaj, të nominuarit nga secila gjykatë themelore, i nënshtrohen votimit të përgjithshëm së të gjithë gjyqtarëve të shtatë (7) Gjykatave Themelore. Kandidati i cili merr shumicën e votave së të gjithë gjyqtarëve të Gjykatave Themelore, zgjidhet anëtar i KGJK-së nga radhët e Gjykatave Themelore.

Në anën tjetër, hartimi dhe miratimi i kësaj rregulloreje paraqet shembullin më të mirë të transparencës dhe bashkëpunimit me mediat, shoqërinë civile dhe publikun. Drafti i parë i kësaj rregulloreje është vendosur në konsultim publik, që palët e interesuara të paraqesin komentet e tyre. Mbi këtë ftesë, IKD ka paraqitur me shkrim komentet e saja, të cilat edhe janë inkorporuar në këtë rregullore.

Por, pasi që në këtë rregullore kishte edhe disa risi të tjera, KGJK e ka ridërguar draftin e kësaj rregulloreje edhe një herë për konsultim publik, duke ua dhënë mundësinë të gjitha palëve të interesuara që të paraqesin me shkrim komentet e tyre.

Sikurse është thënë edhe më lartë, IKD vlerëson lartë këtë praktikë të ndërtuar nga KGJK. Një praktikë e tillë për involvimin e të gjitha palëve që shprehin interes për procesin e draftimit të dokumenteve të ndryshme të sistemit gjyqësor paraqet transparencë dhe shembullin më të mirë të bashkëpunimit të një institucioni me shoqërinë civile. Për më tepër, duke vepruar në këtë mënyrë, edhe vet KGJK-së i mundësohet që të ketë një legjislacion sekondar të mirëfilltë dhe të qëndrueshëm.

Nisur nga kjo praktikë e ndërtuar, IKD konsideron se KGJK duhet që procesin për konsultim publik ta normojë me anë të një rregulloreje të veçantë për konsultime publike. Kjo rregullore do të normonte praktikën e mirë që ka ndërtuar KGJK, si dhe konsultimin publik do ta bënte pjesë obligative të pothuajse çdo dokumenti.

4. Llogaridhënia në sistemin gjyqësor dhe mekanizmat e kontrollit

IKD ka gjetur se gjatë vitit 2019, KGJK ka publikuar raportin vjetor të Gjykatave derisa pjesërisht, ka edhe një avansim në fushën e transparencës.

Obligimet ligjore të sistemit gjyqësor	Përbushur	Pa përbushur
Raporti vjetor i Punës së Gjykatave	X	
Raporti vjetor i Punës së KGJK-së		X
Vlerësimi i Performancës së Gjykatësve		X
Raportimi i Kryetarëve të Gjykatave para KGJK		X
Transparenca	Pjesërisht	
Themelimi i degëve të Gjykatës në Fushë Kosovë për Komunën e Fushë Kosovës dhe Komunën e Obiliqit; dega në Junik për Komunën e Junikut; dega e Hanit të Elezit për Komunën e Hanit të dhe dega në Shtime për Komunën e Shtimes		X

Tabela 1: Obligimet ligjore të përbushura dhe të pa përbushura të sistemit gjyqësor.

KGJK gjatë vitit 2019 ka publikuar raportin vjetor të punës së KGJK-së, por se këtë e ka bërë jashtë afatit ligjor. Po ashtu, KGJK gjatë vitit 2019 ka bërë edhe vlerësimin e performancës të një numri të gjyqtarëve, i cili numër nuk arrin 1/3 e gjithë gjyqtarëve të sistemit gjyqësor, ashtu siç edhe kërkohet me ligj.

Lidhur me raportimin e Kryetarëve të Gjykatave, KGJK ka ftuar të njëjtit për të raportuar para anëtarëve të KGJK-së, por jo rregullisht dhe periodikisht, ashtu siç është e përcaktuar.

Transparenca vazhdon të mbetet sfidë për sistemin gjyqësor, ku ndonëse ka një progres relativ, gjetjet tregojnë se zbatimi i plotë i këtij parimi nga sistemi gjyqësor ende nuk është arritur. bazë në praktikë mbetet ende sfidues.

Në anën tjetër, me Ligjin e ri për KGJK-në janë shtuar edhe degë të reja të cilat KGJK ka për obligim që ti themelojë, derisa janë edhe një numër i degëve të gjykatave që KGJK ka pasur obligim ti themelojë qysh sipas ligjit të vjetër. Sidoqoftë, KGJK ende nuk ka themeluar edhe katër (4) degë të gjykatave të përcaktuara me ligj, aspekt ky që drejt për së drejti ndikon në të drejtën e qytetarëve për qasje në drejtësi.

Më poshtë janë analizuar në detaje (mos) zbatimi i obligimeve ligjore të KGJK-së.

4.1. Raporti Vjetor i Punës së KGJK-së për vitin 2018

KGJK ka qenë e obliguar që të miratojë Raportin Vjetor të Punës së KGJK-së për vitin 2018⁹.

Ky raport është një nga dokumentet më të rëndësishme, sepse përveç që pasqyron punën një vjeçare të KGJK-së dhe Gjykatave, duke e përmbushur një obligim kushtetues dhe ligjor, njëkohësisht e informon publikun mbi punën dhe aktivitetet e zhvilluara me qëllim të forcimit të sistemit të gjyqësisë në vend.

KGJK nuk kishte arritur që deri më 31 mars 2019 të miratojë raportin vjetor të punës për vitin 2018¹⁰. Madje, KGJK deri më 30 janar 2019, nuk kishte marrë as vendim që të përcaktojë përmbajtjen e raportit vjetor¹¹. KGJK është dashur që të sigurojë projekt raportin deri në fund të muajit mars 2019¹².

Në këtë drejtim, duke shkelur këto afate, përpos mos përmbushjes së obligimeve ligjore, KGJK nuk ka respektuar as rregulloret të cilat vetë i ka miratuar.

Sidoqoftë, ky raport ishte miratuar në takimin e KGJK-së të mbajtur me 5 prill 2019¹³, që nënkupton se i njëjti nuk është miratuar brenda afatit ligjor.

IKD e vlerëson si shumë shqetësuese dhe të panevojshme vonesën e KGJK-së në rastet të tilla. Përderisa ky institucion u bënë thirrje vazhdimisht gjyqtarëve që të veprojnë sipas afateve ligjore, shkelja e afateve ligjore nga vetë KGJK përçon shembull të keq për të gjithë gjyqtarët. Për këtë arsye, KGJK duhet që obligimet e saja bazike ti përfundojë brenda afateve ligjore.

4.2. Raporti i punës së gjykatave për vitin 2018

Sekretariati i KGJK-së gjatë vitit 2019 kishte publikuar Raportin Statistikor të Gjykatave për vitin 2018. Ky raport pasqyron punën e gjykatave në Kosovë, përveç Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Leposaviq dhe Zubin Potok.

Raporti i publikuar pasqyron lëndët sipas llojeve në çdo gjykatë respektive, si dhe një analizë lidhur me ngarkesën e gjykatësve me lëndë, duke përfshirë efikasitetin e gjykatësve në zgjidhjen e lëndëve të rënda dhe të lehta, si dhe mesataren më lëndë të ngarkuara në nivel vendi.

⁹ Ligji nr.06/L-055 për KGJK-në, neni 7, paragrafi 1.22

¹⁰ KGJK ka miratuar raportin e saj vjetor me 5 prill 2019.

¹¹ "Rregullore mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e KGJK-së". KGJK., Miratuar më 2 dhjetor 2012, neni 35.1

¹² Po aty, neni 35, paragrafi 4

¹³ Raporti Vjetor 2018. KGJK. 5 prill 2019. (e arritshme në: http://ëëë.gjyqesori-rks.org/ëp-content/uploads/reports/96799_KGJK_RAPORTI_VJETOR_2018_SHQ.pdf). (Qasur së fundi më 22 korrik 2019).

Sipas raportit të publikuar nga Sekretariati i KGJK-së, del se gjykatat themelore dhe degët e tyre në të gjitha lëmitë penale, civile, administrative dhe ekonomike kanë pasur 352 gjykatës në tërë vendin dhe 1,613 personel mbështetës, gjatë vitit 2018.

Të gjitha Gjykatat Themelore në Kosovë kanë pasur në punë gjatë vitit 2018, 425,914 lëndë të të gjitha natyrave, prej tyre kanë trashëguar nga vitet paraprake 307,513 lëndë, kurse vetëm në vitin 2018, gjykatat kanë pranuar në punë 118,401 lëndë të reja. Gjykatat Themelore gjatë vitit 2018, kanë zgjidhur gjithsej 180,290 lëndë, ndërsa të pazgjidhura kanë mbetur 245,515 lëndë.

Raporti në fjalë tregon se mesatarisht një gjykatës i gjykatës themelore është ngarkuar me 23.6 lëndë në muaj, përderisa gjykatësit mesatarisht kanë zgjidhur 25 lëndë në muaj, respektivisht 106 % (përqind) të normës orientuese.

Përpos të dhënave statistikore që ofron ky raport, i njëjti nuk sqaron asgjë më shumë dhe qasja analitike dhe krahasuese e tij është zero. Në këtë drejtim, publiku përmes këtij raporti as nuk mund ta dijë nëse numri i lëndëve që janë në sistem gjyqësor është i menaxhueshëm nga ky i fundit ose jo. Për më tepër, për punën e gjykatave, ky raport nuk tregon shumë aspekte kryesore për administrimin e mirë të gjykatave, siç janë transparenca, llogaridhënia, trendi i progresit etj., por vetëm jep të dhëna statistikore. Është e vërtetë se në këtë raport janë të gjitha të dhënat statistikore për numrin e lëndëve për secilën gjykatë dhe degë të gjykatave, por përmes këtij raporti ekskluzivisht statistikor, publiku i interesuar, në asnjë rrethanë, nuk mund të jetë i informuar lidhur me punën dhe performancën e gjykatave në Republikën e Kosovës.

Raporti i publikuar nga Sekretariati i Këshillit është publik dhe në të kanë qasje të gjitha palët e interesuara¹⁴.

4.3. Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe masat disiplinore

Ligji i aplikueshëm që rregullon kontrollin dhe ngritjen e llogaridhënies në sistemin gjyqësor për gjykatës ka paraparë mekanizmin e vlerësimit të performancës për gjykatës dhe mekanizmin e disiplinimit të gjykatësve në rastet kur të njëjtit vepron në kundërshtim me Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjykatës.

Neni 16.1.2 i Ligji për KGJK-në ka përcaktuar themelimin e Komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.

KGJK, më 30 gusht 2016, kishte miratuar Rregulloren Nr.11/2016 për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve. Kjo rregullore përcakton procedurat dhe kriteret e vlerësimit të performancës së gjykatësve të gjitha niveleve në Kosovë. Kjo Rregullore është plotësuar me Rregulloret 02/2017, 10/2017 dhe me 01/2019.

¹⁴Raporti statistikor i Gjykatave – Vjetor 2018”. KGJK. (shih linkun: <http://gjyqesori-rks.org/GetDocument/15477>). (qasur së fundi më 28 mars 2019).

Po ashtu, KGJK më 6 tetor 2016, kishte themeluar edhe Komisionin për Vlerësimin e Performancës për Gjykatës, i cili përbëhet nga 14 gjykatës prej të gjitha niveleve të gjykatave.

Në raportin e IKD-së mbi monitorimin e punës së KGJK-së për tremujorin e parë të vitit 2019, kishte gjetur se KGJK nuk kishte bërë si duhet planifikimin për numrin e gjyqtarëve të cilët do ti nënshtrohen vlerësimit të performancës. Kjo për arsye se KGJK ka planifikuar që gjatë vitit 2019 të bëjë vlerësimin e performancës për 42 gjyqtarë¹⁵, derisa numri total i gjyqtarëve në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës është 429, përfshirë numrin e gjykatësve me mandat fillestar.

KGJK obligohet që të bëjë vlerësimin e 1/3 së gjyqtarëve, në mënyrë që çdo tre (3) vjet, të bëhet vlerësimi i performancës për të gjithë gjyqtarët.

1/3 e të gjithë gjyqtarëve që aktualisht bëjnë pjesë në sistem gjyqësor është gjithsej 143 gjyqtarë, përfshirë gjykatësit me mandat fillestar që mund të jenë subjekt i vlerësimit të performancës.

Përpos gjyqtarëve të cilët sipas metodës *random* i janë nënshtuar procesit të vlerësimit të performancës, KGJK gjatë vitit 2019 ka bërë vlerësimin e performancës edhe për 33 gjyqtarë të tjerë të cilët kanë aplikuar për avancim brenda sistemit gjyqësor si dhe për pesë (5) gjyqtarë të tjerë me mandat fillestar.

Sa i përket disiplinimit të gjyqtarëve, më 10 janar të vitit 2019, ka hyrë në fuqi Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sa i përket procedurave disiplinore të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ky ligj në nenin 17.3 ka përcaktuar se “*Procedurat disiplinore të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë dhe përfundojnë në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi, në kohën e fillimit të hetimit disiplinor dhe do të përfundojnë brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji*”.

Për këtë arsye, gjatë kësaj kohe në KGJK janë zhvilluar edhe procedurat disiplinore sipas ligjit të vjetër por edhe procedurat disiplinore të bazuara në Ligjin e ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Sa i përket disiplinimit të gjyqtarëve, më 10 janar të vitit 2019, ka hyrë në fuqi Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Për të përmbushur obligimet ligjore që dalin nga ky ligj, KGJK me 30 maj 2019 ka miratuar Rregulloren nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

Sa i përket procedurave disiplinore të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, po ky ligj në nenin 17.3 ka përcaktuar se “*Procedurat disiplinore të filluara para hyrjes*

¹⁵ *Sqarim*: Në procesin për avancimin e Gjyqtarëve në Departamentet Speciale, kandidat kanë qenë edhe 2 gjyqtarë të cilët kanë qenë të përfshirë në këtë numër. Pasi vlerësimi i performancës për të njëjtit ka përfunduar gjatë procesit për avancim në detyrë, numri i gjyqtarëve që do ti nënshtrohen procesit të vlerësimit të performancës sipas metodës *random* ka rënë në 40. “*Përgjigje elektronike nga KGJK*”. 21 nëntor 2019.

në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë dhe përfundojnë në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi, në kohën e fillimit të hetimit disiplinor dhe do të përfundojnë brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

Për këtë arsye, gjatë kësaj kohe në KGJK janë zhvilluar edhe procedurat disiplinore sipas ligjit të vjetër por edhe procedurat disiplinore të bazuara në Ligjin e ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Më 1 janar 2019, Komisioni Disiplinor i KGJK-së nuk ka pasur në punë asnjë rast, derisa deri kur ka filluar të zbatohet Ligji i ri për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka pranuar tri (3) lëndë të reja, të cilat lëndë i ka zgjidhur duke marrë këto vendime:

Lloji i vendimit/masës disiplinore	Numri i vendimeve
Lirim nga përgjegjësia disiplinore	1 vendim
Ulje e pagës 30% në kohëzgjatje prej 3 muajve	1 vendim
Ulje e pagës 30% në kohëzgjatje prej 6 muajve	1 vendim
Totali	3 vendime

Tabela 2 – Masat Disiplinore të shqiptuara nga KD i KGJK-së.

Si shkallë e dytë, KGJK ka pranuar vetëm një ankesë ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor, të cilën ankesë e ka refuzuar si të pabazuar.

Ndërsa, duke u bazuar në Ligjin e ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, KGJK gjatë vitit 2019 ka pranuar gjithsej 16 kërkesa për themelimin e paneleve hetimore¹⁶, ku në të gjitha këto raste, KGJK ka themeluar edhe panelet hetimore.

Në gjashtë (6) prej këtyre rasteve, KGJK gjatë vitit 2019 ka nxjerrë katër (4) vendime:

¹⁶ *Sqarim:* Në dy prej këtyre rasteve, KGJK ka nxjerrë vendim për suspendimin e gjyqtarëve nga detyra, me ç’rast ka ndërprerë afatin e parashkrimit dhe ka pezulluar procedurën disiplinore.

Lloji i vendimit/masës disiplinore	Numri i vendimeve
Lirim nga përgjegjësia disiplinore	1 vendim
Vërejtje jopublike me shkrim	2 vendime
Ulje e pagës 30% në kohëzgjatje prej 3 muajve	1 vendim
Totali	4 vendime

Tabela 3 – Masat Disiplinore të shqiptuara nga KGJK sipas procedurave të Ligjit të ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në anën tjetër, KGJK tanimë ka filluar që vendimet disiplinore si të plotë dhe të pa anonimizuara ti bëjë publike në faqen e saj zyrtare. Zbatimi i këtij obligimi ligjor nga KGJK paraqet një progres të theksuar në transparencën e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës.

4.4. Raportimi i Kryetarëve të Gjykatave para Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Bazuar në Ligjin nr.06/L-054 për Gjykatat, neni 14.2.4, kryetari i gjykatës në baza vjetore i dërgon këshillit një raport mbi suksesin e zbatimit të planit të mëparshëm vjetor për menaxhimin e lëndëve. Po ashtu, neni 14.2.5 i këtij ligji përcakton se kryetari i gjykatës i dërgon këshillit raport tremujor me shkrim, që adreson punën e gjykatës, identifikon çfarëdo probleme me të cilat ballafaqohet gjykata, si dhe propozon hapa riparues për të adresuar problemet e identifikuara.

Këto obligim ligjor, KGJK nuk e ka përmbushur ashtu siç kërkohet me ligj.

Në tremujorin e parë të vitit 2019, KGJK nuk kishte ftuar asnjë prej kryetarëve të gjykatave për të raportuar para anëtarëve të KGJK-së.

Por, në një takim të vetëm, KGJK më 8 maj 2019 kishte ftuar të gjithë kryetarët e gjykatave për të raportuar për vitin 2018, si dhe për tremujorin e parë të vitit 2019.

Në tremujorin e tretë, KGJK nuk kishte ftuar asnjë prej kryetarëve të gjykatave për të raportuar para anëtarëve të KGJK-së.

Ndërsa, më 25 tetor 2019, KGJK kishte ftuar të gjithë kryetarët e gjykatave që në një takim të vetëm, të raportojnë për tremujorin e dytë dhe tremujorin e tretë të vitit 2019.

Lidhur me raportimin e kryetarëve të gjykatave para anëtarëve të KGJK-së, IKD i rikujton KGJK-së se ky raportim hyn në kuadër të mekanizmave të kontrollit që KGJK ka në dispozicion për të mbajtur përgjegjës gjykatat.

Ky obligim ligjor duhet të zbatohet në përpikëri ashtu siç e përcakton ligji. Pra, raportimi duhet të bëhet çdo tre (3) muaj, dhe jo çdo gjashtë (6) muaj duke raportuar kështu njëkohësisht për dy tremujorë. Pra, KGJK duhet ta ketë parasysh se bëhet fjalë për raportim të vazhdueshëm çdo tre (3) muaj.

Vetë ideja e raportimit të kryetarëve të gjykatave në këtë mënyrë është që KGJK të jetë e njoftuar vazhdimisht mbi gjendjen e gjykatave të cilat i ka nën menaxhim, në mënyrë që të përcjell gjendjen dhe në çdo devijim eventual, të marrë masat e përcaktuara brenda kompetencave të këtij institucioni. Thënë ndryshe, raportimi i kryetarëve të gjykatave nuk është një obligim formal, por është një mekanizëm që nëse aplikohet si duhet, mban përgjegjës dhe llogaridhënës gjitha gjykatat, nëpërmjet kryetarëve të këtyre gjykatave.

IKD vlerëson se mos ftesa e kryetarëve të gjykatave nga KGJK sipas përcaktimeve ligjore për të raportuar për punën e gjykatave të tyre është dështim i mekanizmave të KGJK-së për mbajtjen llogaridhënës dhe transparent të gjykatave, çka paraqet edhe ikje nga përgjegjësia e të KGJK-së në ushtrimin e kompetencave ligjore të saj.

Për këtë arsye, sikurse edhe në raportet e kaluara, IKD i bënë thirrje KGJK-së që seriozisht ta trajtojë këtë obligim ligjor dhe që të ftojë në mënyrë të vazhdueshme, ashtu siç kërkohet me ligj, kryetarët e gjykatave për të raportuar para anëtarëve të KGJK-së.

4.5. Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor

Në përgjithësi, sistemi gjyqësor edhe në vitin 2019 ka pasur një progres relativ në fushën e transparencës, nëse kjo pjesë krahasohet me të dhënat nga periudhat paraprake. Ky progres është vazhdimësi e progresit që KGJK ka pasur vit pas viti në fushën e transparencës. Por, nëse të dhënat e mëposhtme krahasohen me obligimet që sistemi gjyqësor ka sipas ligjit, atëherë të dhënat tregojnë se përmbushja e plotë e obligimit të sistemit gjyqësor për transparencë ende nuk është arritur.

Lidhur me transparencën e sistemit gjyqësor përballë kërkesave për qasje në informata dhe dokumente publike, IKD ka gjetur se sistemi gjyqësor ka një ngritje të lehtë pozitive, ku në bazë të raporteve të IKD-së mbi punën e sistemit gjyqësor, del se për çdo vit ka progres këtë drejtim.

IKD gjatë monitorimit të sistemit gjyqësor, gjatë vitit 2019, ka adresuar në sistemin gjyqësor 491 kërkesa për qasje në informata dhe dokumente publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore, ofrimit të informacioneve, statistikave dhe të dhënave tjera të disponueshme dhe lejueshme sipas Ligjit mbi Qasje në Dokumente Publike.

Përgjithësisht, në këtë fushë të transparencës, gjetjet e IKD-së tregojnë se sistemi gjyqësor ka një nivel të transparencës në rreth 65%, derisa përqindja tjetër e totalit duhet të adresohet nga sistemi gjyqësor, në mënyrë që i njëjti të arrijë transparencë të plotë.

Nga 491 kërkesat për qasje në dokumente publike, Këshillit Gjyqësor të Kosovës i janë drejtuar 53 kërkesa, prej të cilave IKD ka pranuar 31 përgjigje pozitive apo në përqindje del

të jetë 58.49%, pesë (5) përgjigje negative apo 9.43% të kërkesave, derisa në 17 kërkesa apo në 32.07 % të kërkesave nuk ka pranuar fare përgjigje.

Nga 491 kërkesat për qasje në dokumente publike, Gjykatave të Republikës së Kosovës i janë drejtuar gjithsej 438 kërkesa, prej të cilave IKD ka pranuar 276 përgjigje pozitive apo në përqindje del të jetë 63.01%, 27 përgjigje negative apo në 6.16.% të tyre, ndërsa në 135 apo 30.82 % të kërkesave nuk ka pranuar përgjigje.

Lidhur me publikimin e legjislacionit sekondar, IKD ka gjetur se në ueb faqen zyrtare të KGJK-së ka ende vendime dhe rregullore të vitit 2018, të cilat ende nuk janë publikuar.

Lidhur me legjislacion sekondar të KGJK-së të nxjerrë gjatë vitit 2019, KGJK ka publikuar të gjitha rregulloret, derisa nuk ka publikuar gjithsej 50 vendime, 45 prej të cilave i përkasin tremujorit të parë të vitit 2019. Pra, në periudha të ndara, KGJK në këtë fushë të transparencës ka performuar shumë mirë në nëntë (9) mujorin e fundit të vitit 2019, derisa qalime në këtë fushë ka pasur në tre (3) mujorin e parë të këtij viti.

Në anën tjetër, gjatë vitit 2019, IKD ka evidentuar edhe praktikë të fshirjes së vendimeve të KGJK-së nga ueb faqja e saj zyrtare, pasi që të njëjtat janë publikuar. Kjo situatë ka ndodhur me vendimet nr.211/2019, 212/2019, 213/2019, 214/2019 dhe 215/2019.

Po ashtu, gjatë vitit 2019, KGJK nuk ka njoftuar në secilin rast publikun, mediat dhe shoqërinë civile për takimet e saja publike.

Neni 14 i Ligjit nr. 06/L-055 për KGJK-në përcakton se takimet e Këshillit janë të hapura për publikun dhe se rendi i ditës së Këshillit do të jetë publikisht i hapur së paku dyzet e tetë (48) orë para takimit.

Ky obligim ligjor i KGJK-së nuk është respektuar në takimin e 212-të të KGJK-së, për të cilin takim, KGJK nuk ka lajmëruar fare.

Obligimi ligjor nga KGJK nuk është respektuar as në takimin e 214-të të saj, për të cilin takim, ftesa dhe rendi i ditës janë publikuar në faqen zyrtare të KGJK-së gjatë kohës kur pothuajse veç kishte përfunduar ky takim.

Obligimin ligjor që rendi i ditës të publikohet 48 orë para takimit, KGJK nuk e ka zbatuar as sa i përket takimit të 210 dhe 213 që ka mbajtur. Për takimin e 210-të, KGJK ka publikuar rendin e ditës pak orë para se ai të mbahej, ndërsa për takimin e 213-të, KGJK e ka bërë publike rendin e ditës vetëm një ditë para se të mbahej takimi.

Sikurse në rastin e publikimit të legjislacionit sekondar, IKD të gjitha këto raste i ka evidentuar në tremujorin e parë të vitit 2019, derisa kjo praktikë nuk është përsëritur në pjesën tjetër të vitit 2019.

Në këtë rast, IKD vlerëson progresin e transparencës në sistemin gjyqësor, veçanërisht për pjesën pas tre (3) mujorit të parë të vitit 2019. Për më tepër, është për tu vlerësuar edhe vetë mbajtja e progresit që sistemi gjyqësor ka arritur vit pas viti.

Por, IKD i rikujton sistemit gjyqësor në përgjithësi dhe KGJK-së në veçanti, se transparenca është parim i punës së sistemit gjyqësor. Për këtë arsye, në secilin rast të punës jo transparente, më së paku mund të themi se cenohet një parim. Andaj, KGJK duhet ta ketë parasysh se indikatorët e qartë matës të transparencës duhet ti ngrisë edhe në pjesën e mbetur, për të zbatuar obligimet që ky sistem ka.

Për më tepër, IKD i rikujton sistemit gjyqësor se transparenca është njëra ndër format më të rëndësishme të ngritjes së besimit të publikut në sistemin gjyqësor, i cili fakt, krahas obligimit ligjor, duhet të shërbejë si motiv për ngritjen e transparencës në sistemin gjyqësor.

4.6. Avancimi dhe transferimi i Gjykatësve

Në takimin e 215-të të mbajtur me 5 prill 2019, KGJK ka nxjerrë vendim me anë të së cilit 6 gjyqtarëve ua ka vazhduar transferimin në gjykata tjera edhe për 1 vit:

- Mileva Tomovic, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë e transferuar në Gjykatën Themelore Pejë – dega Klinë;
- Gordana Virijevic, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë e transferuar në Gjykatën Themelore Mitrovicë;
- Boban Aleksic, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë i transferuar në Gjykatën Themelore Gjilan – Dega në Novobërdë
- Servet Morina, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Ferizaj – dega Shtërpcë e transferuar ne Gjykatën Themelore Prizren;
- Nushe Kuka Mekaj, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Pejë e transferuar ne Gjykatën Themelore Prishtinë;
- Lutfi Shala, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjakove – dega Malishevë i transferuar ne Gjykatën Themelore Prishtinë;

Sa i përket gjyqtarit Lutfi Shala, në Gjykatën Themelore në Gjakovë i njëjti shërben në Departamentin e Përgjithshëm, ndërsa në Gjykatën Themelore të Prishtinës, si i transferuar, i njëjti shërben në Departamentin për Krime të Rënda. Në këtë mënyrë, KGJK edhe gjatë kësaj periudhe nuk e ka bërë të qartë dallimin në mes të transferimit dhe avansimit të gjyqtarëve, në atë mënyrë që në këtë rast, ka avansuar një gjyqtarë pa konkurs, në emër të transferimit¹⁷.

¹⁷ Shih për më tepër rreth kësaj çështje: “Pavarësia, Efikasiteti, Llogaridhënia dhe Integriteti i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 29 janar 2019. (shih linkun: <https://kli-ks.org/ep->

4.7. Monitorimi i takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovë

KGJK nga 1 janari 2019 e deri më 31 dhjetor 2019, ka mbajtur gjithsej 19 takime, që në mesatare i bie se KGJK ka mbajtur nga 1.58 takime në muaj. Po ashtu, gjatë vitit 2019, KGJK ka mbajtur edhe dy (2) takime të jashtëzakonshme.

Por, KGJK nuk ka mbajtur asnjë takim në muajin mars dhe në muajin gusht të vitit 2019. Ky fakt paraqet shkelje të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e KGJK-së, përkatësisht nenit 38 ku thuhet se “Kryesuesi do të përcaktojë planin vjetor për takimet e Këshillit. Këshilli zakonisht mban takime një herë në muaj...”.

Po ashtu, në tre (3) mujorin e parë të vitit 2019, IKD kishte gjetur se KGJK nuk kishte miratuar fare planin vjetor për takimet e këshillit, obligim ky i përcaktuar në nenin 38 të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e KGJK-së.

Ky plan vjetor është miratuar në tre (3) mujorin e dytë të këtij viti, përkatësisht me 5 prill 2019.

Pika 3 e këtij vendimi obligon sekretariatit e KGJK-së që ta publikojë planin vjetor të takimeve në ueb faqen e këshillit, obligim të cilin nuk e ka përmbushur sekretariati i KGJK-së.

4.7.1. Diskutimet e anëtarëve të KGJK-së gjatë miratimit të politikave

IKD ka monitoruar në detaje të gjitha takimet e KGJK-së, përfshirë pjesëmarrjen në diskutim nga të gjithë anëtarët e Këshillit.

Në këtë drejtim, IKD gjen se në KGJK ka një përfshirje më të madhe të numrit të anëtarë në debat, por se prapë se prapë, thelbi i diskutimeve në KGJK vazhdon të mbetet tek disa anëtarë më aktiv.

Gjatë vitit 2019, anëtarja më pasive e KGJK-së ka qenë Radojka Trifunoviq, derisa ka munguar debati sasior edhe nga anëtarët e tjerë si Anita Prenaj-Krasnqi, Gjimeshit Galushi, Cerim Fazliji, Nenad Laziq dhe Manushe Karaqi.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2019, debati në KGJK është mbajtur kryesisht nga Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj, zëvendës kryesuesja e KGJK-së, Makifete Saliuka dhe anëtarët e KGJK-së Armend Berisha dhe Muhamet Rexha.

Ajo çka është vërejtur në këtë pjesë, është roli dhe kontributi ekstremisht i zbehtë i anëtarit të KGJK-së, Nehat Idrizi, pas përfundimit të mandatit të tij si kryesues i KGJK-së.

Në vazhdim janë paraqitur të gjitha mbledhjet, në të cilët përfshihen vendimet e marra:

<content/uploads/2019/01/Raporti-KGJK-KPK-2018-Final-29.01.2019-1.pdf>). (Qasur së fundi më 22 korrik 2019).

- **KGJK takimin e parë në vitin 2019, e ka mbajtur më 10 janar 2019 apo mbledhjen e 210-të.** Gjatë këtij takimi, KGJK ka shqyrtuar situatën e krijuar pas bojkotit të avokatëve, i cili kishte ardhur pas një rekomandimit të KGJK-së të datës 28 dhjetor 2018. KGJK gjatë këtij takimi ka marrë vendim që brenda një afati të arsyeshëm kohor të nxjerrë norma unike lidhur me këtë çështje. Po ashtu, gjatë këtij takimi, KGJK ka nxjerrë vendim për pezullimin e punës së gjyqtarit për tre (3) anëtarët të cilët sipas ligjit të ri të KGJK-së, do të angazhohen me orar të plotë në KGJK, ka caktuar u.d. të Gjyqtarit Mbikëqyrës të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë, ka hapur konkursin për Gjyqtar Mbikëqyrës të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë si dhe me votim të hapur ka caktuar gjyqtaren Liljana Stefanovic për Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Zubin Potok¹⁸.
- **KGJK takimin e dytë në vitin 2019, e ka mbajtur më 24 janar 2019 apo mbledhjen e 211-të.** Gjatë këtij takimi, KGJK ka miratuar plotësim/ndryshimin e Rregullores për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, ka caktuar Gjyqtarin Sami Sharaxhiu për nënkryetar të Gjykatës Themelore në Pejë, ka caktuar Gjyqtarin Faton Bajrami për përfaqësues të Gjykatave Themelore në Këshillin Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, ka ndryshuar emërtimin e Njesisë së Shqyrtimit të Performancës Gjyqësore në “Njësia për Inspektim Gjyqësor” si dhe ka marrë vendim që nga data 1 shkurt 2019 të publikohen statistikat mujore të punës së gjykatësve. Po ashtu, KGJK gjatë këtij takimi ka miratuar rekomandimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës që KGJK në bashkëpunim me MD të fillojë hartimin e draft-ligjit për statusin e gjyqtarëve, ka miratuar rekomandimin e ZAP lidhur me trajtimin me prioritet të lëndëve që kanë të bëjnë me mjedisin si dhe ka miratuar udhëzuesin e përgatitur nga Projekti për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë, që ka të bëjë me përdorimin e rrjeteve sociale nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve¹⁹.
- **KGJK takimin e tretë në vitin 2019, e ka mbajtur më 31 janar 2019 apo mbledhjen e 212-të.** KGJK gjatë këtij takimi ka marrë vendim për paraqitjen e nominimeve për kryesues të ri të KGJK-së, ka urdhëruar Komisionin për Çëshjte Normative të KGJK-së për hartimin e draft udhëzuesit për funksionalizimin e Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë si dhe ka diskutuar lidhur me projektligjin për pagat²⁰.
- **KGJK takimin e katërt në vitin 2019, e ka mbajtur më 14 shkurt 2019 apo mbledhjen e 213-të.** Gjatë këtij takimi, KGJK ka zgjedhur për kryesues të ri anëtarin

¹⁸"KGJK-ja s'e anulon vendimin paraprak, por merr vendim që të nxjerr rregulla të reja për qasjen e avokatëve në gjykata". Betimi për Drejtësi. 10 janar 2019. <https://betimiperdrejtesi.com/kgjk-ja-se-anulon-vendimin-paraprak-por-merr-vendim-qe-te-nxjerr-rregulla-te-reja-per-qasjen-e-avokateve-ne-gjykata/> (qasur për herë të fundit më 31 mars 2019).

¹⁹"KGJK miraton ndryshimin e rregullores për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, e cila parasheh shkarkim e atyre që notohen dobët". Betimi për Drejtësi. 24 janar 2019. <https://betimiperdrejtesi.com/kgjk-miraton-ndryshimin-e-rregullores-per-vleresimin-e-performances-se-gjyqtareve-e-cila-parasheh-shkarkim-e-atyre-qe-notohen-dobet/>. (qasur për herë të fundit më 31 mars 2019).

²⁰"Anëtarët e KGJK-së e vlerësojnë të padrejtë trajtimin e tyre në Projektligjin për Pagat". Betimi për Drejtësi. 31 janar 2019. <https://betimiperdrejtesi.com/anetaret-e-kgjk-se-e-vleresojne-te-padrejte-trajtimin-e-tyre-ne-projektligjin-per-pagat/>. (qasur për herë të fundit më 31 mars 2019).

e KGJK-së, Skender Çoçaj. Çoçaj gjatë këtij takimi ka marrë gjithsej 6 vota, 1 më shumë se kundër kandidati dhe ish-kryesuesi Nehat Idrizi, i cili ka marrë 5 vota²¹.

- **KGJK takimin e pestë në vitin 2019, e ka mbajtur më 21 shkurt 2019 apo mbledhjen e 214-të.** KGJK këtë takim e ka mbajtur larg syve të publikut, pasi për mbajtjen e këtij takimi ka njoftuar gjatë kohës kur pothuajse ky takim veç ka përfunduar. Gjatë këtij takimi, KGJK ka autorizuar Kryetarët e Gjykatave për ushtrimin e përgjegjësive sipas U.A. të KGJK-së për delegimin e kompetencave, ka caktuar Gjyqtarin Nikollë Komani si nënkryetar të Gjykatës Themelore në Gjakovë, ka caktuar Gjyqtarin Artan Sejrani si nënkryetar të Gjykatën Themelore në Prizren, ka caktuar Gjyqtarin Arben Hoti si anëtar të Panelit për Lirim me Kusht si dhe i ka propozuar Akademisë së Drejtësisë emrat e Gjyqtarëve për mentorë të Gjyqtarëve të porsaemëruar.
- **KGJK takimin e gjashtë në vitin 2019 e ka mbajtur me 5 prill 2019, apo takimin e 215-të.** Gjatë këtij takimi, KGJK ka hapur konkurs për një gjyqtarë në Gjykatën e Apelit – Divizioni në Mitrovicë, ka marrë vendim që gjyqtarëve me mandat fillestar të cilët ndjekin trajnimin fillestar në akademinë e drejtësisë tu ndahen lëndë për gjykim në proporcion prej 1/3 në raport me gjyqtarët e tjerë si dhe ka miratuar vendimin për trajtimin e lëndëve të PSRK në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe Gjykatën e Apelit deri në funksionalizimin e Departamentit Special. Në këtë takim KGJK ka miratuar Rregulloren për rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga Detyra të Gjyqtarëve Porotë, raportin vjetor të punës së KGJK-së për vitin 2018, raportin vjetor të punës së SKGJK-së për vitin 2018, raportin vjetor të punës së NjShPGj-së për vitin, 2018 si dhe orarin vjetor të takimeve të KGJK-së për vitin 2019. Po ashtu, gjatë këtij vendimi, KGJK ka vendosur që 5 gjyqtarëve tanimë të transferuar, t’ua vazhdojë transferin edhe për një vit.
- **KGJK takimin e shtatë në vitin 2019 e ka mbajtur me 23 prill 2019, apo takimin e 216-të.** Në këtë takim, KGJK ka miratuar Rregulloren për Organizimin dhe Funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, ka shpallur konkurs për gjyqtarët në këto departamente si dhe ka themeluar komisionin për përzgjedhjen e Gjyqtarëve të Departamentit Special.
- **KGJK takimin e tetë në vitin 2019 e ka mbajtur me 8 maj 2019, apo takimin e 217-të.** Gjatë këtij takimi, para anëtarëve të KGJK-së kanë raportuar Kryetari i Gjykatës së Apelit dhe 7 kryetarët e Gjykatave Themelore. Kryetarët e Gjykatave para anëtarëve të KGJK-së kanë raportuar për vitin 2018 si dhe për tremujorin e parë të vitit 2019. Po ashtu, KGJK gjatë këtij takimi ka miratuar Rregulloren për Procedurën e Ndërmjetësisimit të Lëndëve të Gjykatave.
- **KGJK takimin e nëntë në vitin 2019 e ka mbajtur me 24 maj 2019, apo takimin e 218-të.** KGJK këtë takim e ka mbajtur më 24 dhe më 27 maj. Kjo për arsye se më 24 maj, KGJK ishte detyruar që ta ndërprejë takimin, për arsye se punëtori i sigurimit në

²¹"Skender Çoçaj zgjedhet kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Video)". Betimi për Drejtësi. 14 shkurt 2019. <https://betimiperdrejtesi.com/skender-cocaj-zgjedhet-kryesues-i-keshillit-gjyqesor-te-kosoves/>. (qasur për herë të fundit më 31 mars 2019).

KGJK kishte pranuar një telefonatë ku kishte marrë një kërcënim për sulm me bombë, me ç'rast Policia e Kosovës kishte evakuuar objektin e Sekretariatit të KGJK-së, ku edhe mbahej takimi. Ndërsa, në vazhdimin e këtij takimi më 27 maj, KGJK ka miratuar Rregulloren për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Rregulloren për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Trajnimin e Gjyqtarëve. Po ashtu, gjatë këtij takimi, KGJK ka caktuar në panelin me kusht një (1) anëtarë dhe katër (4) anëtarë rezervë si dhe ka refuzuar kërkesat për transfer të përhershëm për 2 gjyqtarë.

- **KGJK takimin e dhjetë në vitin 2019 e ka mbajtur me 12 qershor 2019, apo takimin e 219-të.** Gjatë këtij takimi, KGJK ka miratuar U.A. për Ndarjen e Përgjegjësave të SKGJK dhe të Gjykatave në Çështjet e Personelit, Buxhetit dhe Financave, Logjistikës dhe Prokurimit, ka miratuar listën e gjyqtarëve për panele Hetimore, ka avancuar gjyqtaren Mejreme Memaj nga Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, ka caktuar u.d. e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – dega në Leposaviq si dhe ka marrë vendim për shpalljen e konkursit në këtë degë. Po ashtu, KGJK gjatë këtij takimi ka marrë vendim për transferimin e stafit të ZPD-së në njësitë organizative të administratës së KGJK dhe gjykatave të Republikës së Kosovës.
- **KGJK takimin e njëmbëdhjetë në vitin 2019 e ka mbajtur me 21 qershor 2019, apo takimin e 220-të.** Gjatë këtij takimi, KGJK ka anuluar konkursin e brendshëm për shtatë (7) gjyqtarë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe ka hapur konkurs të ri për avansimin e nëntë (9) gjyqtarëve në këtë gjykatë. Po ashtu, KGJK gjatë këtij takimi ka caktuar u.d. të gjyqtarit mbikëqyrës për Gjykatën Themelore në Gjilan – dega në Viti, ka hapur konkurs për gjyqtarë mbikëqyrës në këtë degë si dhe ka themeluar komisionin për hartimin e testeve për konkursin e shpallur nga KGJK për rekrutimin e 27 gjyqtarëve të ri në të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.
- **KGJK takimin e dymbëdhjetë në vitin 2019 e ka mbajtur me 28 qershor 2019, apo takimin e 221-të.** Gjatë këtij takimi, KGJK ka caktuar gjashtë (6) gjyqtarët e Departamentit Special pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe tre (3) gjyqtarët pranë këtij departamenti në Gjykatën e Apelit. Për shkak se dy (2) prej gjyqtarëve të caktuar ishin edhe Kryetarë Gjykate (Kreshnik Radoniqi – ish-Kryetar i Gjykatës Themelore në Pejë dhe Vaton Durguti ish-Kryetar i Gjykatës Themelore në Gjakovë) KGJK ka caktuar edhe u.d. të Kryetarëve të këtyre dy gjykatave, ku në Gjakovë është caktuar Gjyqtari Nikollë Komani ndërsa në Pejë është caktuar Gjyqtari Sami Sharaxhiu.
- **KGJK takimin e trembëdhjetë në vitin 2019 e ka mbajtur me 31 korrik 2019, apo takimin e 222-të:** Gjatë këtij takimi, KGJK ka zgjedhur anëtarin Makifete Saliuka zëvendës kryesuese të KGJK-së, ka caktuar gjyqtarin Valon Kurtaj udhëheqës të Departamentit Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndërsa Gjyqtari Vaton Durguti është caktuar udhëheqës i Departamentit Special në Gjykatën e Apelit. Po ashtu, KGJK gjatë këtij takimi ka miratuar Raportin për procedurën e përzgjedhjes së gjyqtarëve në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit si dhe ka themeluar një panel hetimor.

- **KGJK takimin e katërbëdhjetë në vitin 2019 e ka mbajtur më 5 shtator 2019, apo takimin e 223-të:** Ndër vendimet më të rëndësishme që KGJK ka nxjerrë gjatë këtij takimi është vendimi për miratimin e Rregullores për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor si dhe vendimi për Emërimin e Anëtarëve të Komisionit për Rekrutimin e Gjyqtarëve të Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës.
- **KGJK më 20 shtator 2019 ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme,** gjatë të cilës mbledhje për shkak të fillimit të hetimeve nga Prokurori i Shtetit, ka pezulluar nga detyra gjyqtarin e Gjykatës Themelore në Pejë, Sali Berisha.
- **KGJK më 27 shtator 2019 ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme,** gjatë të cilës mbledhje për shkak të fillimit të hetimeve nga Prokurori i Shtetit, ka pezulluar nga detyra Gjyqtarin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – dega në Skenderaj, Rafet Ismajli.
- **KGJK takimin e pesëmbëdhjetë në vitin 2019 e ka mbajtur më 7 tetor 2019, apo takimin e 224-të:** Në këtë takim, KGJK ka miratuar Rregulloren për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve, ka ndryshuar përbërjen e Komisionit për hartimin e testit kualifikues si dhe ua ka vazhduar mandatit disa anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve.
- **KGJK takimin e gjashtëmbëdhjetë në vitin 2019 e ka mbajtur më 25 tetor 2019, apo takimin e 225-të:** Gjatë këtij takimi, para anëtarëve të KGJK-së për tremujorin e dytë dhe të tretë kanë raportuar të gjithë Kryetarët e Gjykatave Themelore si dhe Kryetari i Gjykatës së Apelit. Po ashtu, në këtë takim, KGJK ka shpallur edhe konkurs për kryetarë të Gjykatës Themelore në Pejë dhe Gjykatës Themelore në Gjakovë.
- **KGJK takimin e shtatëmbëdhjetë në vitin 2019 e ka mbajtur më 6 nëntor 2019, apo takimin e 226-të:** Gjatë këtij takimi, KGJK ka aprovuar dorëheqjen e Gjyqtarit Armend Berisha nga pozita e anëtarit të KGJK-së. Për shkak se gjyqtari Berisha ishte kryetar i Komisionit për Çështje Normative, KGJK ka nxjerrë vendim që gjyqtarin Berisha në këtë pozitë ta zëvendësojë anëtarja e KGJK-së, gjyqtarja Anita Prenaj-Krasniqi. Po ashtu, në këtë takim KGJK ka caktuar gjyqtarin Ali Kutllovci nënkryetar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.
- **KGJK takimin e tetëmbëdhjetë në vitin 2019 e ka mbajtur më 12 dhjetor 2019, apo takimin e 227-të:** Gjatë këtij takimi, KGJK ka aprovuar dorëheqjen e ish-kryesuesit të KGJK-së, Nehat Idrizi, nga pozita e anëtarit në KGJK. Po ashtu, KGJK në këtë takim ka shpallur konkurs për tri (3) pozita të lirë për Gjyqtarë në Gjykatën Supreme, ka miratuar Udhëzimin Administrativ për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, Udhëzimin Administrativ për Rregullat Unike dhe të Përbashkëta për Rendin Shtëpiak në Gjykata si dhe ka caktuar Gjyqtarët Mbikëqyrës si anëtar të Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.
- **KGJK takimin e nëntëmbëdhjetë në vitin 2019 e ka mbajtur më 24 dhjetor 2019, apo takimin e 228-të:** KGJK gjatë këtij takimi ka miratuar Rregulloren për Zgjedhjen e Anëtarëve të KGJK-së nga Gjyqësori, ka shpallur dy (2) pozita të lira për anëtarë të KGJK-së si dhe ka zgjedhur komisionet përkatëse për të menaxhuar me procesin e zgjedhjes së anëtarëve të rinjë të KGJK-së. Po ashtu, KGJK gjatë këtij takimi ka

shpallur konkurs për avancimin e pesë (5) gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit si dhe ka miratuar Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, së bashkë me manualin për Publikimin dhe Përpunimin e Aktgjykimeve.

5. Miratimi i legjislacionit sekondar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

Më 18 prill 2019 ka hyrë në fuqi Ligji i ri për KPK-në.

Deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, KPK nuk kishte arritur që të miratojë legjislacionin sekondar i cili kishte qenë obligim që nga legjislacioni i vjetër, tanimë i shfuqizuar.

Në këtë mënyrë, për shkak të mungesës së efikasitetit dhe planifikimit të duhur, KPK deri në shfuqizimin e legjislacionit të vjetër, nuk kishte arritur që ti miratojë këto rregullore:

1. Rregulloren për Standardizim lidhur me Ligjërimin e Prokurorëve;
2. Procedurat Standarde të Veprimit lidhur me Evitimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funkcionit nga Anëtarët e KPK-së;
3. Rregulloren për Rregullat dhe Procedurat që Qeverisin Ankesat ndaj vendimeve të KPK-së rreth zhvendosjes së përhershme apo transferimit kundër vullnetit të Prokurorëve, që tejkalojnë periudhën gjashtë (6) mujore.

Në anën tjetër, gjatë vitit 2019, KPK ka miratuar gjithsej gjashtë (6) rregulloret si në vijim:

1. Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr.08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve
2. Rregullore për Administrimin dhe Ndarjen e Lëndëve në Prokurorin e Shtetit
3. Rregullore për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial
4. Rregullore për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria
5. Rregullore për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve
6. Rregullore për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës

Por, KPK edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar me praktikën e njëjtë, duke dështuar që të miratojë legjislacionin sekondar brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Bazuar në Ligjin e ri për KPK-në, ky institucion ka qenë i obliguar për të miratuar një numër të caktuar të rregulloreve. Lidhur me zbatimin e këtij obligimi, IKD i ka rikujtuar dhe bërë thirrje në vazhdimësi këtij institucioni që të rrisë efikasitetin dhe të bëjë planifikimin e duhur, në mënyrë që ky legjislacion të miratuar para afatit të fundit të përcaktuar me ligj, e që është data 18 tetor 2019.

Përkundër kësaj, KPK as deri në fund të vitit 2019 nuk ka arritur që të miratojë të gjitha rregulloret e përcaktuara me ligj. Në këtë mënyrë, KPK ka dështuar që brenda afatit të përcaktuar me ligj të miratojë këto rregullore:

1. Rregullore për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisioneve të Përhershme për KPK-në;
2. Rregullore për Procesin e Emërimit dhe Riemërimit të Prokurorëve nga Komunitetet e nën-përfaqësuar në mesin e Prokurorëve që Shërbejnë në Kosovë;
3. Rregullore për Strukturën Organizative dhe Funkcionimin e Njesisë për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë;
4. Rregullore për Strukturën Organizative dhe Funkcionimin e SKPK-së.

IKD vlerëson se mos miratimi i legjislacionit sekondar nga KPK brenda afateve të përcaktuara me ligj paraqet mos efikasitet, dështim të planifikimit dhe mos zbatimit të objektivave të përcaktuara si me ligj ashtu edhe me planet strategjike të miratuara nga vet KPK.

Mos miratimi i legjislacionit sekondar, si një ndër detyrat primare të KPK-së, paraqet mos ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor që ka KPK. Në këtë drejtim, KPK duhet ta ketë parasysh se mungesa e secilës rregullore, paraqet zbrazëti juridike, ulje të efikasitetit dhe mos administrimit adekuat në punën e tërë sistemit prokurorial.

Përderisa KPK ka para vetës listën e obligimeve që sipas ligjit duhet ti përmbushë, ky institucion duhet që të bëjë një planifikim të duhur, në mënyrë që të ngrit efikasitetin në kuptim të zbatimit të obligimeve të saja ligjore. Në të kundërtën, KPK do të vazhdojë të ndjekë praktikën e deritanishme, ku ligjet që obligojnë KPK-në do të shfuqizohen, derisa KPK nuk do ti zbatojë këto obligime asnjëherë.

Për më tepër, ky mos efikasiteti është edhe mos reflektim i KPK-së përballë dispozitave të reja ligjore, të cilat kanë pasur për qëllim ngritjen e efikasitetit. Sipas paragrafit 2 të nenit 12 të Ligjit nr.06/L-055 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, kryesuesi, zëvendës kryesuesi, Kryetari i Komisionit për Çështje Normative, Kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve dhe Kryetari i Komisionit për Administrimin e Prokurorive shërbejnë në këshill me orar të plotë dhe pezullojnë detyrën e prokurorit. Përderisa sipas ligjit të vjetër me orar të plotë në këshill ka shërbyes vetëm kryesuesi, me ligjin e ri edhe katër (4) prokurorë të tjerë pezullojnë punën e prokurorit për të shërbyer me orar të plotë në këshill. Me qëllim të ngritjes së efikasitetit të KPK-së, ligji i ri ka sakrifikuar katër (4) prokurorë. Andaj, mos reflektimi i KPK-së në ngritje të efikasitetit dhe performancës përballë kësaj dispozite, përcjell një shembull negativ për të gjithë prokurorët të cilët bëjnë të pamundur që detyrat e tyre ti përfundojnë brenda afateve ligjore. Për më tepër, një qasje e tillë e KPK-së zbehë edhe kredibilitetin e këtij institucioni që të kërkojë llogari nga prokurorët, nëse të njëjtit nuk kryejnë detyrat e tyre me efikasitet dhe sipas afateve të përcaktuara me ligj.

5.1. Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr.08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve

KPK, në takimin e 162-të të mbajtur me 21 shkurt 2019, ka miratuar Rregulloren nr. 01/2019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr.08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve.

Qëllimi i nxjerrjes së kësaj rregulloreje ka qenë ndryshimi i rregullores paraprahe për emërimin e kryeprokurorëve, me qëllim që e njëjta të harmonizohet me ndryshimet ligjore që ishin bërë me Ligjin nr.04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

Përkatësisht, me anë të kësaj rregulloreje, është hequr kriteri që kandidati për Kryeprokuror të PSRK-së duhet domosdoshmërisht të jetë një prokuror special.

Ndonëse qëllimi i nxjerrjes së kësaj rregullore duket plotësisht legjitim dhe i arsyeshëm, IKD ka gjetur se kjo rregullore vetëm sa ka shpërfaqur kundërligjshmërinë që KPK kishte bërë gjatë nxjerrjes së rregullores paraprake.

Ligji nr.04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës kishte hyrë në fuqi me 22 maj 2014, përderisa rregullorja Nr.08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve ishte miratuar nga KPK me 14 tetor 2016.

Rregullorja e vitit 2016, në mënyrë kundërligjore kishte përcaktuar si kriter që për tu zgjedhur në postin e Kryeprokurorit të PSRK-së, kandidati duhet të jetë prokurorë special.

Me anë të rregullores Nr.01/2019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve është synuar që rregullorja paraprake të harmonizohet me ligjin e sipërpërmendur, i cili në kohën kur ishte nxjerrë rregullorja 08/2016 kishte qenë në fuqi.

Kjo situatë është krijuar si pasojë e mungesës së profesionalizmit të KPK-së me rastin e hartimit të legjislacionit sekondar, pasi përderisa ndryshimi i ligjit ka qenë në fuqi, ky kriter nuk është dashur fare të futet në atë kohë.

Kjo kundërligjshmëri ishte futur në rregulloren e vitit 2016, pasi e njëjta nuk kishte ekzistuar në Rregulloren nr.03/2015 për Emërimin e Kryeprokurorëve, e cila ishte nxjerrë nga KPK me 5 nëntor 2015.

IKD e sheh shumë shqetësuese qasjen jo profesionale të KPK-së me rastin e miratimit të legjislacionit sekondar. Në këtë drejtim krijohen situata të panevojshme për amandamentimin e shpeshtë të rregulloreve, çka ndikon edhe në mungesën e stabilitetit të legjislacionit sekondar të KPK-së.

Tutje, me anë të kësaj rregulloreje, KPK ka ndryshuar nenin 6.1 të Rregullores nr.08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve, nen i cili ka përcaktuar se KPK shpallë konkurs për emërimin e kryeprokurorëve në të gjitha nivelet e prokurorive së paku 45 ditë para skadimit të mandatit të kryeprokurorëve të prokurorisë përkatëse. Ky afat, sipas rregullores për ndryshimin e kësaj rregulloreje është shkurtuar në 30 ditë. Për këtë ndryshim, KPK nuk ka dhënë asnjë arsyetim ligjor.

Në anën tjetër, IKD ka gjetur se ka defekte edhe në nenin 1 të kësaj rregulloreje, e cila i referohet qëllimit të nxjerrjes së saj. Sipas këtij neni, qëllimi i kësaj rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i nenit 5.1.1 i Rregullores Nr.08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve. Por, sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje ndryshohet edhe neni 6.1 i rregullores paraprake, çka nënkupton se përmbajtja e rregullores nuk pasqyron qëllimin e përcaktuar për të cilën edhe është nxjerrë kjo rregullore.

5.2. Rregullore për Administrimin dhe Ndarjen e Lëndëve në Prokurorin e Shtetit

KPK, më 27 mars 2019 ka miratuar Rregulloren Nr.02/2019 për Administrimin dhe Ndarjen e Lëndëve në Prokurorin e Shtetit.

Me anë të kësaj rregullore, KPK ka përcaktuar dispozitat që kanë të bëjnë me procedurën e pranimit, regjistrimit, ndarjes dhe administrimit të lëndëve nëpër të gjitha prokuroritë. Për më tepër, në këtë rregullore janë inkorporuar edhe dispozitat përkitazi me sistemin e ri elektronik të menaxhimit të lëndëve, i njohur si Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve.

Po ashtu, në këtë rregullore përcakton edhe dispozita të veçanta për secilën kategori të lëndëve në punë nëpër prokuroritë përkatëse.

5.3. Rregullore për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial

KPK me 10 prill 2019 kishte miratuar Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Publik.

Në takimin e KPK-së të mbajtur me 10 prill 2019, Kryetari i Komisionit për Çështje Normative, Zejnullah Gashi, kishte thënë se kjo rregullore është hartuar në atë formë që përpos komunikimit me publikun, të ruhet edhe konfidencialiteti i hetimeve si dhe të mbrohen të drejtat e njeriut. Gashi ka thënë se kontribut të madh në këtë rregullore ka dhënë Ambasada Amerikane si dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD). “Sa i përket kësaj rregulloreje, ne falënderojmë Ambasadën Amerikane dhe IKD-në për komentet e dhëna. Shumica e komenteve që ka bërë IKD-ja janë inkorporuar në këtë rregullore”, kishte thënë Gashi. Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, kishte thënë se përmes kësaj rregulloreje, qytetarët do të jenë më të informuar rreth asaj se çfarë po ndodh në sistem prokurorial. “Në këtë rregullore kemi punuar gjatë me partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile. Falënderojmë të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë rregullore, si partnerët ndërkombëtar, ashtu edhe IKD-në. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që publiku të informohet në kohë sa më të shkurtë, si dhe qytetarët të jetë të informuar vazhdimisht se çka po ndodhë në sistemin prokurorial”, kishte thënë Hyseni.

Lidhur me këtë rregullore, IKD kishte dërguar komente në KPK me 15 mars 2019, gjatë kohës kur kjo rregullore ishte duke u draftuar. Ndonëse në KPK kanë deklaruar se shumica e rekomandimeve të IKD-së janë përfshirë në këtë rregullore, pas krahasimit, IKD ka gjetur se janë përfshirë një numër i madh i rekomandimeve të IKD-së. Por, IKD ka gjetur se në këtë rregullore nuk janë përfshirë komentet kryesore që ka dërguar IKD, e që kanë të bëjnë me centralizimin e informacionit që përcakton kjo rregullore.

Në përgjithësi, kjo rregullore më tepër paraqet një ristrukturim të akterëve dhe procedurave për komunikim me publikun, se sa një hap për të qenë sistemi prokurorial më afër publikut.

Me anë të kësaj rregulloreje, KPK ka centralizuar sistemin e komunikimit në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, përjashtimisht rasteve kur bëhet fjalë për KPK-në. Neni 7 i kësaj rregulloreje përcakton se:

1. Në kuadër të sistemit prokurorial funksionojnë këto zyra:
 - 1.1. Zyra për Komunikim Publik në KPK dhe
 - 1.2. Zyra për Komunikim Publik në ZKPSH.
2. Zyra për Komunikim Publik në KPK është pikë e kontaktit për publikun dhe burim qendror i informacionit për veprimtarinë e Këshillit.
3. Zyra për Komunikim Publik në KPK e ushtron veprimtarinë e saj në raport me publikun në koordinim të plotë me Kryesuesin dhe Drejtorin e Sekretariatit;
- 4 Zyra për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit është pikë e kontaktit për publikun dhe burim qendror i informacionit për institucionin e Prokurorit të Shtetit, përkitazi me veprimtarinë e të gjitha prokurorive;
5. Zyra e ushtron veprimtarinë e saj në raport me publikun në koordinim të plotë me Kryeprokurorin e Shtetit; dhe
6. Zyrat për Komunikim Publik në KPK dhe ZKPSH kane udhëheqësin dhe zyrtarët për komunikim publik.

Në vijim, IKD do të analizojë të metat dhe kundërligjshmëritë e kësaj rregulloreje. Po ashtu, IKD gjatë vitit 2019 ka monitoruar zbatimin në praktik të kësaj rregulloreje, e cila pjesë do të shtjellohet tek gjetjet e veçanta të këtij raporti.

a) Kundërligjshmëria e kontrollit të plotë të Kryeprokurorit të Shtetit në çdo informacion që plasohen në publik

Në nenin 7, paragrafi 2 të Rregullores për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial (tutje: rregullore) përcaktohet se “Zyra për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit është pikë e kontaktit për publikun dhe burim qendror i informacionit për institucionin e Prokurorit të Shtetit, përkitazi me veprimtarinë e të gjitha prokurorive”, ndërsa në nenin 7, paragrafi 5 të rregullores përcaktohet se “Kjo zyrë komunikimi e ushtron veprimtarinë e saj në raport me publikun në koordinim të plotë me Kryeprokurorin e Shtetit”.

Në nenin 10, paragrafi 1 të rregullores përcaktohet se Prokuroritë Themelore, Prokuroria e Apelit dhe PSRK do të kenë zyrtarët për komunikim me publikun. Në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se “Zyrtarët për komunikim publik e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në raport me publikun në koordinim të plotë me kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse, prokurorin përkatës të çështjes dhe udhëheqësin e Zyrës për Komunikim Publik në ZKPSH”.

Në nenin 16.1.1. të Rregullores përcaktohet se “Për rastet (të veçanta) të cilat janë me interes për opinionin publik, njoftohet kryeprokurori i prokurorisë përkatëse i cili para daljes së informacionit në publik, njofton Kryeprokurorin e Shtetit, kurse në rastin që mund të ndërlihet Këshilli, njoftohet Kryesuesi para daljes së informacionit në publik”.

Sa i përket asaj se çfarë nënkuptohet me “rastet e veçanta”, neni 3 i kësaj rregulloreje përcakton thjesht se me raste të veçanta nënkuptohen “rastet te ndjeshme që zgjojnë

interesimin e publikut”. Pra, KPK në këtë rast ka bërë një riformulim të një paqartësie, duke mos e qartësuar këtë term.

IKD vlerëson se ky rregullim i procedurës së komunikimit me publikun është i kundërligjshëm. Nuk ka asnjë bazë ligjore që Kryeprokurorit të Shtetit i jep mandat për të kontrolluar çdo informacion që del në publik nga sistemi prokurorial.

IKD ka analizuar me kujdes Ligjin për PSh-në, KPK-n dhe ndryshimet e bëra në këto ligje. Në asnjë prej këtyre ligjeve dhe ndryshimet e tyre, kjo kompetencë nuk i ipet Kryeprokurorit të Shtetit. Për më tepër, kjo kompetencë e Kryeprokurorit të Shtetit nuk mund të nxirret as me anë të interpretimit logjik.

Neni 10.1. i LPSH përcakton se “Prokurori i Shtetit i ofron publikut rregullisht informacione lidhur me veprimtaritë e saj”. Fillimisht, nga kjo shohim se këtu nuk i referohet ZKSH apo Kryeprokurorit të Shtetit por i referohet institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Ligji nr.05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit kur flet për kompetencat e Kryeprokurorit të shtetit në nenin 11.1.1 përcakton se Kryeprokurori i Shtetit “është kreu i Prokurorisë së Shtetit, me përgjegjësi për menaxhimin dhe **përfaqësimin** e Prokurorisë së Shtetit dhe të strukturave të prokurorive, të cilat e përbëjnë Prokurorinë e Shtetit”. Termi “përfaqësimin” i përdorur në këtë nen në asnjë formë nuk i jep kompetencë që të kontrollojë çdo informacion që del në publik, përfshirë edhe atë të Prokurorive të tjera pos ZKSH.

Kjo për arsye se edhe sa i përket prokurorive të tjera, kemi një përkufizim identik në rastin e kompetencave të kryeprokurorëve të prokurorive të tjera. Neni 13.1. i po këtij ligji përcakton se “Kryeprokurori udhëheq me punën dhe **përfaqëson** prokurorinë për të cilin është emëruar”.

Të njëjtin përcaktim e bënë edhe Ligji nr.03/L-052 për PSRK, ku në nenin 4.4. të këtij ligji përcaktohet se “Kryeprokurori i PSRK-së do të **përfaqësojë** PSRK-në para personave dhe institucioneve tjera vendore, ndërkombëtare, publike dhe private. Kryeprokurori i PSRK-së mund të caktojë **një prokuror tjetër special** që të përfaqësojë PSRK-në para personave dhe institucioneve tjera vendore, ndërkombëtare, publike dhe private sipas nevojave dhe ngarkesës me punë të zyrës”.

Në rastin konkret, norma e nenit 13.1. e LPSH dhe nenit 4.4. të Ligjit për PSRK shikohen si norma me epërsi ndaj nenit 11.1.1. për shkak se e njëjta është normë specifike/speciale/e veçantë. Më e paktë që mund të thuhet, është se normat janë ekuivalente (secili kryeprokuror për zyrën/prokurorinë që udhëheqë).

Si rrjedhojë, kjo kompetencë e Kryeprokurorit të Shtetit është e kundërligjshme, pasi për informacionin e plasuar në publik, Kryeprokurori i Shtetit është përgjegjës vetëm sa i përket ZKSH, ndërsa për prokuroritë e tjera, janë kryeprokurorët e këtyre prokurorive.

Në anën tjetër, përparësi e kësaj rregullore është neni 16.1.1.3 që përcakton se “Të gjithë përfaqësuesit e mediave, pa dallim, trajtohen njëjtë, me mirësjellje profesionale duke marrë në konsideratë **afatet dhe kufizimet e atyre.**”

Duke pasur parasysh natyrën e afateve dhe kufizimeve të mediave, përcaktimi që çdo informacion të kaloj përmes një personi, që në këtë rast është Kryeprokurori i Shtetit, është apriori i pazbatueshëm. Bazuar në vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*të obligueshme sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*) lajmi i mediave është “mall që shpejt humb vlerën”. Në anën tjetër, është në interes të publikut që për një rast të caktuar të informohet në kohë sa më të shpejtë. Ndjekja e procedurës që secilin informacion para se të plasohet në publik ta kontrolloj Kryeprokurori i Shtetit është procedurë, e cila pamundëson zbatimin në praktikë të nenit 16.1.1.3 të rregullores. Për më tepër, kjo pamundësi është vërtetuar edhe nga monitorimi që IKD i ka bërë zbatimin në praktikë të kësaj rregulloreje, cila do të trajtohet tek gjetjet e veçanta.

b) Heqja nga rregullorja e Prokurorit Kujdestar për Komunikim me Media

Në vitin 2018, KPK ka caktuar edhe Prokurorët Kujdestar për Komunikim me Media për secilën prokurori. Një vendim i tillë ka rezultuar mjaft pozitiv dhe efikas në praktikë. Kjo ishte dëshmuar edhe në raportet e kaluara të IKD-së mbi punën e KPK-së.

Prokurorin Kujdestar për Komunikim me Media rregullorja nuk e përcakton fare, çka paraqet një regres të sistemit prokurorial në kuptim të transparencës me publikun.

Në këtë drejtim, ngarkesa e prokurorit me lëndë që ai është duke hetuar (në këtë rast Prokurorit Kujdestar për Komunikim me Media) nuk duhet të shërbejë si arsyesim se i njëjti nuk arrin që të përmbushë detyrat e tij. Fakti se në këtë rregullore përcaktohen përgjegjësit për komunikim për secilin akter, do të nënkuptonte se prokurori kujdestar për komunikim me media do të kishte disa përgjegjësi të kufizuara dhe nuk do të mbulonte ato të akterëve të tjerë të përcaktuara në rregullore. Në raste të caktuara të cilat kanë një karakter doktrinar juridik, në të cilin nuk flitet për raste konkrete, më efektive dhe e drejtë është që komunikim me publikun ta bëjë një prokurorë se sa një zyrtarë për informim, i cili jo domosdoshmërisht është jurist me profesion.

Për më tepër, nga monitorimi sistematik i IKD-së ndaj sistemit prokurorial shihet qartë se ka një regres të madh të transparencës që nga koha kur komunikimin me publikun nuk e kanë mbajtur më prokurorët kujdestar për media.

5.4. Rregullore për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria

Ligji Nr. 06/L-009 Për Ndërmjetësim në nenin 8, paragrafi 5 ka përcaktuar se “Këshilli Prokurorial i Kosovës, nxjerr akt nënligjor me të cilin përcaktohet **procedura e referimit** të rasteve nga prokuroria sipas paragrafit 1. të këtij neni”.

Në zbatim të këtij obligimi ligjor, KPK në takimin e mbajtur me 25 prill 2019 ka miratuar Rregulloren për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria.

Në këtë rregullore, është përcaktuar se për rastet e ndërmjetësimit do të angazhohet referenti për ndërmjetësim, i cili është zyrtari i prokurorisë së caktuar që administron me rastet e referuara nga prokuroria. Po ashtu, brenda obligim ligjor sipas Ligjit për Ndërmjetësim, është përcaktuar edhe procedura për menaxhimin e lëndës së referuar si dhe përzgjedhja apo caktimi i ndërmjetësuesve.

a) “Volumi” i panevojshëm i rregullores

Siç u tha edhe më lartë, Ligji për Ndërmjetësim e ka obliguar KPK-në për të nxjerrë akt nënligjor me të cilin përcaktohet **procedura e referimit** të rasteve nga prokuroria. Përtej procedurës së referimit, KPK nuk ka pasur as nevojë dhe as të drejtë të përcaktojë dispozita tjera.

Por, pjesa më e madhe e kësaj rregulloreje është e mbushur me nene që nuk e kanë vendin fare në këtë rregullore, pasi ato janë norma ekskluzivisht të kopjuara nga ligjet bazike. Nenet e kopjuara në këtë rregullore nga ligjet bazike janë kryesisht nenet e Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit për Ndërmjetësim.

Përpos procedurës për referim, kjo rregullore përcakton edhe përshtatshmërinë e rastit për ndërmjetësim, fillimin e procedurës së referimit, marrëveshjen për fillimin e ndërmjetësimit, konfliktin e interesit tek ndërmjetësuese, konfidencialitetin e informacioneve, marrëveshjen e arritur për ndërmjetësim, mosarritjet e marrëveshjes, përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit, aprovimin ose anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim dhe shpenzimet e procedurës.

Të gjitha këto çështje, janë të rregulluara në mënyrë identike me ligjet bazike.

IKD vlerëson se KPK duhet ti shmanget qasjes kur ligjet bazike me tekstin identik i konverton në legjislacion sekondar. Në këtë drejtim, KPK duhet ta ketë parasysh se ligji si i vetëm është i zbatueshëm, derisa nuk ka nevojë për dispozita që e detajizojnë zbatimin e të njëjtit. Secili legjislacion sekondar, duhet të jetë në kuptim të zbatimit të ligjit, pra të ketë norma më detajzuese në këtë drejtim, dhe jo të jetë përsëritje e ligjit. Nëse veprohet kështu, atëherë legjislacioni sekondar nuk ka asnjë kuptim.

Në anën tjetër, një qasje e tillë ndikon që KPK në legjislacionin e saj sekondar vetëm të bëjë volum, pasi këto pjesë të rregullores janë të pazbatueshme. Secili prokuror apo ndërmjetësues që është i përfshirë në këtë proces i referohet dispozitave ligjore, dhe i njëjti nuk ka nevojë që ti referohet dispozitës identike e cila gjendet në rregullore të KPK-së.

Andaj, KPK duhet të krijojë praktikë që në secilin rast të kufizohet në detyrimin e saj ligjor me rastin e miratimit të legjislacionit sekondar, dhe mos të krijojë volum të panevojshëm të këtij legjislacioni.

b) Kapitulli jashtëligjorë i kësaj rregulloreje

Me rastin e miratimit të kësaj rregulloreje, KPK i është referuar nenit të mësipërm të Ligjit për Ndërmjetësim dhe Ligjit për KPK-në.

Ndërsa, përpos dispozitave të sipërpërmendura, kreu 3 i kësaj rregulloreje rregullon edhe referimin e rasteve së të miturve në procedurë penale.

Në kuptim të Ligjit për Ndërmjetësim, një qasje e tillë e KPK-së është jashtë ligjore, pasi vetë Ligji për Ndërmjetësim nuk e rregullon çështjen procedurën e ndërmjetësimit për të mitur. Neni 27, paragrafi 3 i Ligjit për Ndërmjetësim përcakton se “Procedura e ndërmjetësimit për të mitur dhe arbitrazhit tregtar rregullohet me ligje të veçanta”.

Për këtë arsye, duke ju referuar vetëm këtij ligji në bazën e saj ligjore, kjo rregullore ka tejkaluar ligjin bazik.

IKD i rikujton për të satën herë KPK-së që krahas të gjithave, çështja kryesore me rastin e hartimit të legjislacionit sekondar është përcaktimi dhe kuptimi i limiteve nga ligjet bazike. Në të kundërtën, do të shfaqen situata të tilla kur vetë legjislacioni sekondar i KPK-së nuk do të jetë në përputhje me natyrën juridike që ka ky legjislacion.

5.5. Rregullore për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve

Më 10 janar 2019 ka hyrë në fuqi Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Neni 17 i këtij ligji përcakton se “Këshillat miratojnë rregulloret e parapara me këtë ligj, brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji”.

Në zbatim të këtij obligimi ligjor, KPK në takimin e mbajtur me 7 qershor 2019 ka miratuar Rregulloren 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve.

Kjo rregullore adreson kërkesat e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve përkitazi me sistemin e ri të disiplinimit që ka ndërtuar kjo rregullore.

Mbi bazën e kësaj rregullore, KPK në takimin e mbajtur më 3 korrik 2019 ka miratuar listën prej 30 prokurorëve të cilët do të shërbejnë në panele hetimore.

a) Kundërligjshmëria e rregullores përkitazi me ankesat anonime

Sikurse KGJK, edhe KPK me anë të kësaj rregulloreje ka vendosur që ta hudhë secilën ankesë të secilës palë i cili në raportimin e një shkeljeje disiplinore dëshiron të mbetet anonim.

Në nenin paragrafin 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje përcaktohet se:

Ankesa hudhet siç është përcaktuar me nenin 9, paragrafi 6 i Ligjit dhe kur autoriteti kompetent konstaton se ankesa është:

1. Anonime
2. Shkelja e supozuar është parashkruar

Në paragrafin 3 të këtij neni të rregullores përcaktohet po ashtu se autoriteti kompetent e refuzon ankesën kur konstatohet se e njëjta është dukshëm jo serioze dhe e pabazuar, sepse nuk ka të bëjë me shkelje disiplinore.

KPK me anë të këtij neni ka tejkalluar nenin 9, paragrafin 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i cili përcakton katër rrethana se kur autoriteti kompetent nuk kërkon fillimin e hetimeve nga KGJK.

Neni 9, paragrafi 6 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve përcakton se:

Autoriteti Kompetent sipas nenit 9, paragrafin 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12, paragrafin 2, përveç kur konstaton se ankesa është **dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar.**

Pra, në asnjërin prej këtyre rrethanave nuk përcaktohet se autoriteti kompetent nuk duhet të kërkojë fillimin e hetimeve në rastin kur kërkesa është anonime.

Për më tepër, në Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në asnjë pjesë të saj nuk e përmban fjalën “anonime”.

Paragrafi 4 i nenit 9 të këtij ligji përcakton se ankesa duhet të përmbajë, ndër të tjera, edhe “identitetin e personit fizik ose juridik i cili e paraqet ankesën”. Por, kjo në asnjë rrethanë nuk mund të shërbejë si arsye që në rregullore të përcaktohet se autoriteti kompetent nuk vepron tutje nëse ankesa është anonime.

Aq më tepër, kur autoriteti kompetent është njoftuar lidhur me një shkelje të supozuar të një prokurori. Kjo për arsye se pas njoftimit të tij lidhur me një rrethanë në të cilën ka një shkelje të supozuar disiplinore, i njëjti mund të kërkojë nga KPK fillimin e hetimeve edhe sipas detyrës zyrtare, pra, edhe sikur ankesa mos të kishte ekzistuar fare.

Përkitazi me këtë, paragrafi 2 i nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve përcakton se:

Autoriteti Kompetent kërkon nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore mbi bazën e një ankese të paraqitur nga një person fizik apo juridik dhe e cila nuk është hedhur poshtë sipas nenit 9, paragrafit 6 të këtij Ligji, **ose sipas detyrës zyrtare kur ka bazë të arsyeshme të besoj se një gjyqtar ose prokuror ka kryer shkelje disiplinore.**

Lidhur me këtë përcaktim të rregullores, sikurse në rastin e Rregulloren për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, IKD konsideron se është tërësisht e papranueshme që secila ankesa e cila është anonime të hudhet qysh në fillim nga autoriteti kompetent, aq më tepër kur në përmbajtjen e të njëjtës ankese mund të ketë dëshmi të qarta për një shkelje të supozuar disiplinore nga një prokurorë.

Në mënyrën se si funksionon aktualisht sistemi prokurorial, është shumë normale që një person i caktuar të ketë frikë të ballafaqohet direkt me prokurorë i cili supozohet se ka kryer një shkelje disiplinore, dhe si rrjedhojë i njëjti do preferojë të mbetet anonim. Në raste të tilla, ankesa mund të përmbajë shumë informacione, dhe nuk ka asnjë arsyetim ligjor dhe logjik me të cilin mund të konkludojmë se kjo ankesë nuk duhet të procedohet tutje. Nëse ankesa është anonime por edhe është e pabazuar dhe joserioze, ka baza të tjera të përcaktuara me ligj dhe rregullore me të cilat autoriteti kompetent mund ta hudhë poshtë në fillim ankesën. Por, jo që ta hudhë ankesën vetëm pse e njëjta është anonime, përkundër përmbajtjes së saj.

Po ashtu, fakti se parashtruesi i ankesës është i panjohur, pra ankesa është anonime, nuk e pengon në asnjë rrethanë zhvillimin e procedurës, pasi e njëjta mund të zhvillohet edhe pa parashtruesin e ankesës. Në kuptim të nenit 2.1.1.5 të Rregullores, palë në rastin konkret paraqitet vetë autoriteti kompetent.

Për këtë arsye, IKD kërkon nga KPK të reflektojë përkitazi me këtë pjesë dhe të ndryshojë këtë rregullore, në atë mënyrë që të largojë këtë pjesë me anë të një rregulloreje për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores. Derisa në atë kohë, secili autoritet kompetent duhet ti referohet ligjit dhe mos ta aplikojë këtë dispozitë kundërligjore të kësaj rregulloreje, pra, të procedojë tutje me ankesat, edhe nëse të njëjtat janë anonime.

5.6. Rregullore për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës

KPK ka miratuar këtë rregullore në takim e saj të mbajtur më 1 gusht 2019.

Me anë të kësaj rregulloreje, KPK ka përcaktuar kriteret dhe procedurat për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe emërimit të Kryeprokurorëve së të gjitha prokurorive.

Deri më tani, KPK ka funksionuar me dy rregullore të veçanta, ku njëra ka qenë për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe tjetra për emërimin e Kryeprokurorëve së të gjitha prokurorive

të tjera, derisa miratimi i një rregullore të vetme për të gjithë prokurorët, ka qenë edhe rekomandim e IKD-së²².

Lidhur me këtë rregullore, KPK ka ndërtuar praktikë të mirë të zbatimit të obligimit ligjor dhe ka hapur konsultim publik. Për më tepër, më 18 korrik 2019, KPK ka mbajtur edhe takim publik me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile lidhur me këtë Rregullore.

Lidhur me këtë rregullore, IKD i ka dërguar KPK-së komentet e mëposhtme, të cilat edhe i ka publikuar në faqen zyrtare të IKD-së²³.

Për të shqyrtuar komentet e dërguara, KPK më 18 korrik 2019 ka mbajtur takim me përfaqësuesit e shoqërisë civile, ku janë diskutuar komentet e dërguara. Në këtë rast, edhe përfaqësuesit e IKD-së kanë prezantuar komentet e dërguara, të cilat janë mirëpritur nga KPK-së.

²² "Lufta" për Kryeprokuroret". IKD. Maj 2019. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2019/05/Lufta-prer-Kryeprokuroret-12.05.2019-ëord.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 27 nëntor 2019).

²³ "Komentet e IKD-së në Draft – Rregulloren për Emërimin e Kryeprokuroreve të Shtetit dhe Kryeprokuroreve të Prokurorive të Republikës së Kosovës". IKD. 18 korrik 2019. (<https://kli-ks.org/komentet-e-ikd-se-ne-draft-rregulloren-per-emerimin-e-kryeprokuroreve-te-shtetit-dhe-kryeprokuroreve-te-prokurorive-te-republikes-se-kosoves/>). (Qasur për herë të fundit më 27 nëntor 2019).

6. Llogaridhënia dhe integriteti në sistemin prokurorial dhe mekanizmat e kontrollit

IKD ka gjetur se KPK ka miratuar raportin vjetor për punën e KPK-së, por se i njëjti nuk është publikuar brenda afatit. Po ashtu, IKD ka gjetur se KPK ka miratuar raportin vjetor të Prokurorit të Shtetit, si dhe ka bërë vlerësimin e 1/3 të prokurorëve.

Obligimet ligjore të sistemit prokurorial	Përbushur	Nuk janë përbushur	Afati
Raporti vjetor i Punës së PSh-së	X		Muaji mars i vitit respektiv
Raporti vjetor i Punës së KPK-së		X	Muaji mars i vitit respektiv
Vlerësimi i Performancës së Prokurorëve	X		1/3 e prokurorëve brenda vitit
Raportimi i Kryeprokurorëve para KPK		X	Çdo tre muaj
Transparenca		X	

Tabela 4 - Obligimet ligjore të përbushura dhe të pa përbushura të sistemit prokurorial.

Por, KPK ka dështuar që të ftojë kryeprokurorët për të raportuar para anëtarëve të KPK-së ashtu siç kërkohet me ligj dhe rregullore të KPK-së, derisa transparenca e sistemit prokurorial vazhdon të pësoj regres, përkundër progresit të evidentuar në fillim të vitit 2019.

6.1. Raporti vjetor i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2018

Neni 4 paragrafi 1 pika 12 e Ligjit për KPK-në përcakton se KPK është i obliguar në përgatitjen e një raporti vjetor mbi veprimtaritë e Prokurorit të Shtetit dhe shpenzimeve të Këshillit.

Ky raport është prezantuar nga Kryeprokurori i Shtetit para anëtarëve të KPK-së në takimin e 165-të të KPK-së, të mbajtur me 10 prill 2019. Në këtë raport të publikuar në faqen zyrtare të KPK-së, nuk është e qartë pse në të njëjtin figuron data “shkurt 2019”, kur ky raport as nuk është miratuar dhe as nuk është publikuar deri në prill të këtij viti.

Në raport thuhet se Prokurori i Shtetit (PSh) gjatë vitit 2018 ka pasur në punë gjithsej 179,242 kallëzime – lëndë penale (lëndë nga regjistrat: PP, PPM, PPN, NJN, PPP, lëndët e PA-së dhe ZKPSH-së) nga të cilat 119.454 janë trashëguar si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake. Në periudhën raportuese, PSh ka pranuar në punë gjithsejtë 59,788 kallëzime –

lëndë penale nga të cilat prokurorët kanë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente 74,031 prej tyre, përkatësisht 14,242 kallëzime – lëndë penale më shumë se që kanë pranuar.

Në fund të periudhës raportuese, të pazgjidhura kanë mbetur 105,211 kallëzime – lëndë penale.

6.2. Raporti Vjetor i Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2018

Neni 4 paragrafi 1 pika 12 e Ligjit Nr. 03/L-224 për KPK-në (neni 7.19 i Ligjit Nr.06/L-056 për KPK-në) përcakton se KPK është i obliguar në përgatitjen e një raporti vjetor mbi veprimtarinë e Prokurorit të Shtetit dhe shpenzimeve të Këshillit.

Ndërsa, KPK me nenin 41 Rregullores për Organizimin dhe Veprimtarinë e KPK-së ka përcaktuar se ky raport duhet të miratohet dhe të publikohet në faqen zyrtare të KPK-së deri më 31 mars të vitit pasues, në rastin konkret 31 mars 2019.

KPK nuk e ka respektuar këtë dispozitë të saj. Kjo pasi KPK këtë raport e ka miratuar më 21 shkurt 2019, por se i njëjti nuk është publikuar sipas afatit që ka përcaktuar vetë KPK.

Në një përgjigje për IKD, KPK kishte thënë se arsyeja pse është vonuar publikimi i këtij raporti kanë qenë disa arsye teknike.

Në këtë rast, IKD vlerëson se është jo e arsyeshme vonesat e gjata në publikimin e dokumenteve të KPK-së, veçanërisht një dokumenti të rëndësishëm si raporti vjetor për punën e KPK-së, në të cilin raport paraqitet puna një (1) vjeçare e këtij institucioni kushtetues. Nëse pas miratimit të një dokumenti nga KPK, krijohen zvarritje nga Sekretariati i KPK-së në publikimin e dokumenteve përkatëse, KPK duhet të mbajë përgjegjës dhe llogaridhënës Sekretariatit e saj, në mënyrë që të ruaj dhe të ngritë efikasitetin dhe transparencën publike.

6.3. Vlerësimi i performancës së prokurorëve dhe masat disiplinore

Ligji nr. 06/L-056 për KPK-në përcakton në nenin 27 përcakton se “Vlerësimi i performancës së prokurorëve me mandat të përhershëm bëhet çdo tre (3) vjet, në mënyrën e tillë që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli cakton me short një e treta (1/3) e prokurorëve, brenda secilës prokurori, si grupin e parë të cilët do t’u nënshtrohen vlerësimit të performancës në afat prej tre (3) muajsh. I njëjti short mbahet pas një (1) viti për të caktuar prokurorët që do bëjnë pjesë në grupin e dytë dhe grupin e tretë pas dy (2) viteve, respektivisht”.

Gjatë vitit 2019, KPK ka planifikuar dhe zhvilluar drejt dhe sipas kërkesave ligjore këtë proces, në mënyrë që përgjatë një (1) viti kalendarik, 1/3 e të gjithë prokurorëve të nënshtrohen procesit të vlerësimit të performancës. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2019, KPK ka bërë vlerësimin e performancës për gjithsej 88 prokurorë, nga 190 sa janë gjithsej.

Sa i përket disiplinimit të prokurorëve, më 10 shkurt të vitit 2019 ka hyrë në fuqi Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sa i përket procedurave disiplinore

të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, po ky ligj në nenin 17.3 ka përcaktuar se “Procedurat disiplinore të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë dhe përfundojnë në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi, në kohën e fillimit të hetimit disiplinor dhe do të përfundojnë brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

Për këtë arsye, gjatë kësaj kohe në KPK janë zhvilluar edhe procedurat disiplinore sipas ligjit të vjetër por edhe procedurat disiplinore të bazuara në Ligjin e ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Më 1 janar 2019, Komisioni Disiplinor i KPK-së ka trashëguar nga viti 2018 gjithsej tri (3) raste disiplinore, derisa gjatë vitit 2019, nga ZPD ka pranuar edhe tri (3) raporte përfundimtare²⁴. Të gjitha këto gjashtë (6) raste Komisioni Disiplinor i KPK-së i ka përfunduar, ku ka marrë këto vendime:

Lloji i masës disiplinore/vendimit	Numri i vendimeve
Pushim i procedurës	1 vendim
Refuzim i raportit përfundimtar	2 vendime
Propozim për largim nga detyra	1 vendim
Ulje në detyrë	1 vendim
Qortim	1 vendim
Total	6 vendime

Tabela 5 - Masat disiplinore të shqiptuara nga KD i KPK-së.

Po ashtu, gjatë vitit 2019, KPK si shkallë e dytë ka pranuar edhe katër (4) ankesa ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor të KPK-së, ku në tri (3) rastet ka refuzuar ankesat dhe ka lënë në fuqi vendimet e Komisionit Disiplinor të KPK-së.

Ndërsa, bazuar në procedurat e reja disiplinore sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, KPK me kërkesë të autoriteteve kompetente ka themeluar gjithsej 12 panele hetimore. Në tetë (8) prej këtyre rasteve, KPK ka marrë këto masa/vendime disiplinore.

²⁴ *Shënim:* Përpos këtyre rasteve, Komisioni Disiplinor i KGJK-së ka pranuar edhe një kërkesë për suspendimin e një prokurori, të cilën kërkesë e ka aprovuar.

Lloji i masës disiplinore/vendimit	Numri i vendimeve
Nuk ka kryer shkelje disiplinore	2 vendime
Vërejtje jo publike me shkrim	3 vendime
Zvogëlim i pagës 30% për gjashtë (6) muaj	1 vendim
Zvogëlim i pagës 50% për gjashtë (6) muaj	1 vendim
Ulje në detyrë	1 vendim
Total	8 vendime

Tabela 6 - Masat disiplinore të shqiptuara nga KPK sipas Ligjit të ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Po ashtu, në një rast tjetër KPK ka nxjerrë edhe një vendim “nuk ka kryer ankesë disiplinore”, i cili vendim ende nuk është i formës së prerë, derisa procedura disiplinore është duke u zhvilluar në tri (3) raste të tjera.

6.4. Raportimi i Kryeprokurorëve para KPK-së

KPK, më 29 dhjetor 2015, ka miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Funksonimin e Prokurorit të Shtetit. Neni 9 i kësaj rregullore përcakton përgjegjësitë e Kryeprokurorëve në raport me KPK-në. Neni 9 pika 1.4 e kësaj rregullore obligon Kryeprokurorët që në baza tre mujore t’i dorëzojnë KPK-së raport me shkrim lidhur me punën e prokurorisë, vështirësitë dhe propozimin e masave lidhur me përmirësimin e performancës së prokurorisë.

Si rekomandim nga raportet e kaluara të IKD-së për KPK-në kishte qenë edhe ajo që KPK të ftojë kryeprokurorët që të raportojnë para anëtarëve të këshillit, rekomandim të cilin KPK nuk e ka zbatuar si duhet gjatë tremujorit të parë të këtij viti.

Më 21 shkurt 2019, para anëtarëve të KPK-së kanë paraqitur raportin vjetor për vitin 2018 Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit si dhe të gjithë Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore.

Gjatë këtij takimi, të njëjtit, me kërkesë të KPK-së, kanë raportuar edhe për periudhën kohore 1 janar – 31 janar 2019²⁵.

Por, KPK gjatë periudhës kohore 1 janar – 31 mars 2019, nuk ka ftuar asnjëherë kryeprokurorët për të raportuar para anëtarëve të KPK-së lidhur me tremujorin e katërt të vitit 2018.

Tutje, KPK nuk e ka përmbushur këtë obligim as në tre (3) mujorin e dytë dhe të katërt të vitit 2019, derisa e ka përmbushur këtë obligim në tre (3) mujorin e tretë të vitit 2019.

Në këtë rast, IKD rithekson se mos raportimi i Kryeprokurorëve para anëtarëve të KPK-së sipas dispozitave që vet KPK i ka përcaktuar paraqet mungesë të llogaridhënies të sistemit prokurorial në raport me KPK-në si dhe mos vlerësim të këtij procesi nga vet KPK.

Në këtë drejtim, raportimi i kryeprokurorëve para anëtarëve të KPK-së ka disa qëllime.

Fillimisht, përmes raportimit të kryeprokurorëve para anëtarëve të KPK-së, KPK mban llogaridhënës gjithë sistemin prokurorial. Qëllimi i dytë është që duke u respektuar dispozitat që vet KPK ka përcaktuar, raportimi i kryeprokurorëve të bëhet çdo tre (3) muaj, dhe kjo për dy arsye: që KPK të jetë vazhdimisht e informuar mbi punën e prokurorive dhe që në rast devijimi, të ketë mundësi që të ndërhyjë me kohë. Po ashtu, përmes raportimit të kryeprokurorëve para anëtarëve të KPK-së, këtij institucioni i ipet mundësia që të bashkëpunojë me kryeprokurorët e të gjitha prokurorive, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të sistemit prokurorial.

Andaj, KPK duhet që të ketë parasysh rëndësinë dhe benefitet e zbatimit të këtij obligimi, dhe të përmbushë këtë obligim sipas afateve që vet i ka përcaktuar. Po ashtu, e rëndësishme thelbësore është që ky raportim mos të jetë formal, por të jetë meritore, në mënyrë që të adresojë të meta në funksionimin efektiv dhe efikas të gjithë sistemit prokurorial.

6.5. Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit prokurorial

KPK në vazhdimësi proklamoi ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me publikun dhe mediat. KPK ka miratuar rregullore dhe strategji për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien dhe për të lehtësuar bashkëpunimin me publikun dhe median.

Po ashtu, në secilën paraqitje publike, secili prej akterëve të sistemit prokurorial deklaroi se puna e tyre zhvillohet ekskluzivisht mbi parimin e transparencës, duke u zotuar se për fuqizimin e këtij parimi do të angazhohen vazhdimisht.

IKD gjatë monitorimit të sistemit prokurorial, gjatë vitit 2019, ka adresuar në sistemin prokurorial 200 kërkesa për qasje në informata dhe dokumente publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore, ofrimin e informacioneve, statistikave dhe të dhënave të tjera të disponueshme dhe lejueshme sipas Ligjit mbi Qasje në Dokumente Publike.

²⁵ *Shënim:* Ky raportim nuk paraqet përmbushje të obligimit nga KPK. Kjo çështje do të trajtohet tek gjetjet e veçanta të këtij raporti.

Prej këtyre 200 kërkesave, IKD ka pranuar 61 përgjigje pozitive apo në 30.5%, 22 kanë qenë përgjigje negative apo 11%, ndërsa në 117 kërkesa IKD nuk ka pranuar fare përgjigje, apo në 58.5%.

Më 10 prill 2019, KPK ka miratuar Rregulloren Nr.03/2019 për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial. Qëllim i kësaj rregulloreje është përcaktuar ngritja e transparencës dhe koordinimi i plotë për prezantimin e drejtë dhe të paanshëm të punës së sistemit prokurorial. Për më tepër, KPK ka deklaruar se miratimi i kësaj rregulloreje është bërë edhe me qëllim që të kihet parasysh natyra e punës së mediave.

Por, me këtë rregullore, KPK në mënyrë të kundërligjshme ka centralizuar informacionin prokurorial në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, përjashtimisht informacionit që ndërlihet me KPK-në.



Karikatura e Kohës Ditore pas miratimit të Rregullores për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial nga KPK.²⁶

²⁶ Karikatura e ditës. Koha.net. 20 prill 2019. (Shih linkun: <https://ëëë.koha.net/karikatura/158007/karikatura-e-dites/>). (Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2020).

IKD në komentet që kishte dërguar në KPK përkitazi me këtë rregullore, ndër të tjera kishte potencuar se vet mënyra se si është dizajnuar procedura e dhënies së informacionit prokurorial për publikun, nuk garanton transparencë të sistemit prokurorial në praktikë, dhe se kjo rregullore, do të shkaktonte regres të transparencës së sistemit prokurorial. Përkundër kësaj thirrje, KPK ka miratuar versionin e rregullores që centralizon informacionin prokurorial në ZKSH.

Para se të hyjë në fuqi kjo rregullore, pra në tre (3) mujorin e parë të vitit 2019, sistemi prokurorial kishte një progres të theksuar të transparencës, e cila ishte evidentuar nga IKD në raportin që kishte publikuar për punën e KPK-së gjatë tre (3) mujorit të parë të vitit 2019²⁷.

Për të vlerësuar efektin në praktikë të kësaj rregulloreje, IKD ka monitoruar zbatimin e saj. Në këtë rast, IKD ka krahasuar progresin dhe regresin e transparencës së sistemit prokurorial në tre (3) mujorin e parë dhe tre (3) mujorin e dytë të vitit 2019, për të parë në praktikë efektet e kësaj rregulloreje.

Nga të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike dhe informata që IKD kishte parashtruar në sistemin prokurorial gjatë periudhës kohore 1 janar – 31 mars 2019, IKD kishte marrë përgjigje pozitive në 57.69% të kërkesave, në 23.07% të kërkesave kishte marrë përgjigje negative ndërsa në 19.23% të kërkesave IKD nuk kishte marrë fare përgjigje.

Ndërsa, IKD gjatë monitorimit të sistemit prokurorial, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019, ka adresuar në sistemin prokurorial 127 kërkesa për qasje në dokumente publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore, ofrimin e informacioneve, statistikave dhe të dhënave të tjera të disponueshme dhe lejueshme sipas Ligjit mbi Qasje në Dokumente Publike.

Prej këtyre 127 kërkesave, 11 kërkesa i janë drejtuar KPK-së, në të cilat IKD ka marrë tetë (8) përgjigje pozitive apo në 72.72 të kërkesave, ndërsa në tri (3) përgjigje IKD nuk ka marrë fare përgjigje, apo në 27.27% të kërkesave.

Ndërsa, prej këtyre 127 kërkesave, 116 i janë drejtuar të gjitha prokurorive, nga të cilat IKD ka marrë vetëm 16 përgjigje pozitive apo 13.73% të kërkesave, në gjashtë (6) kërkesa apo 5.17% të kërkesave prokuroritë kanë refuzuar që të japin përgjigje ndërsa në gjithsej 94 kërkesa apo në 81.03% të kërkesave të parashtruara IKD nuk ka marrë fare përgjigje nga prokuroritë.

Pra, nëse e shohim në praktikë, atëherë del se informacioni i centralizuar është shndërruar në informacion të kufizuar. Kjo për arsye se nga, 57.69% të kërkesave pozitive që IKD kishte pranuar në tre (3) mujorin e parë të vitit 2019, kjo përqindje ka rënë në 13.73% në kërkesat drejtuar Prokurorit të Shtetit.

²⁷ Shala G. "Pavarësia, Efikasiteti, Llogaridhënia dhe Integriteti i Këshillave". IKD. 28 maj 2019. F.29. (Shih linkun https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2019/09/Monitorimi-KGJK-KPK-Buletini-tre-mujor-1-janar-31-mars-2019_Final-PDF.pdf). (Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2020).

Por, kjo rregullore nuk ka ndikuar në transparencën e KPK-së, pasi dispozitat që kanë të bëjnë me informacionin e KPK-së kanë mbetur përafërsisht të njëjta, përpos faktit që Kryesuesit të KPK-së i ipet një rol vendimtar.

Thënë më ndryshe, progresi i nisur nga sistemi prokurorial për transparencë, është minuar me miratimin e kësaj rregulloreje, veçanërisht me centralizimin e informacionit në ZKSH.

Lidhur me legjislacionin sekondar të KPK-së, KPK ka publikuar të gjitha rregulloret që ka miratuar gjatë vitit 2019.

Por, KPK edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar me praktikën e mos publikimit të numrit më të madh të vendimeve që ky institucion ka nxjerrë.

Nga 1 janari 2019 e deri më 31 dhjetor 2019, KPK ka nxjerrë gjithsej 215 vendime. Prej këtyre 215 vendime, KPK në faqen e saj zyrtare ka publikuar vetëm 79 vendime, derisa nuk ka publikuar 136 vendime të tjera. Në përqindje i bie që KPK ka publikuar vetëm 36.7% të vendimeve, derisa nuk ka publikuar 63.2% të vendimeve.

Ndërsa, sa i përket takimeve, KPK ka ftuar mediat dhe shoqërinë civile në secilin prej takimeve të mbajtura gjatë vitit 2019.

6.6. Avancimi dhe transferimi i Prokurorëve

KPK edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar praktikën e avancimit të prokurorëve pa konkurs, në emër të transferimit.

Kjo ka ndodhur në takimin në 161-të të KPK-së të mbajtur me 28 janar 2019, në të cilin takim, KPK ka transferuar prokurorin Ramiz Buzhala nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore të Gjakovës. Transferimi është bërë për një afat prej gjashtë (6) muajve.

Me anë të këtij vendimi, KPK ka vazhduar me praktikën e kundërligjshme ta saj, ku ka avancuar prokurorë pa konkurs, në emër të transferimit. Qartësimi i dallimit në mes avancimit dhe transferimit ka qenë rekomandim edhe në raportet e kaluara për KPK-në që IKD kishte publikuar në janar të këtij viti.

Si rikujtim, IKD vlerëson se kalimi i një prokurori nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda nuk mund të konsiderohet transferim, por avancim²⁸.

6.7. Monitorimi i takimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës

²⁸ Shih për më tepër: Shala G. "Pavarësia, Efikasiteti, Llogaridhënia dhe Integriteti i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial". IKD. 29 janar 2019. F.37-39(Shih linkun <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2019/01/Raporti-KGJK-KPK-2018-Final-29.01.2019-1-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2020); Shala G. "Pavarësia, Efikasiteti, Llogaridhënia dhe Integriteti i Këshillave". IKD. 28 maj 2019. F.30-32. (Shih linkun <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2019/09/Monitorimi-KGJK-KPK-Buletini-tre-mujor-1-janar-31-mars-2019-Final-PDF.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2020).

KPK prej 1 janarit 2019 e deri më 31 dhjetor 2019 ka mbajtur gjithsej 16 takime. Në mesatare i bie se KPK gjatë vitit 2019 ka mbajtur nga 1.3 takime në muaj.

6.7.1. Diskutimet e anëtarëve të KPK-së gjatë miratimit të politikave

IKD ka monitoruar në detaje takimet të gjitha takimet e KPK-së, përfshirë pjesëmarrjen në diskutim nga të gjithë anëtarët e Këshillit.

Për dallim nga viti 2018, IKD gjen se gjatë vitit 2019 ka një përfshirje më të madhe të numrit të anëtarëve që marrin pjesë në diskutim, por se thelbi i debatit vazhdojnë të mbeten një numër i vogël i anëtarëve të KPK-së.

Në vitin 2018, IKD kishte gjetur se anëtari më aktiv i KPK-së kishte qenë Bahri Hyseni. Hyseni edhe gjatë vitit 2019 është më së shumti aktiv në takimet e KPK-së, por se tani në cilësi të kryesuesit.

Përpos Hysenit, pjesëmarrje të konsiderueshme në diskutim ka edhe Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi.

Por, ndër anëtarët më pasivë në KPK gjatë vitit 2019 ka qenë anëtarja më e re e KPK-së nga radhët e PSRK-së, Merita Bina-Rugova, pasuar nga anëtarja e KPK-së nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, Dëshirë Jusaj, anëtarja e KPK-së nga Prokuroria e Apelit, Bedrije Alshiqi dhe anëtari i KPK-së nga Prokuroria Themelore e Pejës, Haxhi Sinanaj.

Në vazhdim janë paraqitur të gjitha mbledhjet, në të cilët përfshihen vendimet e marra:

- **KPK takimin e parë në vitin 2019, e ka mbajtur në 14 janar 2019, apo takimin e 160-të.** Gjatë këtij takimi, anëtari i KPK-së, Bahri Hyseni, është zgjedhur kryesues i ri i KPK-së si dhe i është vazhduar mandati edhe për tre (3) vjet Drejtorit të SKPK-së, Lavdim Krasniqi²⁹.
- **KPK takimin e dytë në vitin 2019, e ka mbajtur me 28 janar 2019, apo takimin e 161-të.** Gjatë këtij takimi, KPK ka rishpallur konkursin për Prokurorë në PSRK dhe PA, ka caktuar udhëheqësit e tre (3) departamenteve të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka refuzuar kërkesat e ish-prokurorëve Abdurrahim Islami dhe Faik Halili për dhënien e tre (3) pagave përcjellëse dhe pagave jubilarë si dhe ka miratuar planin e punës së KPK-së për vitin 2019.
- **KPK takimin e tretë në vitin 2019, e ka mbajtur më 21 shkurt 2019, apo takimin e 162-të.** Gjatë këtij takimi, KPK ka miratuar Strategjinë për Krime të Luftës, Rregulloren nr.01/2019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr. 08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve, Raportin Vjetor për vitin 2018 të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për Veprat Penale Karakteristike. Po ashtu, gjatë këtij takimi, para anëtarëve të KPK-së kanë raportuar Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit

²⁹"Ish-deputeti i PDK-së, Bahri Hyseni zgjidhet kryesues i KPK-së".Betimi për Drejtësi.14 janar 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/ish-deputeti-i-pdk-se-bahri-hyseni-zgjidhet-kryesues-i-kpk-se/>). (qasur për herë të fundit më 1 prill 2019).

dhe 7 (shtatë) Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore si dhe Kryetarët e Komisioneve të KPK-së.

- **KPK takimin e katërt në vitin 2019, e ka mbajtur me 1 mars 2019, apo takimin e 163-të.** KPK gjatë këtij takimi ka hapur konkursin për Kryeprokuror të PSRK-së, ka miratuar dorëheqjen e ish-kryesuesit Blerim Isufaj nga pozita e anëtarit të KPK-së, ka shpallur konkursin për anëtar të ri të KPK-së nga radhët e PSRK-së si dhe ka themeluar komisionet për zgjedhjen e Kryeprokurorit të PSRK-së dhe anëtarit të ri të KPK-së nga radhët e PSRK-së. Po ashtu, gjatë këtij takimi, para anëtarëve të KPK-së ka raportuar Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu, i cili ka paraqitur raportin për periudhën tetor – dhjetor 2018³⁰.
- **KPK takimin e pestë në vitin 2019, e ka mbajtur me 27 mars 2019, apo takimin e 164-të.** Në fillim të këtij takimi, para anëtarëve të KPK-së ka dhënë betimin anëtarja e re e KPK-së nga radhët e PSRK-së, Merita Bina-Rugova. Gjatë këtij takimi, Prokurorja Laura Pula ka paraqitur Raportin Vjetor për vitin 2018 të Komisionit Mbikëqyrës për Zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, ka miratuar Planin Strategjik të Sistemit Prokurorial për vitet 2019-2021 si dhe ka miratuar rregulloren nr.02/2019 për Administrimin dhe Ndarjen e Lëndëve në Prokurorin e Shtetit³¹.
- **KPK takimin e gjashtë në vitin 2019, e ka mbajtur me 10 prill 2019, apo takimin e 165-të:** KPK gjatë këtij takimi ka shqyrtuar kundërshtimet e kandidatëve përkitazi me procesin për emërimin e Kryeprokurorit të PSRK-së. Për shkak se dy (2) kundërshtimet e paraqitura nga kandidatët Armend Hamiti dhe Atdhe Demaj u aprovuan, KPK gjatë këtij takimi ka shtyrë votimin për Kryeprokurorë për PSRK-së. Po ashtu, gjatë këtij takimi KPK ka miratuar Rregulloren për Shërbimet e Komunikimit të Publikut Po ashtu, gjatë këtij takimi, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka paraqitur para anëtarëve të KPK-së Raportin Vjetor të Prokurorit të Shtetit për vitin 2018.
- **KPK takimin e shtatë në vitin 2019, e ka mbajtur me 25 prill 2019, apo takimin e 166-të:** Gjatë këtij takimi, KPK ka anuluar procesin për emërimin e Kryeprokurorit të

³⁰"KPK shpall konkursin për Kryeprokuror të Prokurorisë Speciale".Betimi për Drejtësi. 1 mars 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/kpk-shpall-konkursin-per-kryeprokuror-te-prokurorisë-speciale/>). (Qasur për herë të fundit më 1 prill 2019); "Tension në KPK, Shqipdon Fazliu ofron dorëheqje dhe lëshon mbledhjen, votohet pa rekomandime raporti i tij". Betimi për Drejtësi. 1 mars 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/tension-ne-kpk-shqipdon-fazliu-ofron-doreheqje-dhe-leshon-mbledhjen-votohet-pa-rekomandime-raporti-i-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 1 prill 2019); "Jep dorëheqje nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, ish-kryesuesi Blerim Isufaj".Betimi për Drejtësi. 1 mars 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/jep-doreheqje-nga-keshilli-prokurorial-i-kosoves-ish-kryesuesi-blerim-isufaj/>). (Qasur për herë të fundit më 1 prill 2019).

³¹"KPK miraton planin strategjik 2019-2021, Merita Bina-Rugova betohet si anëtare e re nga radhët e PSRK-së".Betimi për Drejtësi. 27 mars 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/kpk-miraton-planin-strategjik-2019-2021-merita-bina-rugova-betohet-si-anetare-e-re-nga-radhet-e-psrk-se/>). (Qasur së fundi më 1 prill 2019).;"Kryeprokurori Lumezi thotë se korrupsioni në Kosovë është realitet e jo perceptim, pranon se s'po luftohet sa duhet kjo dukuri". Betimi për Drejtësi. 27 mars 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-lumezi-thote-se-korrupsioni-ne-kosove-eshte-realitet-e-jo-perceptim-pranon-se-spo-luftohet-sa-duhet-kjo-dukuri/>). (Qasur së fundi më 1 prill 2019).;"KPK-ja refuzon kërkesën e ish-prokurorit Hamitaga për kompensim të pagave për kohën sa kishte qenë i suspenduar". Betimi për Drejtësi. 27 mars 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/kpk-ja-refuzon-kerkesen-e-ish-prokurorit-hamitaga-per-kompensim-te-pagave-per-kohen-sa-kishte-qene-i-suspenduar/>). (Qasur së fundi më 1 prill 2019).

PSRK-së, dhe si u.d. të Kryeprokurorit të kësaj prokurorie ka caktuar prokurorin Afrim Shefkiu. Po ashtu, KPK gjatë këtij takimi ka marrë vendim për shpalljen e konkursin për avancimin e dy (2) prokurorëve në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore të Prishtinës dhe për avancimin e një prokurori në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

- **KPK takimin e tetë në vitin 2019, e ka mbajtur me 10 maj 2019, apo takimin e 167-të.** KPK gjatë këtij takimi ka emëruar anëtarët e task-forcës dhe grupit monitorues për Strategjinë e Krimeve të Luftës. Po ashtu, KPK gjatë këtij takimi i ka propozuar Presidentit të Republikës së Kosovës shkarkimin e prokurorit Agron Matjani si dhe ka suspenduar me pagesë një prokurore.
- **KPK takimin e nëntë në vitin 2019, e ka mbajtur me 7 qershor 2019, apo takimin e 168-të:** KPK gjatë këtij takimi ka miratuar Rregulloren për Përgjegjësinë Disiplinore të Prokurorëve, ka rishpallur konkurs për avancim të një prokurori në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, ka aprovuar kërkesën buxhetore për periudhën kohore 2020-2022, ka miratuar Raportin për Vlerësimin e Performancës për 13 prokurorë si dhe ka aprovuar kërkesën e ish-prokurorit Bajram Hamitaga për kompensimin e pagave gjatë kohës sa ka qenë i suspenduar.
- **KPK takimin e dhjetë në vitin 2019, e ka mbajtur me 3 korrik 2019, apo takimin e 169-të:** Gjatë këtij takimi, KPK ka refuzuar ankesën e Prokurorit Ibrahim Berisha për caktimin e Prokurorit Kujtim Munishi në pozitën e u.d. të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka miratuar listën e prokurorëve të cilët sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve do të shërbejnë në panelet hetimore si dhe ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel.
- **KPK takimin e njëmbëdhjetë në vitin 2019, e ka mbajtur me 1 gusht 2019, apo takimin e 170-të:** Gjatë këtij takimi, KPK ka miratuar Rregulloren për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, ka shpallur konkurset për emërimin e Kryeprokurorit të PSRK-së dhe Kryeprokurorit të PTh në Prishtinë, ka shqyrtuar raportin e mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për veprat penale karakteristike për periudhën kohore janar – mars 2019, ka transferuar një prokuror nga PTh në Ferizaj në PTh në Mitrovicë, ka bërë transferimin e përhershëm të një prokuroreje nga Departamenti për të Mitur në PTh në Prizren, në Departamentin për Krime të Rënda të kësaj prokurorie si dhe ka avancuar një prokuror të PTh-së në Gjakovë nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për të mitur. Po ashtu, gjatë këtij takimi, para anëtarëve të KPK-së kanë raportuar të gjithë kryeprokurorët e prokurorive.
- **KPK takimin e dymbëdhjetë në vitin 2019, e ka mbajtur me 3 shtator 2019, apo takimin e 171-të:** KPK gjatë këtij takimi ka zgjedhur panelet vlerësuese për emërimin e Kryeprokurorit të PSRK-së dhe PTh-së në Prishtinë, ka shpallur konkurs për avancimin e një prokurori në PTh në Gjakovë nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda, ka shqyrtuar raportin e Komisionit Mbikëqyrës për zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimtimit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin Ekonomik për periudhën kohore janar – qershor 2019 si dhe ka shqyrtuar

raportin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, për periudhën kohore prill – qershor 2019. Po ashtu, KPK ka aprovuar edhe rekomandimin e komisionit në përbërje nga anëtarët Arben Ismajli, Ikramije Bojaxhiu dhe Dardan Maloku, për refuzimin e kërkesës së ushtruar nga ish-prokurori Feti Tunuzliu, për tri paga jubilarë, ndërsa, për trajtimin e një kërkesë të njëjtë të ushtruar nga ish-prokurorja Shpresa Bakija dhe ish-prokurori Xhavit Osmani, Këshilli themeloi një komision në përbërje po ashtu të njëjtë si tek kërkesa e ish-prokurorit Tunuzliu.

- **KPK takimin e trembëdhjetë në vitin 2019, e ka mbajtur me 27 shtator 2019, apo takimin e 172-të:** KPK gjatë këtij takimi ka miratuar listën përfundimtare të kandidatëve për Kryeprokurorë të PTh-së në Prishtinë, ku në këtë listë janë prokurorët Fitore Sadikaj, Kujtim Munishi, Fatmir Behrami dhe Valdet Gashi. KPK gjatë këtij takimi ka miratuar edhe listën përfundimtare të kandidatëve për Kryeprokurorë të PSRK-së, në të cilën listë si kandidatë janë prokurorët Blerim Isufaj, Atdhe Dema, Haki Gecaj, Armend Hamiti dhe Afrim Shefkui. Po ashtu, KPK gjatë këtij takimi ka avancuar një prokurorë në PTh në Gjakovë nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda, ka themeluar një panel hetimor si dhe ka Raportin përfundimtar të Komisionit për Vlerësimin e Performancës për dy prokurorë me mandat fillestar.
- **KPK takimin e katërbëdhjetë në vitin 2019, e ka mbajtur me 22 tetor 2019, apo takimin e 173-të:** Gjatë këtij takimi, para anëtarëve të KPK-së kanë raportuar kryesuesit e katër (4) komisioneve të përhershme të KPK-së. Po ashtu, gjatë këtij takimi KPK ka miratuar politikën e trajnimit për prokurorët dhe stafin administrativ, si dhe ka themeluar panelet hetimore në dy (2) raste disiplinore.
- **KPK takimin e pesëmbëdhjetë në vitin 2019, e ka mbajtur me 12 nëntor 2019, apo takimin e 174-të:** Në këtë takim, KPK ka shqyrtuar raportet e Komisioneve për Rishqyrtim për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për Kryeprokuror të PSRK-së dhe PTh në Prishtinë. Po ashtu, gjatë këtij takimi është prezantuar dhe miratuar raportin i mekanizmit përcjellës ndër institucional për veprat penale karakteristike për periudhën kohore janar – shtator 2019.
- **KPK takimin e gjashtëmbëdhjetë në vitin 2019, e ka mbajtur me 23 dhjetor 2019, apo takimin e 175-të:** Në këtë takim, KPK ka zgjedhur ish-kryesuesin e KPK-së, Blerim Isufaj, Kryeprokuror të PSRK-së, derisa Kujtim Munishi është zgjedhur Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Po ashtu, gjatë këtij takimi, KPK ka hapur konkurs për avancimin e prokurorëve në Prokuroritë Themelore në Pejë, Prizren dhe Mitrovicë.

7. Gjetjet e veçanta të monitorimit të IKD-së për KGJK dhe KPK

IKD në këtë pjesë të raportit paraqet gjetjet e veçanta të monitorimit sistematik për KGJK-në dhe KPK-në, të cilat janë përshkruar gjatë vitit 2019. Për të gjitha këto gjetje të veçanta, IKD ka raportuar në baza të rregullta për publikun përmes portalit “Betimi për Drejtësi” si dhe përmes publikimit të reagimeve të shkurtra në formë të komunikatave për media³².

7.1. Konflikti i interesit në zgjedhjen e anëtarëve të këshillave në pozita udhëheqëse të prokurorive/gjykatave

Më 1 mars 2019, KPK ka miratuar dorëheqjen e ish-kryesuesit të KPK-së, Blerim Isufaj nga pozita e anëtarit të KPK-së.

Në po të njëjtën ditë, KPK ka shpallur konkursin për kryeprokuror të ri të PSRK-së.

Pas dhënies së dorëheqjes nga pozita e anëtarit të KPK-së, ish-kryesuesi Isufaj i ka hyrë garës për kryeprokuror të ri të PSRK-së, me ç’rast kandidatura e tij është miratuar nga KPK në takimin e 172-të, të mbajtur me 27 shtator 2019.

Ndërsa, përfundimisht, Isufaj në takimin e 175-të të KPK-së të mbajtur me 23 dhjetor 2019, me vota unanime është zgjedhur kryeprokuror i ri i PSRK-së. Në këtë rast, Isufaj ka marrë 10 vota për kryeprokurorë, nëntë (9) prej të cilave nga ish-kolegët e tij anëtarë të KPK-së.

Për mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së në pozita udhëheqëse në prokurori, duke dhënë formalisht dorëheqje pak para kandidimit për këto pozita, IKD konsideron se kemi të bëjmë me konflikt të interesit.

Neni 12 i Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial në paragrafin 4 ka përcaktuar se “*Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të anëtarit të Këshillit, i njëjti nuk mund të ngritet në detyrë, si dhe nuk mund të emërohet Kryeprokuror i Prokurorisë përkatëse*”.

Në rastin konkret, me qëllim shmangies nga ndalimi në këtë nen, ish-kryesuesi i KPK-së, Blerim Isufaj, ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të KPK-së pikërisht në ditën kur është shpallur konkursi për pozitën që Isufaj ka pretenduar dhe në të cilën edhe është zgjedhur.

Nisur nga fakti se tanimë ish-anëtari i KPK-së votohet pikërisht nga kolegët e tij për një pozitë të caktuar, kjo domosdoshmërisht se i vë në pozitë të pabarabartë të gjithë kandidatët e tjerë.

Por në anën tjetër, kjo situatë ndalohet specifikisht nga Ligji nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

³²*Shënim:* IKD si rezultat i monitorimit sistematik të KGJK-së dhe KPK-së dhe në përgjithësi të sistemit të drejtësisë, institucioneve dhe agjencioneve që e zbatojnë ligjin, përgatitë raporte ditore, të cilat i publikon në portalin e specializuar për fushën e sundimit të ligjit “Betimi për Drejtësi” (ëëë betimiperdrejtesi.com) si dhe në uebfaqen e organizatës publikon reagime të shkurtra përmes formës së komunikatave për media (ëëë kli-ks.org). Të gjitha raportimet për KGJK dhe KPK janë të qasshme në këto dy dritare të informimit për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Neni 18 i këtij ligji ka përcaktuar kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike.

Ndër të tjera, ky nen ka përcaktuar se: “1. **Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë:**1.1. të punësohet ose **të emërohet**, për një periudhë deri në **dy (2) vjet pas përfundimit** të funksionit publik, **në pozitë udhëheqëse ose menaxhuese**, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe **institucioneve vartëse** të tyre të cilat kanë marrëdhënie biznesi **me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik**, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik **kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre..”.**

Sipas nenit 3.1.1.3 të këtij ligji, “Zyrtar i lartë nënkupton zyrtarët e lartë publikë të përcaktuar sipas Ligjit përkatës”, derisa sipas nenit 3.1.1.1.9 të Ligjit 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarëve, si zyrtarë të lartë publik kategorizohen edhe “*Anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, Auditori Gjyqësor, Prokurori Disiplinor*”.

Në kuptim të menaxhimit, PSRK ashtu si secila prokurori tjetër, është institucion vartës i KPK-së. Kjo manifestohet edhe nga kompetencat e KPK-së sipas Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili ligj në nenin 7, ndër të tjera, përcakton se KPK: ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim: “1.1. vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të prokurorive sipas ligjit...1.4. vendos për emërimin e kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit, në pajtim me Ligjin për Prokurorinë e Shtetit dhe Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës...1.9. vendos për numrin e prokurorëve në secilin Prokurori...1.11. vendos për avancimin, transferimin dhe disiplinimin e prokurorëve. 1.12. vendos kriteret për vlerësimin e prokurorëve, për ngarkesën me lëndë të prokurorive dhe për funksionim efikas të prokurorive si dhe kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit dhe shqyrton ankimet e prokurorëve për vlerësimin e tyre...1.20. mbikëqyrjen dhe administrimin e prokurorive dhe personelit të saj”.

Në këtë mënyrë, zgjedhja e Isufaj në pozitën e Kryeprokurorit të PSRK-së, duke dhënë dorëheqje pikërisht në ditën e shpalljes së konkursit për këtë pozitë nga pozita e anëtarit të KPK-së, është rast tipik i ndalesës së zyrtarit të lartë publik sipas nenit 18 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Pra, zgjedhja e Isufaj në pozitën e kryeprokurorit të PSRK-së paraqet konflikt interesi sipas këtij ligji.

Në anën tjetër, dispozita e nenit 18 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik vlenë në mënyrë identike edhe për anëtarët e KGJK-së. Pra, sikurse anëtarët e KPK-së, as anëtarët e KGJK-së nuk mund të zgjidhen kryetarë të gjykatave deri pas periudhës dy (2) vjeçare prej kur e përfundojnë mandatin e tyre si anëtarë të këshillit.

Andaj, respektimi i ligjeve në fuqi dhe shmangia nga konflikti i interesit tek anëtarët e këshillit është një domosdoshmëri për të cilën këshillat duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë.

Krahas ndalesës së zgjedhjes së anëtarëve të këshillave në pozitën e kryeprokurorit/kryetarit të gjykatës sipas nenit 18 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si KGJK ashtu edhe KPK duhet ta kenë parasysh se zhvillimi i tillë i proceseve emëruese është minim i meritokracisë si dhe dëmtrim i imazhit të sistemit të drejtësisë.

Lidhur me minimin e meritokracisë, ky konstatim i IKD-së në asnjë rrethanë nuk deklaron se personat e emëruar nuk janë meritore, por ndërlihet me procesin si tërësi, dhe vënie në pozitë të pabarabartë të kundër kandidatëve të tanimë ish-anëtarit të këshillit.

Për këtë arsye, si KPK, ashtu edhe KGJK duhet të respektojnë ndalesat ligjore dhe të shmangin praktikat e tilla të emërimeve në pozita të larta menaxheriale brenda sistemit të drejtësisë.

7.2. Bojkoti i Avokatëve ndaj Gjyqësorit

Me 28 dhjetor 2018, KGJK kishte nxjerrë rekomandim sipas të cilit, avokatët lejohen që të qasen në objektet e Gjykatës vetëm sipas ftesës apo lejes paraprahe të gjyqtarit.

Lidhur me këtë rekomandim, më 5 janar 2019 kishte reaguuar OAK, ndërsa me 9 janar 2019 avokatët kishin hyrë në bojkot të përgjithshëm, duke mos marrë pjesë në asnjë seancë.

Ky bojkot kishte zgjatur mbi dy ditë, e që si pasojë kishte pasur shtyrjen e qindra seancave gjyqësore.

Më 10 janar 2019, KGJK kishte mbajtur një takim të jashtëzakonshëm, ku ishte diskutuar situata e krijuar. Gjatë këtij takimi, ish- Kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, ka thënë se qëllimi i rekomandimit nuk ka qenë kufizimi i qasjes së avokatëve në gjykata, por ndalimi i komunikimit në mes gjyqtarëve dhe avokatëve, pa qenë e pranishme pala tjetër, përkatësisht komunikimit “ex-parte”.

Gjatë këtij takimi, KGJK ka nxjerrë vendim me të cilin ka autorizuar Komisionin për Çështje Normative që në bashkëpunim me Komisionin për Administrimin e Gjykatave dhe Kryetarët e Gjykatave të rishikojë dhe hartojë rregulla unike dhe të përbashkëta për rendin shtëpiak në Sistemin Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Sipas vendimit, kjo duhet të bëhet brenda një afati të arsyeshëm kohor. Deri më 31 mars 2019, KGJK nuk ka njoftuar se në cilën fazë është hartimi i këtyre rregullave.

Një ditë pas nxjerrjes së këtij vendimi, OAK kishte pezulluar bojkotin.

Lidhur me bojkotin e avokatëve, më 10 janar 2019 kishte reaguuar publikisht edhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD).³³

Sipas IKD-së, KGJK dhe OAK duhet të anulojnë vendimet e tyre të kundërligjshme që kanë prodhuar kufizime, bojkot dhe bllokadë të punës në sistemin e drejtësisë në dëm të drejtësisë dhe qytetarëve.

“IKD si organizata e vetme që monitoron sistematikisht sistemin gjyqësor dhe prokurorial, gjen se këto vendime janë duke prodhuar dëme të mëdha, të cilat po ndikojnë drejtpërdrejtë në shkeljen e të drejtave të qytetarëve. Bazuar në të dhënat e monitorimit sistematik të IKD-së, rezulton se vetëm me 9 janar 2019, janë shtyrë 161 seanca gjyqësore në çështjet penale. Në të gjitha këto raste, më së shumti janë duke pësuar palët në procedurë, duke mos arritur të realizojnë të drejtat e tyre të garantuara me legjislacionin pozitiv. IKD shpreh shqetësim për këtë situatë të krijuar për shkak të qasjes së KGJK-së dhe OAK-së, të cilat kanë ndikuar që një numër i madh i rasteve të natyrës urgjente siç janë ato të paraburgimit të dështojnë më 9 janar 2019. Me këtë problem janë duke u ballafaquar gjykatësit dhe prokurorët edhe sot me datë 10 janar 2019 për shkak të natyrës urgjente që kanë këto raste, të cilat nuk mund të procedohen pa përfaqësimin e avokatëve. IKD ka analizuar vendimet respektive të këtyre dy institucioneve dhe pasojat e krijuara si rezultat i kësaj situate. IKD vlerëson se KGJK ka vepruar në mënyrë të gabuar dhe pa bazë kur ka nxjerrë vendim/rekomandim për ta rregulluar çështjen e qasjes së avokatëve në gjykata. Vendimi i KGJK-së për më tepër është selektiv, i pabazuar dhe pa arsytuar si duhet, i cili ka prodhuar pasoja, duke shkaktuar dëme tek palët, duke zvarritur proceset gjyqësore. IKD po ashtu shpreh shqetësimin lidhur me mënyrën se si Oda e Avokatëve të Kosovës ka reaguuar dhe e ka menaxhuar këtë situatë si rezultat i vendimeve të KGJK-së. OAK padyshim se në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të saj ka nxitjen e një qasjeje sa më të plotë dhe të barabartë të përfaqësimit ligjor për të gjithë personat pa marrë parasysh kushtet ekonomike dhe sociale. OAK ka për mision të vendosë standarde të larta të profesionalizmit, kompetencës, besimit dhe sjelljes etike për avokatët në Kosovë. Për më tepër, Oda i konsideron synime të përhershme angazhimet për ruajtjen e pavarësisë së profesionit ligjor dhe pushtetit gjyqësor si themele të shoqërisë së lirë e demokratike. Në këtë drejtim, edhe Vendimi i OAK që në mënyrë të njëanshme dhe të bojkoton në mënyrë të përgjithshme dhe të pakufizuar të gjitha seancat gjyqësore, përfshirë rastet e paraburgimit, si dhe bojkotimin e përfaqësimit të rasteve në Polici dhe Prokurori, bie në kundërshtim me vlerat dhe parimet që i promovon ky institucion. Rrjedhimisht, përmes këtij vendimi, cenohen të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve, rastet e cilëve nuk mund të procedohen pa përfaqësimin e mbrojtjes nga avokatët. Në të njëjtën kohë si KGJK ashtu edhe OAK, kanë injoruar obligimet që dalin nga ligji i aplikueshëm në Kosovë, e veçanërisht në drejtësinë penale. Këto dy institucione përmes vendimeve dhe veprimeve të tyre kanë shkelur parimet dhe standardet e përcaktuara më Kodin e Procedurës Penale” thuhej në reagimin e IKD-së.

³³ “IKD: KGJK dhe OAK të anulojnë vendimet e tyre të kundërligjshme që kanë prodhuar kufizime, bojkot dhe bllokadë të punës në sistemin e drejtësisë në dëm të drejtësisë dhe qytetarëve”. Reagim nga Instituti i Kosovës për Drejtësi. 10 janar 2019. (shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-kgjk-dhe-oak-te-anulojne-vendimet-e-tyre-te-kunderligjshme-qe-kane-prodhuar-kufizime-bojkot-dhe-bllokade-te-punes-ne-sistemin-e-drejtjesise-ne-dem-te-drejtjesise-dhe-qytetareve/>)

IKD i ka rekomanduar KGJK-së që Vendimi lidhur me rregullin dhe disiplinën në gjykatat e Kosovës, duhet të bëhet përmes aktit nënligjor respektivisht rregullores së miratuar në KGJK. Rregullorja duhet të jetë e bazuar në ligj, duke respektuar dhe promovuar standarde që rrisin besimin e publikut dhe integritetin në sistemin gjyqësor të Kosovës, por që në të njëjtën kohë i mbrojnë dhe i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjitha palët në procedurë gjyqësore. Po ashtu, sipas IKD-së, OAK duhet të tërheqë urgjentisht vendimin për ndalimin e përfaqësimit të avokatëve në të gjitha rastet, duke lejuar përfaqësimin në rastet e natyrës urgjente, siç kërkohet me ligj dhe në komunikim dhe koordinim me KGJK-në të gjejnë një zgjidhje për të mundësuar zhvillimin e procedurave gjyqësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm³⁴.

Nxjerrja e rregullave unike mbi rendin shtëpiak është bërë me 12 dhjetor 2019, kur KGJK ka miratuar Udhëzimin Administrativ për Rregullat Unike dhe të Përbashkëta për Rendin Shtëpiak në Gjykata, në të cilin udhëzim administrativ janë përcaktuar llojet e hapësirave brenda gjykatave dhe rregullat specifike për qasje në këto hapësira.

7.3. Problemet gjatë periudhës tranzitore për funksionalizimin e Departamentit Special

Më 2 janar të këtij viti ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat. Neni 13.1.1. i këtij Ligji përcakton themelimin e Departamentit Special për Lëndët në Kompetencë të PSRK-së. Sipas këtij ligji, ky departament vepron në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës, me kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 42.1 të këtij Ligji, KGJK obligohet që të funksionalizojë dhe caktojë gjyqtarët për këtë departament brenda 6 muajve. I njëjti nen i këtij ligji në paragrafin 4 ka paraparë se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha lëndët që janë në kompetencë të PSRK-së kalojnë në këtë departament, përjashtimisht lëndëve për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar, të cilat vazhdojnë të gjykohen nga departamenti për krime të rënda. Sa i përket Gjykatës së Apelit, Ligji ka paraparë se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, lëndët e reja trajtohen nga Departamenti për Lëndët në Kompetencë të PSRK-së në Gjykatën e Apelit.

Por, ndonëse KGJK është brenda afatit sa i përket funksionalizimit të këtij departamenti, i cili përfundon me 2 qershor 2019, ky institucion për tre muaj rresht nuk ka nxjerrë asnjë vendim ose udhëzim se si të veprohet gjatë kësaj kohe, nëse pranohen lëndë të reja. Në këtë drejtim, ka pasur ankesa edhe nga Gjykata Themelore e Prishtinës, se si të veprohet nëse ngritët një aktakuzë e re nga PSRK apo kërkohet caktimi i ndonjë mase për sigurinë e të pandehurit në procedurë penale.

³⁴ “IKD: KGJK dhe OAK të anulojnë vendimet e tyre të kundërligjshme që kanë prodhuar kufizime, bojkot dhe bllokadë të punës në sistemin e drejtësisë në dëm të drejtësisë dhe qytetarëve”. IKD.10 janar 2019. (shih linkun <https://kli-ks.org/ikd-kgjk-dhe-oak-te-anulojne-vendimet-e-tyre-te-kunderligjshme-qe-kane-prodhuar-kufizime-bojkot-dhe-bllokade-te-punes-ne-sistemin-e-drejtjesise-ne-dem-te-drejtjesise-dhe-qytetareve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 prill 2019).

Një vendim i tillë është nxjerrë tek më 5 prill 2019, ndonëse për këtë çështje ishte diskutuar në KGJK edhe më 31 janar 2019³⁵. Sipas këtij vendimi të gjitha lëndët e PSRK-së që janë në procedurë paraprake dhe ato për të cilat ende nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të barten nga të gjitha Gjykatat Themelore të Kosovës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndërsa shqyrtimi i tyre do të bëhet me prioritet sapo të funksionalizohet Departamenti Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit. Lëndët për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të vazhdojnë të shqyrtohen në gjykatat përkatëse, deri në përfundimin e tyre.

Sipas pikës 5 të këtij vendimi, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë do të caktojë një gjyqtar nga Departamenti për Krime të Rënda i cili krahas detyrave të tjera, do të angazhohet edhe në procedurë paraprake për këto lëndë. Sipas pikës 6 të këtij vendimi, edhe Kryetari i Gjykatës së Apelit do të caktojë një koleg prej gjyqtarëve të Departamentit për Krime të Rënda të cilët do të vendosin lidhur me ankesat nga procedura paraprake për këto lëndë³⁶.

7.4. KGJK shkel rregulloren që vet e ka miratuar

KGJK në takimin e 210-të të mbajtur me 10 janar 2019 e ka zgjedhur Gjyqtaren Liliana Stefanoviq në pozitën e Gjyqtares Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore të Mitrovicës – dega në Zubin Potok.

Por, ndonëse në vitin 2017 KGJK ishte sfiduar mjaft shumë derisa kishte miratuar rregulloren për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, KGJK e ka shkelur këtë rregullore me rastin e zgjedhjen së gjyqtares Liliana Stefanoviq në këtë pozitë.

Ish-kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, gjatë këtij takimi bëri të ditur se pas pensionimit të gjyqtarit mbikëqyrës për degën e Zubin Potokut, KGJK ka hapur konkurs për këtë pozitë, ku si e vetme ka aplikuar gjyqtarja Liliana Stefanoviq.

Anëtarja e KGJK-së, gjyqtarja Makifete Saliuka, ka bërë të ditur se komisioni për intervistim ka zhvilluar procedurat, ku si kandidate e vetme ka qenë gjyqtarja Liliana Stefanoviq.

Anëtari tjetër i KGJK-së, Nenad Laziq, ka thënë se Stefanoviq nuk ka asnjë masë disiplinore.

Fakti se Stefanoviq ka qenë kandidate e vetme për këtë pozitë ka shërbyer si fakt që KGJK votimin ta bëjë në mënyrë të hapur dhe në kundërshtim me rregulloren (05/2017) për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores (14/2016) si dhe për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (09/2017) për procedurat e zgjedhjes, emërimit, vlerësimit, pezullimit dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës.

³⁵"Anëtarët e KGJK-së e vlerësojnë të padrejtë trajtimin e tyre në Projektligjin për Pagat".Betimi për Drejtësi.31 janar 2019. (shih linkun <https://betimiperdrejttesi.com/anetaret-e-kgjk-se-e-vleresojne-te-padrejte-trajtimin-e-tyre-ne-projektligjin-per-pagat/>). (Qasur për herë të fundit me 12 prill 2019).

³⁶Vendimi nr.83/2019.KGJK.5 prill 2019. (Shih linkun <http://gjyqesori-rks.org/GetDocument/16699>). (Qasur për herë të fundit më 12 prill 2019).

Neni 4 i kësaj rregulloreje përcakton procedurat e përzgjedhjes në KGJK. Paragrafi 3 i këtij neni përcakton se “Përzgjedhja e kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës bëhet përmes votimit të fshehtë”. Kjo rregullore nuk bën dallim në faktin nëse në proces është një ose më tepër kandidatë për përzgjedhje.

Paragrafi 9 i këtij neni përcakton se “Anëtari i Këshillit mund të abstenojë nga votimi para fillimit të procesit të votimit”. Në votimin për gjyqtarin mbikëqyrës të degës së Zubin Potok, nuk është pyetur fare nëse dikush nga anëtarët dëshiron të abstenojë nga procesi.

Ndryshe, miratimi i ndryshimit të rregullores për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës kishte ardhur pas situatës së krijuar kur Gjykata Kushtetuese kishte anuluar procesin për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme dhe asaj të Apelit.

Por, në KGJK konsiderojnë se ky proces ka qenë në rregull.

“Anëtarët e KGJK-së veç kanë qenë në dijeni për mundësinë e abstenimit dhe asnjëri prej tyre nuk është deklaruar se dëshiron të abstenojë. Ne konsiderojmë se ky proces është në rregull”³⁷.

IKD e vlerëson shumë shqetësuese praktikën e ndërtuar nga KGJK për mos zbatimin e rregulloreve që vetë i ka miratuar. Kjo është shembulli më i keq për të gjithë akterët e tjerë të sistemit gjyqësor. Për më tepër, kjo qasje sjell deri tek përfundimi që qëllimi i këtij institucioni është miratimi i legjislacionit sekondar dhe politikave në letër, por jo edhe zbatimi i tyre në praktikë.

7.5. Akuzat e sistemit prokurorial lidhur me dështimet në luftimin e korrupsionit

Gjatë vitit 2018, të dy këshillat kanë hedhur akuza të ndërsjella lidhur me dështimin e sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit. Më konkretisht, në atë se kush është fajtor lidhur me dështimin e aktakuzave të profilit të lartë.

Gjatë vitit 2019, “akuza” të tillë nuk ka pasur nga sistemi gjyqësor, por vetëm nga ai prokurorial.

Në takimin e 162-të të KPK-së të mbajtur me 21 shkurt 2019, para anëtarëve të KPK-së është paraqitur Raporti Vjetor i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për Veprat Penale Karakterisitike. Sipas këtij raporti, prej 100 ankesave që prokurorët kishin ushtruar në Gjykatën e Apelit lidhur me këto vepra penale, vetëm 6% e tyre janë aprovuar.

Lidhur me këtë fakt, kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, ka thënë se me gjasë, është bërë praktikë hudhja e ankesave të prokurorit të shtetit. “Nga 100 ankesa, i kemi vetëm 6 apo 7 prej tyre të aprovuara. Duhet të shikojmë se për këto ankesa a është krijuar një praktikë për hudhjen e tyre, apo ne ende nuk kemi arritur ta përmirësojmë cilësinë e ankesave. Me gjasë është krijuar praktikë hudhja e këtyre ankesave” ka thënë Hyseni.

³⁷IKD intervistë përmes postës elektronike me znj. Ajshe Zejnullahu - Nuza, Zyrtare e Lartë Ligjore në KGJK. 10 prill 2019.

Lidhur me këtë raport, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka thënë se fajtori për dështimin në luftën kundër korrupsionit nuk duhet të kërkohet në prokurori.

Në një konferencë të organizuar nga OSBE me 27 mars 2019 kishte qenë prezent edhe Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, i cili përsëri, sikurse gjatë vitit të kaluar, ka deklaruar se gjykatat i hudhin aktakuzat kur bëhet fjalë për “persona të rëndësishëm me emër dhe mbiemër”.

Akuza në drejtim të gjyqësorit ka hedhur edhe ish-Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Imer Beka. Në takimin e 162-të të 21 shkurtit, teksa raportonte para anëtarëve të KPK-së, ai ka thënë se më shumë ka ushtrim të ndikimit në Gjykatë se sa në Prokurori, pasi “ne nuk akuzojmë njerëz pa prova”.

Siç është thënë edhe në raportin e kaluar, IKD e sheh si shumë shqetësuese lojën “ping-pong” në mes të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor lidhur me dështimin e tyre për ta luftuar korrupsionin e profilit të lartë. Në këtë drejtim, duhet të kontribuojnë të dy sistemet. Por, është e njohur përgjithësisht, se në rastin kur një prokuror e dërgon në gjykatë një aktakuzë e cila ka prova bindëse ndaj të akuzuarve, gjykata e ka jashtëzakonisht të vështirë që t’i shmanget vendimit të drejtë. Po ashtu, Prokurori i Shtetit ka në dispozicion mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike, në rast se nuk është i kënaqur me vendimin e gjykatës. Po ashtu, është detyrë e Prokurorit të Shtetit, që në rast se vërtetohet se gjykatat po i hudhin aktakuzat në rastet kur, siç thotë Kryeprokurori i Shtetit Lumezi, bëhet fjalë për emra të mëdhenj, të hetojë dhe të dërgojë para drejtësisë gjyqtarë të caktuar, pasi “nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore” në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është vepër penale. Kështu duhet të funksionojë ky relacion dhe Prokurorit të Shtetit në asnjë formë nuk i lejohet që të komentojë aktgjykimet e gjykatave, për shkak se kjo përbën shkelje të Kodit të Etikës.

Lidhur me këtë çështje, KPK nuk është përgjigjur në kërkesën e drejtuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi.

7.6. Raportimi “blanko” i Kryeprokurorëve

KPK më 29 dhjetor 2015, ka miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Funksionimin e Prokurorit të Shtetit. Neni 9 i kësaj rregullore përcakton përgjegjësitë e Kryeprokurorëve në raport me KPK-në. Pika 1.4 e këtij neni obligon Kryeprokurorët që **në baza tre mujore** t’i dorëzojnë KPK-së raport me shkrim lidhur me **punën** e prokurorisë, **vështirësitë** dhe **propozimin** e masave lidhur me përmirësimin e performancës së prokurorisë.

KPK në takimin e 162-të të mbajtur me 21 shkurt 2019 ka ftuar Kryeprokurorin e PA-s dhe 7 (shtatë) Kryeprokurorët e PTH-ve për të raportuar para anëtarëve të KPK-së për periudhën kohore janar – dhjetor 2018 dhe janar 2019.

Kryeprokurorët kanë pasur në agjendë që për këto periudha kohore të raportojnë lidhur me rastet PP dhe PPN për rastet e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, zbatimin e projektit

TIK/SMIL, si dhe numrin e lëndëve të trashëguara, pranuar, zgjidhura dhe të mbetura në punë në janar të këtij viti.

Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, ka thënë se kërkesa e tij drejtuar kryeprokurorëve është e bazuar në nenin 4, paragrafi 1, nen paragrafi 1.4 të Ligjit nr.03/L-224 për KPK-në. Ky nen përcakton që KPK “*mbikëqyr administrimin e prokurorive dhe personelit të saj*”.

IKD rikujton se raportimi i përcaktuar në nenin 9, pika 1.4 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Funksonimin e Prokurorit të Shtetit është një detyrim ligjor për KPK-në, procedura për zbatimin e të cilit përcaktohet në vetë këtë rregullore. Ky nen decidivisht përcakton afatin kohor për raportim si dhe çka raportohet. Në këtë drejtim, detyrimi ligjor për KPK-në është që të ftojë çdo tre muaj kryeprokurorët për të raportuar para anëtarëve të këshillit si dhe nga ta të kërkojë të raportojnë për çështjet të cilat rregullorja i kërkon, e që janë: 1. Puna e Prokurorisë, 2. Vështirësitë dhe 3. Propozimi i masave.

Për më tepër, qëllimi i periudhës raportuese, “*çdo 3 (tre) muaj*”, nuk është pa asnjë qëllim. Përmes raporteve të ndryshme me shkrim apo formave të tjera të informimit, KPK do të informohet në përgjithësi për punën e një prokurorie, edhe sikur mos të ekzistonte fare ky obligim i prokurorëve. Por, në mënyrë që KPK të jetë e informuar vazhdimisht për punën dhe vështirësitë e prokurorive, është përcaktuar ky afat kohor, në mënyrë që KPK të ketë mundësi që të reagojë me kohë për secilin problem.

Raportimi 13 (trembëdhjetë) mujor i kryeprokurorëve në KPK, në asnjë mënyrë nuk e përmbushë detyrimin ligjor që kryeprokurorët të raportojnë para anëtarëve të KPK-së çdo 3 (tre) muaj, e që i bie se duhet të raportojnë katër (4) herë në vit.

Krejt në fund, sipas IKD-së, kjo mënyrë e raportimit “bllanko” për të “përmbushur” të gjitha obligimet ligjore me një veprim, është shembulli më reprezentativ që tregon se KPK nuk është e interesuar për të forcuar mekanizmat e kontrollit të brendshëm me qëllim të avancimit të punës së Prokurorit të Shtetit.

Për këtë të gjetur, përgjigja e KPK-së është se do të ftojë kryeprokurorët për të raportuar edhe mbi baza tremujore, ndonëse deri më tani, kjo nuk është bërë.

“KPK në bazë të analizave vendos për temat që kryeprokurorët do të raportojnë, për neve ka qenë me rëndësi që kryeprokurorët të raportojnë për këto tema kur dihet që jemi në fazën përfundimtare të lansimit të projektit SMIL. Kryeprokurorët do të ftohen që të raportojnë për periudhën janar – mars 2019”³⁸.

7.7. Tensionet e KPK-së me Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike

Në takimin e 163-të të KPK-së të mbajtur me 1 mars 2019, para anëtarëve të KPK-së ka raportuar Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu.

³⁸IKD intervistë përmes postës elektronike me z. Astrit Kolaj–Zyrtar për informim në KPK.10 prill 2019.

Ky raportim i Fazliut ka kaluar me tensione gjatë këtij takimi.

Deri te tensionimi, ka ardhur pasi që lidhur me raportimin e Fazliut ka pasur pakënaqësi nga anëtarët e KPK-së, ndaj të cilëve Fazliu ka reaguar duke thënë se edhe mund të ofrojë dorëheqje, nëse vlerësohet se dikush tjetër mund ta bëjë punën e tij më mirë.

Një tension i tillë ka vazhduar gjatë gjithë kësaj mbledhje, me ç'rast Fazliu në fund edhe e ka lëshuar takimin, pasi që anëtarët e KPK-së, kanë vendosur që raporti i tij të votohet pa rekomandime.

Para se të ndodhte kjo, raportimin e tij, Fazliu e nisi duke thënë se nuk ka pas shumë ndryshime në punën e Prokurorit të Shtetit në vitin 2018 në krahasim me vitet 2017 dhe 2016, kur bëhet fjalë për sekuestrimin e pasurisë së krijuar me vepër penale, ku tha se shuma e ngrirë dhe e sekuestruar është rreth 28 milion euro. Mirëpo, Fazliu tha se përkundër vitit 2017, ku ka pasur një sukses të mirë, pasi ishin konfiskuar rreth 1 milion e 200 mijë euro, në vitin 2018, ai tha se ka një rënie drastike, pasi që shuma e konfiskuar është vetëm rreth 50 mijë euro. Një shumë e tillë e konfiskuar, Fazliu tha se është e papërfillshme kur merret parasysh numri i prokurorëve, hetuesve, inspektorëve dhe gjyqtarëve që janë në Kosovë.

E si rekomandime të raportit, Fazliu tha se një prej tyre është se edhe për KPK por edhe KGJK, do të ishte mirë të bëhet një vlerësim kolektiv, në mënyrë që të rritet llogaridhënia dhe transparenca e këshillave dhe të mos pritët deri në përfundim të mandatit pesë vjeçar të përbërjes së këshillave.

Kritika ndaj këtij raporti kishin dy anëtarët e KPK-së, Arben Ismajli dhe Haxhi Sinani.

Tutje, Fazliu kishte deklaruar se përbërja e vjetër e KPK-së është ndryshuar për shkak se “nuk ka punu mirë”.

Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni kishte thënë gjatë kësaj mbledhje se në memorandumimin për funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, janë paraparë saktë detyrat, e në to, sipas Hysenit, nuk i është dhënë mundësia që të bëjë vlerësimin e një institucioni kolegjal, e aq më larg performacën e këtij institucioni. “Edhe një sqarim, sa i përket përbërjes së këshillit të kaluar, nuk është ndërru për shkak të performancës, po është ndërru për shkak të ndryshimeve ligjore e për të cilat ne nuk kemi asnjë fuqi t’i ndalim”, tha Hyseni.

E në këtë debat, ishte përfshirë edhe Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, i cili kishte thënë se mandati i koordinatorit nuk është vendimmarrës, por mbikëqyrës. Tutje, Lumezi gjatë këtij takimi kishte deklaruar se përbërja e vjetër ka qenë shumë e mirë dhe se askush nuk është larguar për shkak të mos punës. Sipas tij, nuk është e mundur që të bëhet vlerësimi i një organi kolegjal, por vlerësohen anëtarët.

Tensionet në takimin e KPK-së kishin vazhduar deri në momentin kur raporti ishte hedhur në votim pa amandamente, gjatë të cilit votim, Fazliu ishte largua nga takimi, duke iu përgjigjur kryesuesit Hyseni me fjalët “e marr vesh çka vendosni”.

Pas kësaj, me votë unanime, këshilli kishte votuar edhe propozimin e anëtarit Arben Ismajli që të mblidhet bordi që e ka nënshkruar memordandumin për funksionalizim të koordinatorit dhe diskutojë punën e koordinatorit dhe të tregojë se pse për pesë vjet nuk është mbledhur ky bord.

Deri më tani, Fazliu nuk ka dhënë dorëheqje. Në një përgjigje për “Betimi për Drejtësi”, Fazliu kishte thënë se do të raportojë përsëri në KPK³⁹.

Por, që nga 1 marsi 2019, përkatësisht në takimin në të cilin kishte tensione në mes anëtarëve të KPK-së dhe Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu, ky i fundit nuk është paraqitur më në KPK.

Deri më këtë datë, Fazliu kishte raportuar vazhdimisht para anëtarëve të KPK-së, për periudha tremujore, obligim i cili është edhe i sanksionuar me nenin 7.2. të Rregullores për Themelimin dhe Funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtar.

Më 1 mars 2019, Fazliu kishte raportuar para anëtarëve të KPK-së lidhur me tremujorin e katërt të vitit 2018, ndërsa i njëjti nuk ka raportuar fare sa i përket tremujorëve përkatës të vitit 2019.

IKD ka kërkuar edhe përgjigje me shkrim nga KPK se a është ftuar Fazliu nga KPK për të raportuar, dhe për çfarë arsye i njëjti nuk ka raportuar deri tani. Por, në këtë kërkesë për informata, IKD nuk ka marrë përgjigje nga KPK.

Në këtë mënyrë, IKD vlerëson se puna dhe mos puna e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimet Ekonomik duhet të vlerësohet nga mekanizmat e brendshëm të sistemit prokurorial. Nëse ky koordinator, në rastin konkret Prokurori Shqipdon Fazliu, sipas KPK-së nuk ka treguar performancë të duhur, i njëjti të zëvendësohet me një akter tjetër, në mënyrë tensionet e krijuara në mes anëtarëve të KPK-së dhe prokurorit Fazliu, mos të ndikojnë në efikasitetin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimet Ekonomik.

7.8. Procesi i rekrutimit të gjyqtarëve të departamenteve speciale

KGJK me 23 prill 2019 ka shpallur konkurs të brendshëm për avancimin e gjyqtarëve në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Departamentin Special të Gjykatës së Apelit.

KGJK këtë proces e ka përmbyllur më 28 qershor 2019, ku edhe ka emëruar gjyqtarët të cilët do të shërbejnë në këto 2 departamente.

Sipas komunikatës për media të KGJK-së të lëshuar me 28 qershor 2019, KGJK në kuadër të Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë kishte avancuar 6 gjyqtarë:

³⁹“Tension në KPK, Shqipdon Fazliu ofron dorëheqje dhe lëshon mbledhjen, votohet pa rekomandime raporti i tij”. Betimi për Drejtësi. 1 mars 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/tension-ne-kpk-shqipdon-fazliu-ofron-doreheqje-dhe-leshon-mbledhjen-votohet-pa-rekomandime-raporti-i-tij/>). (Qasur së fundi më 2 prill 2019).

1. Valbona Musliu – Selimaj
2. Valon Kurtaj
3. Arben Hoti
4. Albina Shabani – Rama
5. Musa Kongjeli
6. Shadije Gërguri

Ndërsa, në kuadër të Departamentit Special të Gjykatës së Apelit, KGJK kishte avancuar 3 gjyqtarë:

1. Kreshnik Radoniqi
2. Vaton Durguti
3. Burim Ademi

Gjyqtarët e lartë cekur kanë në filluar punën nga 1 korriku 2019.

Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit në nenin 6, paragrafi 1 përcakton se: “KGJK, shpall konkurs të brendshëm për **pozitat e lira për gjyqtar** të cilët do të ushtrojnë funksionin e tyre në kuadër të Departamentit Special”.

Në takimin e mbajtur me 23 prill 2019, KGJK ka nxjerrë vendimin KGJK.nr.87/2019 për shpalljen e konkursit për pozita të lira për gjyqtarë. Neni 1 i këtij vendimi përcakton që “Të shpallet konkurs i brendshëm për pesëmbëdhjetë (15) pozita të lira për gjyqtar, të cilët do të ushtrojnë funksionin e tyre në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit”.

Por, numri i pozitave të lira për gjyqtarë nuk ishte cekur fare në takimin e 23 prillit 2019, të cilin e kishte monitoruar IKD. Gjatë këtij takimi, KGJK vetëm ka shpallur konkurs për gjyqtarë në këtë departament, por nuk ka përcaktuar fare numrin e pozitave të lira për gjyqtarë. Të paktën, kjo nuk është përmendur gjatë këtij takimi të KGJK-së.

Po ashtu, vetë ky vendim kishte përcaktuar numrin total të pozitave të lira për gjyqtarë në Departamentin Special, duke mos specifikuar fare se sa pozita të lira për gjyqtarë janë për Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë e sa për Departamentin Special në kuadër të Gjykatës së Apelit.

Përderisa, KGJK në konkursin e shpallur më 23 prill 2019, kishte shpallur konkurs për 9 pozita të lira për Gjyqtarë të Departamentit Special pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe 3 Gjyqtarë në Departamentin Special pranë Gjykatës së Apelit, që në total i bie 12 gjyqtarë. Pra, përkundër faktit se në vendimin e KGJK-së ishte përcaktuar se konkursi shpallet për 15 pozita të lira, KGJK e kishte shpallur konkursin për vetëm 12 gjyqtarë. Për më tepër, vetë konkursi nuk votohet fare në KGJK, por votohet vendimi për shpalljen e konkursit, ndërsa konkursi i publikuar duhet të jetë në përputhje totale me vendimin e miratuar në takim të KGJK-së.

Se pse KGJK nuk e kishte përcaktuar në vendimin e miratuar numrin e gjyqtarëve të Departamentit Special pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe këtij departamenti pranë Gjykatës së Apelit dhe pse përkundër faktit se vendimi i miratuar përcaktonte 15 pozita të lira ndërsa konkursi ishte shpallur për 12 pozita të lira, KGJK nuk ka dhënë asnjëherë asnjë arsytim.

Ndërsa, përkundër faktit se konkursi ishte shpallur për 9 pozita të lira për Gjyqtarë të Departamentit Special pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, KGJK më 28 qershor 2019 kishte emëruar vetëm 6 gjyqtarë në këtë departament. As këtë fakt KGJK nuk e ka sqaruar asnjëherë.

Lidhur me procesin e rekrutimit të gjyqtarëve të Departamentit Special të GjTh në Prishtinë dhe GjA, KGJK 31 korrik 2019 ka miratuar një raport prej gjithsej katër (4) faqeve, në të cilin raport, dilemat e mësipërme nuk sqarohen, madje të njëjtat konfirmohen⁴⁰.

7.9. “Kërcënimi” i Sindikatës së Judikaturës për futje në grevë

Në raportin e IKD-së lidhur me punën e këtyre dy këshillave gjatë vitit 2018, ishte trajtuar edhe greva e punëtorëve të administratës. Punëtorët e administratës së gjykatave dhe prokurorive në vend, nga 4 deri më 11 korrik 2018 kishin hyrë në grevë të përgjithshme, duke kërkuar realizimin e tri kërkesave, e ato ishin rritja e pagave për 100%, që me Ligjin për Pagat të ketë vlerësime reale dhe të dinjitetshme për punëtorët e gjykatave dhe prokurorive dhe kërkesa e fundit ka qenë rregullimi i statusit së këtyre punëtorëve. Gjatë kohës së grevës, qindra seanca gjyqësore kishin dështuar të mbaheshin si pasojë e këtij veprimi sindikal. Vetëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për çdo ditë kanë dështuar të mbahen mbi 100 seanca gjyqësore, përfshirë edhe ato të korrupsionit. Kurse, dhjetëra seanca për çdo ditë, si pasojë e grevës ishin pamundësuar edhe në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës. Nga greva ishin përjashtuar vetëm rastet e paraburgimeve, të dhunës në familje si dhe rastet të shënjestruara për liberalizimin e vizave.

Ndërsa, më 11 korrik 2018, ishte arritur marrëveshja për ndërprerjen e grevës. Një marrëveshje e tillë është arritur pas një takimi që përfaqësuesit e këshillit grevist kanë pasur me përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial, kryetarët e Gjykatave Themelore si dhe kryeprokurorët e Prokurorive Themelore, ku ka marr pjesë edhe ish-ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri.

Por, disa ditë më vonë, është bërë e ditur se punëtorët e administratës së gjykatave dhe prokurorive nga kërkesë për rritje page 100%, janë mjaftuar me një shtesë në shumë prej 50 eurove.

Sindikata e Judikaturës së Punonjësve Administrativ të Gjykatave dhe Prokurorive me 12 qershor 2019 me anë të një shkresë drejtuar Ministrin të Drejtësisë, Zyrës së Kryeministrit dhe

⁴⁰ KGJK. Vendimi nr.177/2019. 31 korrik 2019. (Shih linkun https://ëëë.gjyqesori-rks.org/ëp-content/uploads/decisions/64412_KGJK-Vendimi_Nr_177_2019_per_miratim_te_Raportit_per_Dep_Special.pdf). (Qasar për herë të fundit më 19 shkurt 2020).

përfaqësuesve të KGJK-së dhe KPK-së, kishte njoftuar se kjo sindikatë do të futet në grevë nga 1 korriku i këtij viti. Kjo sindikatë kishte gjithsej 6 kërkesa me të cilat planifikonte të futej në grevë: përfshirja e administratës së gjykatave dhe prokurorive si nëpunës civil me status të veçantë, punonjësit e kësaj administrate të kenë dallim prej 25% në pagë ndaj nëpunësve të kategorive të tjera, të shpallen koeficientët për secilën kategori të të punësuarve në këtë administratë, tu rikthehet statusi i shërbyesve civil punëtorëve të cilëve u është marrë ky status, të vazhdoj zbatimi i vendimit të Kryeministrit për pagesë shtesë si dhe të bëhet pagesa retroaktive e shtesave nga janari i vitit 2017 deri në gusht 2018.

Por, në një takim që kjo sindikatë kishte mbajtur me Ministrin e Drejtësisë dhe përfaqësuesit të KGJK-së dhe KPK-së, e njëjta ishte pajtuar që të shtyjë grevën deri më 1 tetor 2019. Sipas komunikatës së KGJK-së, palët u pajtuan që: të punohet së bashku me përfaqësuesit e Sindikatës për hartimin e dokumentit për sistematizim e vendeve të punës sipas Ligjit të ri për pagat, të përfundojë procesi i rikthimit të stafit administrativ-teknik në shërbyes civilë, si dhe të bëhen përpjekje për realizimin e pagesës së shtesës prej 50 eurosh nga 1 janari 2019, siç është bërë deri më tani.

“Pas arritjes së pajtueshmërisë për këto pika, përfaqësuesit e Sindikatës së Judikaturës së Kosovës konfirmuan se greva e paralajmëruar për të hënë më 1 korrik 2019 do të mbetet e pezulluar deri më 1 tetor 2019” thuhej në këtë komunikatë.

7.10. Kërcënimi me bombë në KGJK

Një telefonate kërcënuese që pretendohet ta ketë marr roja i sigurimit në KGJK, dhe dyshimet për vendosjen e një mjete shpërthyes, kishte bërë që anëtarët dhe stafi ta braktisin objektin gjatë kohës kur KGJK po zhvillonte takimin e 24 majit të vitit 2019.

Nga objekti ishin larguar edhe personeli i Prokurorisë Speciale të Kosovës, që ndodhet në rrugën “Luan Haradinaj”, në Prishtinë, pak metra larg objektit të KGJK-së si dhe stacionit policor të Kosovës. Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së, Shkelzen Maliqi, u ka thënë anëtarëve të këshillit dhe stafit tjetër që të dalin jashtë, pas dyshimeve të tilla. Krejt kjo, siç u ka thënë ai anëtarëve të KGJK-së, se roja i sigurimit ka marr një telefonatë kërcënuese se “juve dhe Gjykatën Speciale kanë me ju bo rrafsh me tokë”. Pas këtij lajmi, të gjitha njësitet relevante policore ishin dal në vendin e ngjarjes, me ç’rast për disa orë edhe është bllokuar rruga “Luan Haradinaj”. Ndërsa, Policia ka njoftuar se po punohet intensivisht për ta identifikuar personin që dyshohet se ka kërcënuar me bombë. Përpos stafit të KGJK-së, Policia e Kosovës ka evakuuar edhe objektin e PSRK-së.

Në fund të ditës, përmes një komunikate për media Policia e Kosovës, ka thënë se pas marrjes së informatës, të gjitha njësitet kanë dal në vendin e ngjarjes, por që në fund ka rezultuar se nuk është gjetur asgjë e dyshimtë.

Deri më tani, asnjë institucion nuk ka informuar nëse është arritur zbardhja e këtij rasti nga institucionet e sigurisë dhe drejtësisë.

7.11. Ndërprerja e procesit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të PSRK-së

Më 4 prill 2019 ishte pensionuar Kryeprokurori i PSRK-së, Reshat Millaku, derisa me 15 qershor të vitit 2019 ishte pensionuar Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Imer Beka. Për këtë arsye, KPK kishte planifikuar zgjedhjen e 2 kryeprokurorëve të rinjë, përkatësisht Kryeprokurorit të PSRK-së dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Për këtë arsye, KPK kishte ndryshuar Rregulloren për Emërimin e Kryeprokurorëve. Kjo rregullore ishte ndryshuar më 21 shkurt 2019, përkatësisht 8 ditë para se KPK të shpallte konkursin për Kryeprokurorë të PSRK-së. Në ditën kur ishte shpallur ky konkurs, 1 mars 2019, pasi që pretendonte këtë pozitë, nga pozita e anëtarit të KPK-së ka dhënë dorëheqje ish-kryesuesi i këtij këshilli, Blerim Isufaj.

Konkursi për Kryeprokuror të ri të PSRK-së është hapur nga KPK-ja, më 1 mars 2019 dhe është mbyllur më 15 mars 2019.

Po ashtu, më 1 mars 2019, KPK-ja kishte themeluar Komisionin për Vlerësimin e Kandidatëve për kryeprokuror të PSRK-së, i përbërë nga kryesuesi Besim Kelmendi dhe anëtarët Drita Hajdari dhe Xhevdet Bislimi. Më pas, prokurorja speciale Drita Hajdari kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Në një përgjigje me shkrim nga KPK-ja, për “Betimi për Drejtësi”, thuhej se dorëheqja e Hajdarit është bërë për arsye personale. Në këtë përgjigje thuhej se anëtarja e komisionit, Drita Hajdari, është zëvendësuar nga anëtari rezervë i këtij komisioni, Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, Haxhi Dërguti. Edhe vetë Haxhi Dërguti njëherë kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë, por më pas kishte deklaruar se e kishte revokuar dorëheqjen e tij.

Në garë për pozitën e kryeprokurorit të PSRK-së ishin katër (4) kandidatë: Haki Gecaj, ish-kryesuesi i KPK-së, Blerim Isufaj, Atdhe Demaj dhe Armend Hamiti.

Komisioni për Vlerësimin e Kandidatëve për Kryeprokuror të ri të PSRK-së kishte rekomanduar ish-kryesuesin e KPK-së, Blerim Isufaj të cilin e kishin vlerësuar me 40.1 pikë, kurse Haki Gecaj, ishte vlerësuar me 42.9 pikë. Kurse, dy kandidatët që nuk kishin kaluar në fazën finale, Atdhe Demaj, ishte vlerësuar me 31.8 pikë, ndërsa Armend Hamiti ishte poentuar me 29.2.

Në takimin e 10 prillit kur edhe ishte pritur që të mbahet procesi i votimit për Kryeprokurorë të PSRK-së, votimi ishte shtyrë nga KPK, pasi kjo e fundit kishte aprovuar kundërshtimet e kundër kandidatëve Atdhe Demaj dhe Armend Hamiti.

Në takimin e 25 prillit 2019 përsëri si pikë e rendit të ditës ishte votimi për kryeprokurorë të PSRK-së. Gjatë këtij takimi, KPK ka anuluar tërësisht këtë konkurs, me arsyetimin se duhet të miratohet një rregullore e re për emërimin e Kryeprokurorëve, e cila duhet të jetë në përputhje me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese në rastin e zgjedhjen së Kryetarëve të Gjykatave nga KGJK. Arsyetimi i anulimit të konkursit ishte mos krijimi i pasigurisë juridike me ndryshimin e rregullores në mes të procesit. Me anulimin e konkursit, KPK kishte

autorizuar Komisionin për Çështje Normative për hartimin e një rregulloreje të re për emërimin e kryeprokurorëve. Sipas KPK-së, deri në miratimin e rregullores së re nuk do zhvillohet as procesi për zgjedhjen e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Lidhur me zgjedhjen e Kryeprokurorëve, IKD me 12 maj 2019 kishte publikuar analizën e politikave “Lufta” për Kryeprokurorët”.

Në këtë analizë IKD kishte konkluduar se për shkak të vështirësive të KPK-së në kryerjen e procesit të pavarur, të drejtë dhe transparent të zgjedhjes së pozitive të larta, sidomos zgjedhjes dhe propozimit për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe zgjedhjes dhe emërimit të Kryeprokurorëve, IKD vlerëson se KPK duhet të marrë parasysh hartimin e një rregulloreje të re të zbatueshme për procedurën e zgjedhjes dhe emërimit për të gjitha pozitat e larta në sistemin e prokurorial, duke përfshirë pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, Kryeprokurorit të PSRK-së, Kryeprokurorit të Apelit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorisë Themelore.

Sipas IKD-së, KPK duhet të shmang praktikën e tanishme të miratimit të dy rregulloreve të ndryshme, një për Kryeprokurorin e Shtetit dhe e dyta për Kryeprokurorët e tjerë dhe përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të ndryshme për procesin zgjedhor të pozitive të mësipërme si dhe në vend të kësaj, KPK duhet të fokusohet në hartimin dhe miratimin e rregullores së re për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve në të cilin do të përcaktojë qartë procedurën për përzgjedhjen dhe emërimin, duke përfshirë sigurimin e rregullave dhe kriterëve të qarta, transparente dhe objektive. Për të munduruar që sistemi prokurorial të arrijë objektivat e tij dhe të kryejë funksionet e tij, është thelbësore që Kryeprokurorët në të gjitha nivelet të zgjedhën në bazë të kompetencave të dëshmuara, integritetit dhe pavarësisë, si dhe në përputhje me procedurat e paanshme, duke përjashtuar çdo diskriminim dhe duke lejuar mundësinë e rishikimit të paanshëm.

“Pavarësia dhe integriteti i prokurorëve të shtetit janë me interes legjitim për publikun e gjerë. Ata duhet të mbrohen nga sulmet që ka gjasa t’i pengojnë që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të pavarur ose që dëmtojnë besimin e publikut tek ata dhe institucioni që përfaqësojnë. Vendimi për emërimin e udhëheqësit të shërbimit prokurorial është me interes të veçantë dhe mund të jetë edhe më i ndjeshëm se sa në rastin e gjyqtarëve. Sa i përket emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorit të PSRK-së, nuk është e mjaftueshme që një kandidat për një zyrë të tillë të lartë t’i nënshtrohet kërkesave të përgjithshme të kualifikimit që ekzistojnë për çdo pozicion tjetër prokurorial. Kompetencat e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorit të PSRK-së kërkojnë kompetenca dhe përvojë të posaçme. Në këtë drejtim, KPK gjatë miratimit të rregullores duhet të marrë në konsideratë këto, përderisa i harton kriteret e kualifikimit dhe eksperiencës. Me qëllim që procesi i emërimit të jetë më transparent dhe i hapur, bazuar në Komisionin e Venecias, OSBE/ODIHR dhe ÇPE/DGI rekomandohet që të propozohet jo vetëm një, por disa kandidatë për postin e Kryeprokurorit dhe pastaj KPK të zgjedhë një prej tyre. Në këtë drejtim, KPK duhet të marrë në konsideratë ata kandidatë që kanë përafërsisht të njëjtin rezultat, që të kenë mundësinë të jenë pjesë e procesit të votimit nga ana e KPK-s” thuhej ndër të tjera në këtë analizë të IKD-së.

Lidhur me miratimin e rregullore së re për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, në dëgjimin publik të organizuar nga KPK më 18 korrik 2019, IKD kishte paraqitur komentet e saj⁴¹, derisa kjo rregullore ishte miratuar nga KPK më 1 gusht 2019, në të cilën ditë edhe ishte shpallur konkursi për Kryeprokurorë të PSRK-së dhe PTh në Prishtinë.

Ky proces kishte përfunduar me 23 dhjetor 2019. Në takimin e mbajtur me këtë datë, KPK kishte zgjedhur ish-kryesuesin e KPK-së, Blerim Isufaj, për Kryeprokuror të PSRK-së, derisa Kujtim Munishi është zgjedhur kryeprokuror i PTh në Prishtinë.

Ndaj këtyre vendimeve në të njëjtën ditë kishte reaguar edhe IKD.

“IKD ka monitoruar me kujdes procesin e emërimit të Kryeprokurorëve në këto dy prokurori dhe bazuar në gjetjet e monitorimit, vlerëson se ky proces nuk i plotëson standardet e kërkuara për të siguruar një proces të emërimit të bazuar sipas meritokracisë, publicitetit, respektimit të procedurës së pavarur të ankesave që ndikon në mungesën e besimit të publikut për një proces të drejtë, pavarur dhe të paanshëm” thuhej ndër të tjera në reagimin e IKD-së⁴².

Po ashtu, lidhur me këtë proces, Ambasada Amerikane ka deklaruar se nuk e mbështetë dështimin e KPK-së për të zbatuar Rregulloren për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të PSRK-së dhe PTh në Prishtinë.

Në përgjigjen për “Betimi për Drejtësi”, Zyra për Informim e Ambasadës Amerikane, thekson se mungesa e mbështetjes për dështimet e KPK-së në zbatimin e Rregullore për zgjedhjen e Kryeprokurorëve, nuk ka të bëjë me asnjë kandidat individualisht. “Ne iu dëshirojmë Kryeprokurorëve sukses dhe mungesa e mbështetjes sonë për procesin e përzgjedhjes nuk reflekton opinionin tonë individual për personat e zgjedhur”⁴³.

7.12. KPK në mënyrë të kundërligjshme shpërblen me pozitën e UD Kryeprokurorit të Prishtinës prokurorin Kujtim Munishi

Në takimin e 7 qershor 2019, për shkak të shtyrjes së procesit për emërimin e Kryeprokurorit të ri të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, KPK kishte caktuar Prokurorin Kujtim Munishi u.d. të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

⁴¹ "Komentet e IKD-së në Draft – Rregulloren për Emërimin e Kryeprokurorëve të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës". IKD. 18 korrik 2019. (<https://kli-ks.org/komentet-e-ikd-se-ne-draft-rregulloren-per-emerimin-e-kryeprokurore-ve-te-shtetit-dhe-kryeprokurore-ve-te-prokurorive-te-republikes-se-kosoves/>). (qasur së fundi më 29 korrik 2019).

⁴² "IKD reagon lidhur me integritetin e kontestuar të procesit të emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë". IKD. 23 dhjetor 2019. (<https://kli-ks.org/ikd-reagon-lidhur-me-integritetin-e-kontestuar-te-procesit-te-emerimit-te-kryeprokurorit-te-prokurorise-speciale-dhe-kryeprokurorit-te-prokurorise-themelore-ne-prishtine/>). (Qasur për herë të fundit më 19 shkurt 2020).

⁴³ "Ambasada Amerikane nuk e mbështet dështimin e KPK-së për të zbatuar Rregulloren për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të PSRK dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë". "Betimi për Drejtësi". 27 dhjetor 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/ambasada-amerikane-nuk-e-mbeshtet-deshtimin-e-kpk-se-per-te-zbatuar-rregulloren-per-perzgjedhjen-e-kryeprokurorit-te-psrk-dhe-prokurorise-themelore-ne-prishtine/>). (Qasur për herë të fundit më 19 shkurt 2020).

Lidhur me këtë vendim, IKD kishte reaguar me 17 qershor 2019.

Sipas IKD-së, KPK mënyrë të kundërligjshme e ka caktuar Prokurorin Kujtim Munishi në pozitën e U.D. të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Përderisa ligjet bazike që rregullojnë sistemin prokurorial të Kosovës, si Ligji për Këshillin Prokurorial dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit, nuk kanë dispozita që rregullojnë caktimin e U.D. së Kryeprokurorëve të prokurorive përkatëse, KPK përmes Rregullores nr.8/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve, në nenin 14, ka përcaktuar në mënyrë taksative se në rast të mungesës së Kryeprokurorit të Prokurorisë përkatëse, i njëjti zëvendësohet nga zëvendësi i tij, i caktuar nga vet ai.

Ish-Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, z. Imer Beka kishte caktuar si Zëvendës të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurorin Ibrahim Berisha. Kryeprokurorit Beka i ka përfunduar mandati si Kryeprokuror i PTh në Prishtinë, dhe sipas Rregullores së miratuar nga vet Këshilli Prokurorial i Kosovës, me automatizëm, prokurori Berisha merr përgjegjësitë dhe kompetencat e U.D. së Kryeprokurorit të PTh në Prishtinë.

Për më tepër, në nenin 14 pika 2 të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorëve të miratuar nga vet KPK dhe që është në fuqi, përcaktohet se në rast të pushimit të mandatit të Kryeprokurorit, zëvendës-kryeprokurori e ushtron pozitën e Kryeprokurorit por jo më gjatë se tre muaj. Mbi këtë bazë vendimin për caktimin e U.D. e merr Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Ky obligim ligjor është shkelur nga KPK, e cila ka anashkaluar zëvendës kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ka propozuar dhe caktuar për ushtrues detyre të kryeprokurorit, prokurorin Kujtim Munishi.

IKD vlerëson se kjo logjikë e veprimit nga KPK, duke shkelur politikat e saj që rregullojnë administrimin dhe menaxhimin e sistemit prokurorial, të cilat vetë i ka miratuar, dëshmon se qëllimi i emërimit të prokurorëve të caktuar në këto pozita është që të njëjtit të jenë në rolin e argatit ndaj grupeve të caktuara të interesit. Për IKD-në është e papranueshme logjika e veprimit në këtë mënyrë të kundërligjshme, sidomos në rastet si ky, kur tendenca e drejtuesve të KPK-së shkon në drejtim të shpërblimit të kundërligjshëm me pozita dhe ngritje të shpejtë në karrierë të prokurorit Kujtim Munishi, për të cilin IKD dhe mediat e pavarura kanë raportuar për shërbimin që ai ka bërë për Kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezi, të cilit ia ka mbyllur në mënyrë të kundërligjshme hetimin për dosjen e manipuluar të provimit të jurisprudencës. Për më tepër, IKD e konsideron të papranueshme qasjen dhe politikën e ndjekur nga KPK që në pozita udhëheqëse të caktoj persona me integritet të cenuar dhe ndaj të cilëve publiku ka mungesë të besimit në pavarësinë dhe paanshmërinë e tij në ushtrimin e funksioneve prokuroriale.

IKD dhe publiku nuk e ka të qartë arsyen e shkeljes së dispozitave të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorëve dhe emërimin e kundërligjshëm të prokurorit Kujtim Munishi.

Nuk është dhënë asnjë arsye për mos emërimin e zëvendës kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në pozitën e ushtruesit të detyrës së kryeprokurorit, ashtu siç përcaktohet në Rregullore, në nenin 14, paragrafi 2.

Përpos kësaj, zëvendës Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Ibrahim Berisha, kishte paditur KPK-në lidhur me këtë vendim, ku po ashtu ka kërkuar edhe masë të përkohshme, përmes së cilës ka kërkuar që urgjentisht të anulohet vendimi i kundërligjshëm.

Sipas padisë së ushtruar më 26 qershor 2019, e të cilën e ka siguruar “Betimi për Drejtësi”, Ibrahim Berisha, Zëvendës-Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore të Prishtinës ka kërkuar anulimin e vendimit Nr.KPK/Nr.377/2019 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, të datës 7 qershor 2019, për emërimin e UD të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si dhe emërimin e tij në po këtë pozitë, apo kthimin e çështjes në rivendosje.

Kjo pasi që siç thuhet në padi, KPK në takimin e 168 – të në mënyrë të kundërligjshme dhe pa përfshi në rendin e ditës, e ka emëruar si UD të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurorin Kujtim Munishi.

Për më tepër, Berisha ka kërkuar edhe caktimin e masës së përkohshme të sigurimit me ndalimin e ekzekutimit të vendimit të KPK-së, së 7 qershorit, për emërimin e UD të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, pasi që, sipas tij, ky vendim do të shkaktojë pasoja me pasiguri në zbatimin e ligjshmërisë nga KPK.

Zëvendës-Kryeprokurori Berisha, ndër të tjera, në padi ka thënë se vendimet e tilla të paligjshme po ndikojnë në moszbatimin e ligjshmërisë në sistemin prokurorial të Kosovës–humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin prokurorial dhe reagimin e mediave dhe shoqërisë civile dhe organizatave tjera monitoruese në mjetet e informimit publik.

Përpos kësaj padie, Berisha kishte bërë ankesë edhe në KPK, të cilën KPK e kishte trajtuar në takimin e mbajtur me 3 korrik 2019. KPK gjatë këtij takimi, e ka refuzuar ankesën e zëvendës-Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe ka lënë në fuqi vendimi sipas të cilit u.d. i Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë caktohet Prokurori Kujtim Munishi.

7.13. Dështimi në praktikë i Rregullores së KPK-së për Shërbimin e Komunikimit

Me miratimin e Rregullores për Shërbimin e Komunikimit në Sistemin Prokurorial nga ana e KPK-së më 10 prill 2019.

Me anë të kësaj rregulloreje, KPK ka centralizuar informacionin tek Kryeprokurori i Shtetit.

Ligjshmëria e kësaj rregulloreje është analizuar tashmë në këtë raport tek pjesa e legjislacionit sekondar të KPK-së.

Për këtë rregullore, akterë brenda sistemit prokurorial vazhdimisht kanë insistuar se informacioni kalon në ZKSH vetëm sa i përket rasteve të veçanta të pa përkufizuara në rregullore dhe se me anë të kësaj rregulloreje synohet ngritja e mëtutjeshme e transparencës brenda sistemit prokurorial.

Por, për të vlerësuar afërsinë e sistemit prokurorial me publikun pas miratimit të kësaj rregulloreje, IKD ka monitoruar zbatimin në praktikë të së njëjtës, që nga 10 prilli 2019, kur edhe është miratuar kjo rregullore.

IKD gjen se pas miratimit të kësaj rregulloreje, respektivisht pas centralizimit të informacionit në ZKSH, ka një regres rapid të transparencës në sistemin prokurorial.

Kjo rregullore përcakton se ZKSH në bashkëpunim me të gjitha prokuroritë përpilon raportin 24 orësh të Prokurorit të Shtetit, të cilin ua dërgon mediave. Ky obligim formalisht është përmbushur pothuajse në çdo rast, përveç vikendeve, ku raportin 24 orësh të Prokurorit të Shtetit për të shtunën dhe të dielën, ZKSH ua ka përcjellur mediave të hënën.

Sa i përket përmbajtjes së këtij raporti, nga i njëjti nuk mund të kuptohet drejt veprimtaria e përditshme e Prokurorit të Shtetit, aq më tepër të dhënat për rastet specifike të cilat janë të rëndësishme për publikun, mediat dhe shoqërinë civile. Pjesa më e madhe e këtij raporti janë të dhëna “blanko” mbi numrin e aktakuza të ngritura, ndalimeve dhe kërkesave për caktimin e masave të sigurisë. Pra, kemi të bëjmë me një raport ku pjesa më e madhe e tij është statistikë.

Përtej këtij raporti, Prokurori i Shtetit pothuajse nuk ka ndërmarrë mundin asnjëherë për t’iu dhënë përgjigje kërkesave të tjera për informata, për çështje me rëndësi për publikun, mediat dhe shoqërinë civile, që nuk janë pjesë e raportit 24 orësh të Prokurorit të Shtetit.

Nëse krahasojmë të dhënat nga raportet e kaluara të IKD mbi punën e sistemit prokurorial, shihet se pas centralizimit të informacionit prokurorial në ZKSH, transparenca shkon drejt një regresi rapid.

Gjatë vitit 2018, IKD kishte adresuar gjithsej 108 kërkesa për qasje në dokumentet publike dhe informata në sistemin prokurorial. Prej këtyre 108 kërkesave, IKD ma marrë përgjigje pozitive në 42 prej tyre, apo 37.86 %, në 55 prej tyre, apo 51.45%, IKD nuk ka marrë fare përgjigje, kurse në 11 kërkesa institucionet prokuroriale kanë refuzuar të japin të dhënat e kërkuara, apo në 10.67%.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, IKD kishte adresuar në sistemin prokurorial gjithsej 26 kërkesa për qasje në dokumentet publike dhe informata. Prej këtyre 26 kërkesave, IKD ka marrë 15 përgjigje pozitive apo në 57.69%, 6 kanë qenë përgjigje negative apo 23.07%, ndërsa në 5 kërkesa IKD nuk ka pranuar fare përgjigje, apo në 19.23%.

Ndërsa, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019, IKD ka adresuar në sistemin prokurorial gjithsej 127 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe informata. Prej këtyre 127 kërkesave, 116 i janë drejtuar të gjitha prokurorive, nga të cilat IKD ka marrë vetëm 16 përgjigje pozitive apo

13.73% të kërkesave, në 6 kërkesa apo 5.17% të kërkesave prokuroritë kanë refuzuar që të japin përgjigje ndërsa në gjithsej 94 kërkesa apo në 81.03% të kërkesave të parashtuara IKD nuk ka marrë fare përgjigje nga prokuroritë.

Pra, gjatë vitit 2018, përqindja e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe informata në të cilat IKD nuk kishte marrë përgjigje kishte qenë 51.45%, derisa kjo përqindje kishte rënë gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 në 19.23%, i cili fakt në raportin e kaluar të IKD-së është evidentuar si progres.

Por, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019, pra pas centralizimit të informacionit në ZKSH, kjo përqindje është ngritur në 81.03%. Kjo e dhënë flet për atë se sistemi prokurorial tanimë është pothuajse hermetikisht i mbyllur dhe plotësisht jo transparent, përpos rasteve përjashtuese.

Përkundër mungesës së vullnetit të sistemit prokurorial për të qenë transparent me publikun, mediat dhe shoqërinë civile, mënyra se si është ndërtuar rregullorja krijon edhe vështirësi teknike në plasimin e informacioneve. Por, fajtori në këtë rast është rregullorja e kundërligjshme e KPK-së, dhe jo publiku, mediat dhe shoqëria civile. Madje, ky fakt ishte përmendur nga IKD edhe në komentet që IKD kishte dërguar në KPK përkitazi me Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit në Sistemin Prokurorial, por që nuk ishin marrë parasysh nga KPK.

“Në anën tjetër, përparësi e kësaj rregullore është neni 16.1.1.3 që përcakton se “Të gjithë përfaqësuesit e mediave, pa dallim, trajtohen njëjtë, me mirësjellje profesionale duke marrë në konsideratë **afatet dhe kufizimet e atyre.**”

Duke pasur parasysh natyrën e afateve dhe kufizimeve të mediave, përcaktimi që çdo informacion të kalojë përmes një personi, që në këtë rast është Kryeprokurori i Shtetit, është apriori i pazbatueshëm. Bazuar në vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*të obligueshme sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*) lajmi i mediave është “mall që shpejt humb vlerën”. Në anën tjetër, është në interes të publikut që për një rast të caktuar të informohet në kohë sa më të shpejtë. Ndjekja e procedurës që secilin informacion para se të plasohet në publik ta kontrollojë Kryeprokurori i Shtetit është procedurë, e cila pamundëson zbatimin në praktikë të nenit 16.1.1.3 të rregullores. Për më tepër, kjo pamundësi është vërtetuar edhe nga monitorimi që IKD i ka bërë zbatimit në praktikë të kësaj rregulloreje, cila do të trajtohet tek gjetjet e veçanta” thuhej në komentet e IKD-së drejtuar KPK-së gjatë fazës së draftimit të kësaj rregulloreje.

Për këto arsye, IKD vlerëson se përkundër kundërligjshmërisë së centralizimit të informacionit prokurorial tek Kryeprokurori i Shtetit, e cila tanimë është trajtuar në këtë raport tek pjesa e legjislacionit sekondar të KPK-së, edhe të dhënat nga monitorimi praktik tregojnë se kjo rregullore është sinonim i mos transparencës.

Andaj, IKD vlerëson se nëse KPK është me të vërtetë e përkushtuar që të ngrit transparencën në punën e saj, hapi i parë është që të reflektojë përballë këtyre të gjeturave, dhe të

decentralizoj informacionin prokurorial, ashtu siç edhe përcaktohet me ligjet bazike. Në të kundërtën, sistemi prokurorial do të shndërrohet në një sistem hermetikisht të mbyllur, për të cilin gjëja e parë që do të bie ndërmend kur ta përmendësh do të jetë mos transparenca.

7.14. Kryetari i Gjykatës së Apelit kërkon shkarkimin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve

Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës më 18 shtator 2019 kishte mbajtur takim, ku si pikë e rendit të ditës ka qenë edhe diskutimi lidhur me procesin e Rishikimit FunkSIONAL të Sektorit të Sundimit të Ligjit.

Në diskutimin lidhur me këtë pikë, është diskutuar edhe mbi punën e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve.

Në këtë diskutim, Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, kishte kërkuar shkarkimin e këtij komisioni, pasi sipas tij, ky komision është subjektiv, duke shtuar se nëse gjyqësori nuk i përforcon këta mekanizma, procesi i vetingut është i pashmangshëm.

“Ne kemi një Komision për Vlerësim të Performancës së Gjyqtarëve, me të cilin unë nuk pajtohem fare. Ky ka qenë një komision subjektiv, për të cilin unë kërkoj që të shkarkohet. Ka anëtar me integritet më të ulët të cilët vlerësojnë gjyqtarët e tjerë me integritet të lartë. Me duhet me i përforcu këto komisione, në të kundërtën, vetingu është i pashmangshëm” kishte thënë Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala.

Lidhur me këtë komision, Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, kishte kërkuar edhe ndryshimin e rregullores për vlerësim të performancës, në mënyrë që sipas Pecit, gjyqtarët të jenë në një veting të vazhdueshëm.

Në anën tjetër, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi, kishte kërkuar që qëndrimet e Kryetarëve të Gjykatave ti marrë parasysht Komisioni për Vlerësimin e Performancës.

“Duhet të merren parasysht edhe qëndrimet e kryetarëve të gjykatave për gjyqtarët. Unë vet kom pas rast kur kam adresu sjelljen e një gjyqtari, ndërsa jam ndier keq kur në kolegjiun më ka thënë “çka pate mem bo”, dhe jam ndier shumë keq në këtë situatë” kishte thënë Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi.

7.15. Rritet numri i të arrestuarve në mënyrë të kundërligjshme si dhe shumat që u kompensohen këtyre personave

Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës më 18 shtator 2019 kishte mbajtur takim, ku si pikë e rendit të ditës ka qenë edhe diskutimi lidhur kompensimin e personave të dënuar apo arrestuar pa arsye.

Gjatë këtij takimi, Kryetari i kësaj Asambleje, Gjyqtari Bashkim Hyseni, ka thënë se ka një dinamike të rritjes së vazhdueshme të numrit të personave që KGJK kompenson vit pas viti

për shkak të mbajtjes në paraburgim të personave që më pas rezulton të jenë të pafajshëm. Sipas Hysenit, përderisa në vitin 2004 kishte vetëm 14 persona me rreth 31.000 euro kompensim tani kemi 185 persona me rreth 366.000 euro kompensim. Hyseni ka kërkuar nga gjyqtarët që në këto raste të jenë më të vëmendshëm dhe në secilin rast të bëjnë një vlerësim më serioz dhe të gjithanshëm.

Lidhur me këtë çështje, Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, ka thënë se nuk di se cili është mekanizmi se si të veprohet në këtë situatë, por i njëjti ka shprehur apel të përgjithshëm që gjyqtarët të kenë kujdes në raste të tilla.

Tutje, Kryesuesi i KGJK-së, Skënder Çoçaj kishte thënë se gjyqtarët duhet të përdorin sa më shumë masat e tjera alternative të sigurisë së pranisë së personit në procedurë penale, derisa ka kërkuar nga Kryetarët e Gjykatave që për këtë çështje të bisedohet edhe nëpër kolegji.

Mos syçeltësi të gjyqtarëve e kishte cilësuar këtë dukuri Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, i cili ka kritikuar qasjen kur pas muajit të parë, paraburgimi vazhdohet edhe për 2 muaj të tjerë pa asnjë provë.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi, kishte thënë se në këtë numër ka ndikuar edhe rritja e numrit të gjyqtarëve, por që sipas saj, gjyqtarët duhet të kenë guxim profesional kur të vendosin për këto raste.

Ndryshe, dukurinë e rritjes së vazhdueshme të numrit të personave të mbajtur në paraburgim apo vuajtje të dënimit në mënyrë të kundërligjshme e kishte trajtuar emisioni “Betimi për Drejtësi”, pas së cilit kanë ardhur edhe këto reagime.

Më 16 mars të këtij viti, emisioni “Betimi për Drejtësi” kishte shfaqur hulumtimin “Humbja e milionave nga “gabimet” e drejtësisë”⁴⁴.

Në këtë emision, gjykatësi Muhamet Rexha kishte thënë se ai do ta inicioonte ngritjen e një çështjeje të tillë në KGJK.

Rexha këtë çështje e ka ngritur në takimin e KGJK-së të mbajtur me 5 prill 2019, ku ndër të tjera ka kërkuar që kjo çështje të diskutohet edhe në Asamblenë e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

Lidhur me këtë situatë, IKD vlerëson se përkundër humbjeve të mëdha buxhetore që këto raste i shkaktojnë buxhetit të Republikës së Kosovës, kjo pasojë mbetet minimale përballë cenimit të sigurisë juridike të qytetarëve të Republikës së Kosovës nga sistemi gjyqësor.

Në këtë drejtim, para se të trajtojnë dispozitat e KPPRK-së, gjyqtarët duhet të kenë parasysh se në këto raste rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet garancive kushtetuese mbi të drejtat e njeriut.

⁴⁴ "Humbja e milionave nga “gabimet” e drejtësisë". Betimi për Drejtësi. 16 mars 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/humbja-e-milionave-nga-gabimet-e-drejtesise/>). (Qasur së fundi më 29 nëntor 2019).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se “Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim....2) **për dyshim të bazuar** për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme **konsiderohet i domosdoshëm** për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm **për një periudhë të shkurtër kohore** para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

Në këtë drejtim, nisur nga kjo dispozitë kushtetuese, gjyqtarët duhet të kenë një kujdes maksimal. Duhet rikujtuar se në drejtësinë penale të Republikës së Kosovës, barra e provës është detyrë ekskluzive e prokurorit, derisa palët janë të barabarta. Në këtë rast, nëse një kërkesë për caktimin e paraburgimit nuk është e mbështetur në prova, gjyqtarët duhet ta refuzojnë të njëjtën, pavarësisht se për çfarë vepre penale bëhet fjalë në dispozitivin e aktakuzës.

Po ashtu, gjyqtarët duhet të kenë parasysh se përballë kompetencave jashtëzakonisht të mëdha që Prokurori i Shtetit ka në drejtësinë penale të Republikës së Kosovës, janë vetëm kompetencat e gjyqtarit të procedurës paraprake të cilat e mbrojnë qytetarin nga fuqitë e mëdha të prokurorit. Nëse në këtë rast dështon edhe sistemi gjyqësor, përkatësisht gjyqtari i Procedurës Paraprake, atëherë përfundimisht mund të themi se deri në ngritjen e aktakuzës, në asnjë rast nuk bëhet fjalë për barabarësi të armëve në mes të palëve në një procedurë penale.

7.16. Dy gjyqtarë nën pranga si të dyshuar për korrupsion

Me urdhër të PSRK-së, më 19 shtator 2019, Policia e Kosovës e kishte arrestuar gjyqtarin e Gjykatës Themelore në Pejë, Sali Berisha, i cili në këtë Gjykatë ka qenë i angazhuar si gjyqtarë në Departamentin për Krime të Rënda.

Lidhur me arrestimin e gjyqtarit Berisha, kishte njoftuar edhe Policia e Kosovës.

“Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (NjRHKEK), gjegjësisht Njësi Rajonal për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prishtinë, ka pranuar informacione nga viktima, që ka pasqyruar abuzimin e funksioneve gjyqësore, veprime që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si dhe imazhin e sistemit gjyqësor. Gjatë procesit të hetimit preliminar janë ndërmarrë masat adekuate për të identifikuar formën e aplikuar më parë të korrupsionit nga i inkriminuari. Gjatë aplikimit të masave hetimore kemi siguruar dyshimin e bazuar se i inkriminuari ka kërkuar realizimin e ofertës, në atë mënyrë që i njëjti kërkon/pranon përfitimin material, (kohë më parë dyshohet se janë dorëzuar nga viktima dhe janë pranuar nga i dyshuari i lartshënuar katër mijë (4.000.00) euro), në mënyrë të drejtpërdrejtë, në mënyrë që mos të veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, në cilësinë e gjyqtarit. Pas arrestimit i dyshuari është kontrolluar në prezencën e avokatit mbrojtës, në zyrën e NJRHKEK-së Pejë, me ç’rast i janë gjetur në xhep paratë dymijë (2.000.00) euro, të cilat janë përdorur për aplikimin e masës së fshehtë ‘simulim i veprës së korrupsionit’. Me aprovim verbal të prokurorit, është kontrolluar banesa e të dyshuarit, ku janë gjetur dhe janë sekuestruar: një armë zjarri, tipi Zaza-min, kalibër: 8mm, një karikator dhe dhjetë (10)

fishekë të kalibrit 8mm, dhjetë mijë euro (10.000.00) euro, shkresa, aktgjykime dhe proces verbale gjyqësore. Me urdhër të prokurorit special, i dyshuari është ndaluar në qendër të mbajtjes për 48 orë”, thuhej tutje në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Këto pretendime i ka mohuar mbrojtësi i të pandehurit Sali Berisha, Avokati Gëzim Kollçaku⁴⁵.

Vetëm një ditë pas arrestimit, më 20 shtator 2019, KGJK ka mbajtur takim të jashtëzakonshëm, gjatë të cilit ka pezulluar nga detyra Gjyqtarin Sali Berisha.

Më 20 shtator, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special për rastet e PSRK-së i kishte caktuar gjyqtarin Berisha masën e paraburgimit për 30 ditë, derisa më 18 tetor 2019, ky departament Gjyqtarit Berisha ia kishte vazhduar paraburgimin edhe për dy muaj të tjerë, aktvendim të cilin e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit⁴⁶.

Në anën tjetër, shtatë (7) ditë pas arrestimit të Gjyqtarit Berisha, përkatësisht me 26 shtator 2019, me urdhër të PSRK-së ishte arrestuar edhe Rafet Ismajli, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – dega në Skenderaj.

Bashkë me të, është arrestuar edhe një zyrtar policor, i dyshuar për marrje të ryshfetit.

Lidhur me këtë arrestim ka njoftuar edhe Policia e Kosovës.

“Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK), pas pesë muajve të zhvillimit të hetimeve profesionale dhe aplikimit të masave të përcaktuara sipas KPPRK-së, nga hetuesit rajonal për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit në Prishtinë ka siguruar informacione relevante që kanë pasqyruar abuzimin e funksioneve gjyqësore, gjegjësisht veprime që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Gjatë aplikimit të masave dhe veprimeve hetimore janë siguruar dëshmi të bazuara për inkriminimin e dy zyrtarëve; një gjyqtari në Departamentin Penal të Gjykatës Themelore në Skenderaj dhe të një zyrtari policor”, thuhej në njoftim⁴⁷.

Një ditë pas arrestimit, më 27 shtator 2019, KGJK përsëri kishte mbajtur takim të jashtëzakonshëm, gjatë të cilit takim kishte pezulluar nga detyra Gjyqtarit Rafet Ismajli.

Tutje, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special për rastet e PSRK-së, më 27 shtator 2019 të pandehurit Ismajli i kishte caktuar masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje

⁴⁵ "Mbrojtja thotë se gjykatësi Sali Berisha ra në grackë, mohon se ai mori ryshfet". Betimi për Drejtësi. 20 shtator 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-thote-se-gjykatesi-sali-berisha-ra-ne-gracke-mohon-se-ai-mori-ryshfet>). (Qasur së fundi më 29 nëntor 2019).

⁴⁶ "Gjykatësi Sali Berisha mbetet në paraburgim edhe për dy muaj". Betimi për Drejtësi. 1 nëntor 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesi-sali-berisha-mbetet-ne-paraburgim-edhe-per-dy-muaj/>). (Qasur së fundi më 29 nëntor 2019).

⁴⁷ "PSRK-ja kërkon paraburgim për gjykatësin në Skenderaj dhe zyrtarin policor të arrestuar nën dyshimin për korrupsion". Betimi për Drejtësi. 27 shtator 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/psrk-ja-kerkon-paraburgim-per-gjykatesin-ne-skenderaj-dhe-zyrtarin-policor-te-arrestuar-nen-dyshimin-per-korrupsion/>). (Qasur së fundi më 29 nëntor 2019).

prej 30 ditëve⁴⁸, të cilin vendim Gjykata e Apelit e kishte ndryshuar, në atë mënyrë që Gjyqtarit Rafet Ismajli i kishte caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditëve⁴⁹⁵⁰.

⁴⁸ "Caktohet arrest shtëpiak ndaj gjykatësit në Skenderaj dhe zyrtarit policor që dyshohen për korrupsion". Betimi për Drejtësi. 27 shtator 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/caktohet-arrest-shtepiak-ndaj-gjykatesit-ne-skenderaj-dhe-zyrtarit-policor-qe-dyshohen-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2019).

⁴⁹ "Apeli ndryshon vendimin e Themelores, cakton paraburgim ndaj gjykatësit në Skenderaj dhe zyrtarit policor që dyshohen për korrupsion". Betimi për Drejtësi. 4 tetor 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ndryshon-vendimin-e-themelores-cakton-paraburgim-ndaj-gjykatesit-ne-skenderaj-dhe-zyrtarit-policor-qe-dyshohen-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2019).

⁵⁰ *Shënim*: Më 5 shkurt 2020, PSRK ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë ndaj Gjyqtarit Sali Berisha.

8. Rekomandime

Rekomandimet për KGJK:

1. KGJK të tregojë efikasitet të shtuar në përmbushjen e obligimeve ligjore, sidomos miratimin e legjislacionit sekondar.
2. KGJK të avancojë praktikën pozitive të konsultimeve publike. Kjo praktikë të formalizohet me nxjerrjen e një rregulloreje të veçantë për konsultime publike.
3. KGJK të ndryshoj nenin 4.5.5.5 të Rregullores nr.01/2019 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr.11/2016 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve. Derisa KGJK ta bëjë këtë, Komisioni për Vlerësimin e Performancës ta implementoj këtë matës, përkundër vendimit jo relevant të KGJK-së në këtë rast.
4. Me rastin e draftimit të legjislacionit sekondar, KGJK ti shmanget volumit të panevojshëm të rregulloreve.
5. KGJK të ndryshojë nenin 2.7. të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve. Derisa KGJK ta bëjë këtë, autoritetet kompetente mos të hudhin ankesat disiplinore për faktin e vetëm se të njëjtat janë anonime.
6. KGJK mos të anashkalojë legjislacionin bazë me rastin e draftimit të legjislacionit sekondar.
7. KGJK në kuptim të dispozitave të KPPRK-së, të rishqyrtojë Rregulloren për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor.
8. Në legjislacionin e saj sekondar, KGJK të respektojë të drejtën në mjete juridike.
9. KGJK mos të referohet në legjislacion të shfuqizuar.
10. KGJK të miratojë raportin e saj vjetor brenda afatit.
11. Raporti vjetor i KGJK-së, raporti vjetor i Gjykatave dhe secili raport tjetër i KGJK-së mos të jetë ekskluzivisht përshkrues, por të ketë qasje analitike, në mënyrë që publiku, mediat dhe shoqëria civile ti kenë të njohura sukseset dhe sfidat e sistemit gjyqësor.
12. IKD i rekomandon KGJK-së që në afatin e përcaktuar ligjor të themelojë degët e reja që parashihen me Ligjin e ri për Gjykatat, dhe jo të ndjek praktikën e deritanishme ku tanimë është shfuqizuar Ligji për Gjykatat, por që asnjëherë nuk janë themeluar degët e reja të cilat KGJK ka pasur obligim ti themeloj.
13. KGJK të bëjë vlerësimin e performancës për 1/3 e të gjithë gjyqtarëve, në mënyrë që brenda tri (3) viteve të vlerësoj performancën e të gjithë gjyqtarëve. Për më tepër, KGJK të ketë kujdes që këtë proces ta zhvilloj në mënyrë meritore që i njëjti proces të arrijë qëllimin e tij, dhe mos të jetë vetëm një proces formal.
14. KGJK të vazhdoj me publikimin e vendimeve disiplinore.
15. KGJK të ftojë Kryetarët e Gjykatave çdo tre (3) muaj për të raportuar para anëtarëve të KGJK-së. Ky raportim të jetë thelbësor në kuptim të ngritjes së llogaridhënies, dhe jo të jetë vetëm një raportim formal.
16. KGJK të publikojë të gjitha vendimet dhe rregulloret e nxjerra nga KGJK, si gjatë vitit 2019, ashtu edhe ato të viteve të mëhershme.
17. KGJK mos të fshijë nga faqja e saj zyrtare vendimet e publikuara.
18. KGJK të njoftojë për secilin takim publikun, mediat dhe shoqërinë civile.
19. KGJK të ndalë praktikën e avancimit të gjyqtarëve në emër të transferimit.
20. KGJK të mbajë takime çdo muaj.

21. Sekretariati i KGJK-së të publikojë planit vjetor të takimeve të KGJK-së.
22. Anëtarët e KGJK-së të jenë më aktiv në diskutimet e këshillit, në mënyrë që të japin kontributin e tyre meritore si anëtar të institucionit që menaxhon me sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.
23. KGJK të zbatoj rregulloret që vet i ka miratuar.
24. KGJK me rastin e emërimit të kryetarëve të gjykatave, të ketë kujdes në respektimin e Ligjit Nr. 06/L -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik

Rekomandimet për KPK:

1. KPK të miratojë legjislacionin sekondar brenda afateve ligjore.
2. KPK të analizojë drejtë bazën ligjore me rastin e nxjerrjes së legjislacionit sekondar.
3. Me rastin e miratimit të legjislacionit sekondar, KPK mos të tejkaloj kornizat ligjore.
4. KPK të rishqyrtojë Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial.
5. KPK në zbatim të dispozitave ligjore të decentralizoj informacionin prokurorial.
6. KPK të rikthej prokurorët kujdestar për media.
7. KPK ti shmangët praktikës së ndryshimit të rregulloreve gjatë proceseve në zhvillim e sipër.
8. Me rastin e zgjedhjes së kryeprokurorëve, KPK ta respektojë rregulloren e saj të cilën e ka miratuar.
9. Me rastin e zgjedhjes së kryeprokurorëve, KPK ta zhvillojë procesin me efikasitet, dhe këto procese mos të zvarriten.
10. Me rastin e draftimit të rregulloreve, KPK ti shmangët volumit të panevojshëm.
11. KPK të rishqyrtojë nenin 7.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve. Derisa KPK ta bëjë këtë, autoritetet kompetente për prokurorë mos të hudhin asnjë ankesë disiplinore për faktin e vetëm se e njëjta është anonime.
12. KPK të avancojë procesin e konsultimeve publike me rastin e miratimit të dokumenteve me rëndësi për sistemin prokurorial. Po ashtu, KPK ta formalizojë këtë proces me nxjerrjen e një rregulloreje të veçantë për konsultime publike.
13. KPK të publikojë raportet e saja vjetore brenda afateve që vet i ka përcaktuar.
14. KPK të mbajë përgjegjësi Sekretariatit të KPK-së për zvarritjet e shkaktuara me rastin e publikimit të dokumenteve të miratuara nga KPK.
15. KPK të ketë kujdes të shtuar me rastin e vlerësimit të performancës së prokurorëve, në mënyrë që ky proces të arrijë qëllimin e tij, dhe jo të jetë një proces thjesht formal.
16. KPK të publikojë si të pa anonimizuar të gjitha vendimet disiplinore.
17. IKD i rekomandon KPK-së t'i ftojë Kryeprokurorët e të gjitha prokurorëve për të raportuar çdo 3 (tre) muaj, që i bie katër (4) herë brenda vitit. Po ashtu, ky raportim të jetë përmbajtës dhe efektiv, e jo të zhvillohet vetëm formalisht.
18. Sistemi prokurorial të respektojë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.
19. KPK të publikojë në faqen e saj zyrtare të gjitha vendimet e nxjerra si gjatë vitit 2019, ashtu edhe vendimet e viteve të tjera.

20. KPK të ndalë praktikën e avancimit të prokurorëve pa konkurs, në emër të transferimit.
21. Anëtarët e KPK-së të jenë më aktiv në diskutim gjatë takimeve të KPK-së, në mënyrë që të japin kontributin e tyre meritor si anëtar të institucionit që menaxhon me sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës.
22. KPK t'i ndalë akuzat për dështimet e sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe të kryejë obligimet e saj kushtetuese dhe ligjore në kuptim të kontrollit dhe mbikëqyrjes së prokurorive dhe mekanizmave të brendshëm. Në këtë drejtim, nëse ka bazë për atë se çka deklarojnë përfaqësuesit e sistemit prokurorial, këta të fundit duhet të hetojnë dhe të dërgojnë para drejtësisë këta gjykatës.
23. KPK me rastin e emërimit të kryeprokurorëve, të ketë kujdes në respektimin e Ligjit Nr. 06/L -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik